

# DORACA KU PËR MËSUES

**AKTIVITETE PËR MBËSHTETJE TË  
TË GJITHË NXËNËSVE NË SHKOLLË  
DHE NË KLASË**



**CIP - Каталогизација во публикација**

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

373.3:376.011.3-051(035)

373.3-057.874(035)

HOLENVEGER, Xhudith

Aktivite p r mb shtetje t  t  gjith  nx n sve n  shkoll  dhe n  klas  [Електронски извор]: doracak u p r m sues / Xhudith Holenveger, Edina Krompak. - Shkup : UNICEF, 2018

Начин на пристап (URL): <https://www.unicef.mk>. - Текст во PDF формат, содржи 130 стр., илустр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 17.05.2018. - Библиографија: стр. 129-130

ISBN 978-608-4787-25-9

1. Krompak, Edina [автор]

- а) Инклузивно образование - Наставници - Прирачници
- б) Основни училишта - Ученици - Поддршка - Прирачници

COBISS.MK-ID 107287562



# DORACAKU PËR MËSUES

**AKTIVITETE PËR MBËSHTETJE TË TË GJITHË  
NXËNËSVE NË SHKOLLË DHE NË KLASË**

Xhudith Holenveger  
Edina Krompak

**Mars, 2018**

# PËRMBAJTJA:

<b>HYRJA DHE SFONDI I PËRGJITHSHËM</b> .....	<b>7</b>
Qëllimi i këtij doracakut për mësues .....	8
Premisat themelore dhe korniza .....	9
Baza teorike e doracakut për mësues.....	10
Sfondi .....	10
Resurse dhe informacione të përgjithshme.....	10
Falënderime .....	11
<b>PJESA E PARË: NGA PARIMET NË AKTIVITETET E SHKOLLËS</b> .....	<b>16</b>
<b>1.1 KRIJIMI I SHKOLLAVE GJITHËPËRFSHIRËSE</b> .....	<b>18</b>
Sfondi .....	18
Informacione për përdoruesin .....	18
Aktiviteti shkollor 1: Transformimi i jetës shkollore përmes pjesëmarrjes së nxënësve .....	18
Aktiviteti shkollor 2: Kremtimi i Ditës së të drejtave të njeriut .....	20
Aktiviteti shkollor 3: Bashkëpunimi ndërmjet bashkësisë dhe shkollës .....	22
Aktiviteti shkollor 4: Dita e hapur për mësim .....	24
<b>1.2 MËSUESIT GJITHËPËRFSHIRËS</b> .....	<b>26</b>
Sfondi .....	26
Informacione për përdoruesin .....	26
Aktiviteti shkollor 1: Evaluimi ndërmjet kolegëve mes shkolla partnere .....	26
Aktiviteti shkollor 2: Informacione kthyesë mes kolegëve mësues .....	28
Aktiviteti shkollor 3: Orët e përbashkëta për të ligjëruar atë për çka jeni të spikatur- shkëmbimi i praktikave të mira .....	29
Aktiviteti shkollor 4: Pasqyrimi i mësimin të përbashkët.....	31
<b>1.3 BASHKËPUNIMI ME TË TJERËT</b> .....	<b>32</b>
Sfondi .....	32
Informacione për përdoruesin .....	32
Aktiviteti shkollor 1: Sistemi i “mbështetjes nga bashkëmoshatarët” .....	33
Aktiviteti shkollor 2: Bashkëpunimi me prindërit.....	35
Aktiviteti shkollor 3: Bashkëpunimi me nxënësit: Bashkësia e nxënësve .....	36
Aktiviteti shkollor 4: Krijimi i fushatës shkollore kundër dhunës .....	38
<b>1.4 RESPEKTIMI I DIVERSITETIT TË NXËNËSVE – FOKUSI NË IDENTITET...</b> .....	<b>40</b>
Sfondi .....	40
Informacione për përdoruesin .....	40
Aktiviteti shkollor 1: Ne dhe bota – fokusi në paragjykimet.....	40
Aktiviteti shkollor 2: Pa faj - Sfidimi i sjelljes.....	42
Aktiviteti shkollor 3: Shkruaj këngë për veten .....	44
Aktiviteti shkollor 4: Bëjeni të dukshëm diversitetin gjuhësor!.....	46
<b>1.5 MBËSHTETJA E TË GJITHË PJESËMARRËSVE</b> .....	<b>49</b>
Sfondi .....	49
Informacione për përdoruesin .....	49
Aktiviteti shkollor 1: Ejani të fluturojmë!.....	49
Aktiviteti shkollor 2: Përvetësimi i këndvështrimit të tjerëve.....	51
Aktiviteti shkollor 3: Orkestra e shkollës dhe grupi teatror .....	53
Aktiviteti shkollor 4: Mbrëmje për rrëfim të tregimeve në prezencë të familjeve .....	55
<b>PJESA E DYTË: NDËRTIMI I BLOQEVE NË DREJTIM TË MBËSHTETJES SË TË GJITHË NXËNËSVE</b> .....	<b>56</b>
<b>2.1 PROGRAMI MËSIMOR GJITHËPËRFSHIRËS DHE FLEKSIBIL</b> .....	<b>58</b>
Sfondi .....	62
Informacione për përdoruesin .....	58
Aktiviteti 1: Udhëzime për diferencim – piramida e planifikimit .....	58
Aktiviteti 2: Më shumë mënyra të prezantimit të informacioneve .....	62
Aktiviteti 3: Më shumë mënyra për veprim dhe shprehje .....	64
Aktiviteti 4: Ndërtimi i përbashkët i vokabularit.....	66

<b>2.2 KRIJIMI DHE PËRSHTATJA E QËLLIMEVE KUPTIMPLOTA PËR TË GJITHË NXËNËSIT .....</b>	<b>68</b>
Sfondi .....	68
Informacione për përdoruesin .....	68
Aktiviteti 1: Zhvillimi i qëllimeve efektive .....	69
Aktiviteti 2: Nxënësit i parashikojnë të arriturat e ardhshme .....	71
Aktiviteti 3: Kontrollimi i qëllimeve SMART.....	73
Aktiviteti 4: Ndërtimi i pritjeve pozitive për nxënësit tuaj më të vështirë.....	74
Aktiviteti 5: Mësimi përmes punëtorive.....	77
Aktiviteti 6: Korrigjimi i punimeve me shkrim i orientuar dhe fokusuar kah resurset .....	79
<b>2.3 KRIJIMI I MJEDISEVE TË PËRSHTATURA MËSIMORE.....</b>	<b>81</b>
Sfondi .....	81
Informacione për përdoruesin .....	81
Aktiviteti 1: Ambienti i klasës .....	82
Aktiviteti 2: Rrethi i brendshëm dhe i jashtëm .....	85
Aktiviteti 3: Riorganizimi i klasës .....	86
Aktiviteti 4: Ushtrimi për grupim fleksibil – rebusi grupor .....	88
<b>2.4 SHFRYTËZIMI I VEGLAVE DHE STRATEGJIVE PËR MBËSHTETJE TË TË GJITHË NXËNËSVE .....</b>	<b>90</b>
Sfondi .....	90
Informacione për përdoruesin .....	90
Aktiviteti 1: Veglat për drejtim të klasës.....	91
Aktiviteti 2: Puna me paragjykimet e nxënësve.....	94
Aktiviteti 3: Marrëveshjet për mësim .....	96
Aktiviteti 4: Portofolat për mësim.....	98
<b>PJESA E TRETË: ZBATIMI PRAKTIK.....</b>	<b>5</b>
<b>3.1 PLANIFIKIMI: PARASHIKIMI I DETYRAVE DHE RRETHANAVE .....</b>	<b>101</b>
Sfondi .....	101
Informacione për përdoruesin .....	101
Aktiviteti 1: Vënia e pasaportës së kompetencës, ose pasaportës arsimore .....	102
Aktiviteti 2: Planifikimi i mësimin të më shumë niveleve dhe më shumë dimensioneve .....	105
Aktiviteti 3: Druri i pritjeve.....	107
Aktiviteti 4: Nxënësit dhe prindërit marrin pjesë në planifikimin e arsimit.....	109
<b>3.2 VEPRIMI: SINKRONIZIMI I MËSIMDHËNIES DHE MËSIMIT .....</b>	<b>111</b>
Sfondi .....	111
Informacione për përdoruesin .....	111
Aktiviteti 1: Njohja e stilit të mësimin dhe shkathtësitë ekzekutive të nxënësve .....	112
Aktiviteti 2: Festë me çaj – ushtrimi i përbashkët për parashikim të tekstit.....	114
Aktiviteti 3: Nxënësit bëhen mësues për një ditë – mësimdhënia reciproke .....	116
Aktiviteti 4: Librezat për lidhjen e shkollës me shtëpinë .....	118
<b>3.3 EVALUIMI: KOMBINIMI I RISHIKIMIT DHE REFLEKSIONIT .....</b>	<b>120</b>
Sfondi .....	120
Informacione për përdoruesin .....	120
Aktiviteti 1: Komunikimi me nxënësit përmes informacioneve kthyesë kuptimplota .....	121
Aktiviteti 2: Strategjitë për vetëmbikëqyrje të nxënësve.....	123
Aktiviteti 3: Strategjia për evaluim mes nxënësve si bashkëmoshatarë.....	124
Aktiviteti 4: Aktiviteti me tre kavanoza .....	126
<b>SHTOJCA.....</b>	<b>128</b>
Fotografi .....	128
Referenca.....	129



**HYRJA**

**DHE SFONDI I PËRGJITHSHËM**

## QËLLIMI I KËTIJ DORACAKU PËR MËSUES



Ky doracak synon t'i inkurajojë mësuesit të bëhen praktikues gjithëpërfshirës (inkluziv). Në fakt ai është një udhëzues praktik për promovimin e arsimit gjithëpërfshirës në shkollë dhe në klasë, por edhe në rrafshin individual. Doracaku është një koleksion i aktiviteteve, të cilët administrata dhe mësuesit e shkollave mund t'i zbatojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Shpresojmë që shembujt dhe burimet e dhëna në këtë doracak do të krijojnë ide për mësuesit dhe udhëheqësit e shkollave, me qëllim që të zhvillojnë aktivitete të mëtejshme, të cilat do t'i ndajnë me kolegët e tyre dhe me shkollat tjera. Doracaku nuk iu përcakton mësuesve se çka të bëjnë ose të mos bëjnë, por thjesht ofron shembuj për gjërat që mund t'i bëjnë, dhe më e rëndësishmja, është si ua tregon mënyrën se si mund ta bëjnë atë, gjegjësisht arsyen pse ta bëjnë atë.

Doracaku i mësuesve nuk është një produkt përfundimtar, por është më tepër një fillim i një koleksioni të mirëorganizuar të shembujve të praktikave të mira të dhëna më poshtë. Shpresojmë që me kalimin e viteve do të zhvillohet dhe do të përfshijë shembuj të praktikës së mirë dhe ideve të mira nga shkollat në rajon. Doracaku mund të përdoret nga secila shkollë, ndonëse fillimisht ishte menduar për shkollat që janë pjesë e rrjetit të shkollave gjithëpërfshirëse (inkluzive) të UNICEF-it. Rrjeti në fjalë është në rritje e sipër. Deri më tani shkollat e këtilla i kanë absorbuar modulet për trajnim të trajnuesve për arsim gjithëpërfshirës, të zhvilluar nga UNICEF-i dhe kanë filluar t'i zbatojnë parimet dhe idetë fillestare të zhvilluara gjatë punëtorive, ndërsa më vonë edhe në proceset zhvillimore të shkollave.

Premisa themelore e moduleve dhe e këtij doracaku për mësues është se shkollat gjithëpërfshirëse (inkluzive) duhet të zhvillojnë praktika të mira gjithëpërfshirëse në katër sfera:

- zhvillimi i vazhdueshëm profesional i liderëve të shkollave, mësuesve dhe personave tjera profesionalë, që punojnë në shkollë (me fokus në mësuesit dhe personat tjera profesionalë),
- zhvillimi i bashkëpunimit dhe praktikave në klasë, shkollë dhe bashkësi (me fokus në bashkëpunim),
- respektimi dhe vlerësimi i diversitetit të nxënësve në të gjitha praktikat shkollore (me fokus te nxënësit), dhe
- mbështetja e të gjithë nxënësve përmes fleksibilitetit të programit mësimor dhe përfshirja e praktikave të ndara (diferencuara) mësimore për realizim të tyre (me fokus në programin mësimor).

Këto katër praktika gjithëpërfshirëse janë marrë nga “Profili i mësuesve gjithëpërfshirës” të Agjencisë Evropiane për Zhvillim në Arsimin Special (2012). Ato u zhvilluan në kuadër të katër praktikave të lartpërmendura. Ideja për fokusim në praktikë është e thjeshtë: mund të jeni mësues i përkryer për arsim gjithëpërfshirës, mirëpo vetëm pasi të përfshiheni në praktikat gjithëpërfshirëse do ta përcillni ndryshimin të nxënësit tuaj. Ajo që është e dobishme për mësuesit është fakti se praktikat gjithëpërfshirëse nuk iu tregojnë atyre se çka të bëjnë, por i bëjnë të mësojnë, se si ajo që ata e dinë



të bëhet e rëndësishme, gjegjësisht pse të bëhet e rëndësishme. Doracaku ka për qëllim të mbështetë mësimdhënien dhe kapacitetet e mësuesve për të vepruar në klasë dhe në shkollë në mënyrë të qëllimshme dhe profesionale.

Ky doracak për mësues fokusohet në sferën kryesore të praktikave të klasës, duke dhënë shembuj për mbështetjen e të gjithë nxënësve në mësonjëtoen gjithëpërfshirëse. Këtu është fjala për të bërë programin mësimor të qashtëm për të gjithë nxënësit dhe për të krijuar mundësi për mësim të qëllimshëm dhe për pjesëmarrje të nxënësve.

## PREMISAT THEMELORE DHE KORNIZA



Ky doracak për mësues është një vazhdim i përpjekjeve të UNICEF-it për përfshirjen e arsimit gjithëpërfshirës në shkolla dhe krijimin e një rrjeti praktikash të mira. Shkollat më së miri mësojnë nga shkollat tjera, të cilat kanë realizuar aspekte të caktuara të arsimit gjithëpërfshirës dhe janë në gjendje t'i ndajnë ato. Doracaku është i bazuar në filozofinë dhe strategjinë e UNICEF-it për të mbështetur arsimin gjithëpërfshirës në mbarë botën. Në të përshkruhet korniza konceptuale e moduleve për trajnim të trajnuesve për arsimin gjithëpërfshirës e përgatitur nga Zyra Rajonale e UNICEF-it për EQL/ BShP (Evropën Qendrore dhe Lindore/Bashkësinë e Shteteve të Pavarura). Përmes këtyre moduleve, mësuesit mësojnë rreth arsimit gjithëpërfshirës, veçanërisht në rrethanat e bashkëpunimit, ku shkollat studiojnë së bashku. Ky doracak ka për qëllim të mbështesë menaxherët e shkollave dhe mësuesit në zbatimin e ideve dhe parimeve të tyre në praktikë.

Doracaku për mësues bazohet në qasjen e bazuar në të drejta, ku fëmija është në qendër të vëmendjes. Fëmijët konsiderohen si bartës të të drejtave, e jo të detyrimeve. Shtetet dhe shkollat duhet të përmbushin detyrimet e tyre dhe ta respektojnë, mbrojnë dhe përmbushin të drejtën për arsim. Të gjithë fëmijët kanë të drejtën dhe aftësinë për të mësuar, ndërsa shkollat janë ato që bartin përgjegjësinë për të krijuar një mjedis mësimor, i cili nxit të mësuarit dhe pjesëmarrjen e të gjithë fëmijëve. Arsimi vrojtohet përmes syve të nxënësit. Procesi i transformimit të shkollave, nga hapësira në të cilat mësohet programi mësimor (kurrikula), në ambiente në të cilat mësojnë fëmijët konsiderohet si realizim progresiv i arsimit gjithëpërfshirës.


Doracaku për mësues synon t'iu sigurojë mësuesve njohuri konkrete, gjegjësisht, dituri që transformohet lehtë në veprim. Për ta lehtësuar këtë proces, secili aktivitet përshkruhet nga këndvështrimi i përdoruesit. Modeli teorik i aktiviteteve, i cili qëndron në bazën e moduleve për trajnim të trajnuesve ofron strukturën për prezantim të aktiviteteve. Në pasqyrimin e secilit aktivitet jepen përgjigje për pyetjet e njëjta:

Pse është i rëndësishëm ky aktivitet? („Pse?“ ose „Për çfarë arsye?“)

Për çka bëhet fjalë? („Çka?“)

Metodat dhe veglat e nevojshme („Si?“)

Sipas modelit teorik të aktiviteteve, këto janë pyetjet tjera, të cilat duhet të shqyrtohen: „Kush?“ dhe „Ku?“, që të përshkruhet plotësisht aktiviteti (shih Modulin hyrës për trajnim të trajnuesve, UNICEF 2015, fq. 10ff.):



**Fotografia 1: Modeli i aktiviteteve**

Pyetjet që kanë të bëjnë me atë se “kush” dhe “ku” do ta realizojë aktivitetin janë njësoj të barabarta, por ato duhet të përgjigjen nga përdoruesi, duke e marrë parasysh kontekstin konkret ose mjedisin në të cilin do të realizohen aktivitetet. Rrethanat lokale mund njashtu të ndikojnë në fokusin e aktivitetit (“Çka”) dhe në materialet ose strategjitë (“Si”)e përdora. Përdoruesit e ndryshëm mund të përqendrohen pak më ndryshe edhe në rezultateve, andaj edhe kjo do të ndikojë ndaj mënyrës se si zbatohet aktiviteti.

### **Baza teorike e doracakt për mësues**

Doracaku për mësues nuk i shpjegon parimet e arsimit gjithëpërfshirës, por ofron aktivitete, me të cilat këto parime do të zbatohen në shkollë, në klasë dhe në mënyrë individuale. Po ashtu, doracaku nuk e përfshin nivelin e politikave (nacionale, rajonale ose lokale, varësisht nga sistemi arsimor). Aktivitetet për avancimin e politikave gjithëpërfshirëse dhe praktikave administrative nuk janë të përfshira në këtë doracak, për shkak se ai synon t’iu ndihmojë mësuesve në praktikatat e tyre për të zhvilluar shkolla dhe klasa gjithëpërfshirëse.


PERSPEKTIVA KRONOLOGJIKE						
Shkolla si...	Matja Grumbullimi	Analiza Kuptim	Planifikimi Vendimarrja	Veprimi Implementimi	Kontrollimi Vlerësimi	
<b>KËNDVËSHTRIMI SISTEMOR</b>	Politika					
	Shkolla					
	Klasa					
<b>MARRËDHËNIET PJESEMARRËSE I NDËRLIDHIN MJEDISET/SISTEMET ME PERSONIN</b>						
<b>MARRËDHËNIET PJESEMARRËSE I NDËRLIDHIN MJEDISET/SISTEMET ME PERSONIN</b>						

### Fotografia 2: Arsimi si sistem dhe proces

Fotografia 2 ofron pasqyrim të niveleve sistemore dhe hapave kronologjike për zgjedhjen e problemeve të nevojshme për realizim e arsimit gjithëpërfshirës në nivele të ndryshme. Matja, grumbullimi dhe analiza e informacioneve të burimeve të ndryshme janë hapa të rëndësishme për arritje të botëkuptimit për planifikim dhe vendimarrje në lidhje me mësimin dhe pjesëmarrjen e nxënësve.


Shkollat gjithëpërfshirëse janë të orientuara drejt tejkalimit të izolimit të mësuesve përkatës. Puna e në projekte të përbashkëta dhe organizimi i aktiviteteve për të gjithë nxënësit ndihmon në krijimin e ndjenjës së përkatësisë dhe nevojës, që shkolla të bëhet gjithëpërfshirës. Aktivitetet shkollore kanë në fokus krijimin e shkollave gjithëpërfshirëse në përgjithësi dhe në bazë të praktikave konkrete të mësuesve gjithëpërfshirës, si p.sh. mbështetja e zhvillimit profesional të mësuesve, bashkëpunimi, respektimi i dallimeve dhe sigurimi i mbështetjes gjatë mësimin. Këtu është fjala për mënyrën se si mësuesit i ndajnë mes vete përvojat dhe dituritë.

Aktivitetet kryesore dhe përgjegjësitë e arsimtarëve janë në klasë, gjë që është në fokus të këtij doracaku. Sipas Profilit për mësues gjithëpërfshirës (Agjencia Evropiane 2012) siç edhe u theksua, ekzistojnë katër sfera të kompetencës: “Vlerësimi i dallimit të nxënësve”, “Mbështetja e të gjithë nxënësve”, “Bashkëpunimi me të tjerët” dhe “Zhvillimi personal profesional”. Praktika e përgjithshme e realizimit të praktikave gjithëpërfshirëse në shkolla është paraqitur në Fotografinë 3.



**Fotografia 3: Modeli i aktiviteteve të praktikave të mësimin gjithëpërfshirës**

Ky doracak konkret për mësues fokusohet në “Mbështetje të të gjithë nxënësve”, që paraqet mënyrën “si” janë praktikat gjithëpërfshirëse (inkluzive). Fjala është për mënyrën se si mësuesit duhet ta promovojnë të të gjithë nxënësit mësimin akademik, praktik, social dhe emocional, si dhe të mësohen të përdorin praktika efektive mësimore. Si ta promovojnë programin mësimor për mbështetje të mësimin të të gjithë nxënësit? Si të krijojnë mundësi për mësim dhe të sajajnë mjedise mësimore, në të cilat iu adresohet nevojave dhe interesave të nxënësve?



**Fotografia 4: Modeli i aktiviteteve për praktikën e mbështetjes së të gjithë nxënësve**

Me fokus konkret në mbështetjen e të gjithë nxënësve, mësuesit gjithëpërfshirës duhet që në të gjitha praktikatat të fokusohen në “Pse”, “Çka”, “Si”, dhe “Ku”. Fotografia 4 i paraqet këta katër komponentë të praktikave mësimore për mbështetje të të gjithë nxënësve. Këta komponentë janë strukturë përbërëse të pjesës së dytë.

### Sfondi

Doracaku për mësues është organizuar në tre kapituj kryesorë. Pjesa e parë “Nga parimet në aktivitetet kryesore në shkollë” përmban aktivitete shkollore për përfshirje të nxënësve, mësuesve, madje edhe të prindërve, jashtë ambientit të zakonshëm të klasës. Pjesa e dytë “Ndërtimi i blloqeve drejt mbështetjes së të gjithë nxënësve” fokusohet në aktivitetet e klasës. Orari i nënkapitujve i ndjek komponentët e praktikave të mira. Pjesa e tretë “Zbatimi praktik” është organizuar rreth procesit arsimor, duke filluar me perspektivën e planifikimit, të ndjekur me perspektivën interaktive të sinkronizimit të mësimin dhe mësimdhënies, duke përfunduar me perspektivën e vlerësimit përmes rishikimit dhe refleksionit. Çdo pjesë e secilës nënpjesë fillon me një rezymë (sfond), me qëllim të orientimit më të lehtë dhe ndihmesës së përdoruesit për ta kontekstualizuar aktivitetin. Pas pasqyrimit vijnë informacione themelore, të cilat përdoruesit duhet t’i merr parasysh gjatë implementimit të aktiviteteve të dhëna brenda nënpjesës.

Pjesa e tretë dhe e fundit, e emërtuar si “Zbatimi praktik”, e shpie lexuesin në procesin e përgatitjes, realizimit dhe evaluimit të mësimdhënies dhe mësimin. Kjo pjesë e ndjek procesin e arsimit, që në esencë është cikli i aktiviteteve, gjegjësisht cikli i zgjidhjes së problemeve. Kur mësuesit e planifikojnë mbështetjen e të gjithë nxënësve, duhet t’i kombinojnë këto elemente: “Pse” (qëllimet zhvillimore), “Çka” (përmbajtjen e programit mësimor dhe paraqitjen e tij), “Si” (strategjitë e mësimdhënies dhe mësimin) dhe “Ku” (ambientin e mësimdhënies dhe mësimin). Për këtë arsye pjesa e tretë thekson praktikatat e parashikimit të detyrave dhe ambienteve mësimore, për shkak të sinkronizimit të aktiviteteve mësimore dhe mësimin të rishikimit dhe refleksionit.

### Resurse dhe informacione të përgjithshme

Në epokën e sotme të informatikës nuk ekzistojnë informacione, ide dhe resurse, të cilat mësuesit nuk mund t’i gjejnë në internet. Megjithatë, mund të jetë mjaft rënde të gjenden resurse të cilësisë së lartë për ndonjë qëllim të caktuar. Struktura e këtij doracaku iu ndihmon mësuesve të kenë pasqyrë dhe të organizohen aktivitete në pajtim me qëllimin dhe fokusin e tyre. Ndoshta do të duhet në internet të hulumtohen dhe të zbulohen resurse të dobishme në kontekst të promovimit të arsimit gjithëpërfshirës.

Ekzistojnë ueb sajte të caktuara, të cilat sigurojnë resurse të vlefshme për arsim gjithëpërfshirës, të cilat janë edhe në përputhje me qasjen e UNICEF-it ndaj arsimit gjithëpërfshirës:


[Portali rajonal i UNICEF-it për arsim gjithëpërfshirës në Evropë dhe Azi Qendrore](#) është resurs kryesor për punëtorët profesional në vendet e rajonit. Në këtë ueb

sajt janë publikuar [Modulet për trajnim të trajnuesve për arsim gjithëpërfshirës](#), si dhe [14 broshurat për arsim gjithëpërfshirës](#).

Agjencia Evropiane për Arsim të Personave me Nevoja të Posaçme dhe Arsim Gjithëpërfshirës së bashku me UNESCO-n e kanë zhvilluar një ueb sajt, të njohur si "[Arsimi gjithëpërfshirës në veprim](#)", në të cilin ka shumë shembuj të praktikave të mira.

[Rrjeti i shkollave gjithëpërfshirëse](#) (RrShGj) paraqet një resurs arsimor i bazuar në familje, shkolla dhe bashkësi, në të cilin promovohen praktika arsimore gjithëpërfshirëse. Mund të vizitoni ueb faqen e tyre kryesore ose mund të lidhen drejtpërsëdrejti në [ueb faqen e resursit të strukturuar mirëfilli](#).


Ueb faqet, në të cilat ka informacione për tema dhe çështje konkrete janë theksuar në kapitujt përkatës, si "informacione dhe referenca plotësuese".




### Falënderime

Përgatitja e këtij doracaku për mësues është mundësuar nga Zyra e UNICEF-it në Shkup dhe Qendra Maqedonase për Edukim Qytetar. Zanafilla e këtij procesi ishte punëtorja për mësim të diferencuar, e cila u realizua nga Edina Krompak në Shkup, nga 19 deri më 21 nëntor të vitit 2014 dhe nga 6 deri më 8 nëntor të vitit 2016. Për të siguruar kompatibilitet me kornizën konceptuale të moduleve të UNICEF-it për trajnim të trajnuesve dhe për të mundësuar zbatim më të gjerë edhe përtej projekteve në këtë vend, Xhudit Hollenveger e përpunoi strukturën e doracakut në përputhje me modulet për trajnim të trajnuesve (UNICEF 2015) dhe me Kornizën për praktika gjithëpërfshirëse (Këshilli i Evropës 2015). Fotografitë në doracak për mësues përmbajnë punime të pjesëmarrësve të punëtorive për mësim të diferencuar dhe të dhëna hulumtuese të projektit hulumtues “Gjuha dhe hapësira në kontekstet arsimore: peizazhi lingistik i një shkollë fillore të Zvicrës”, implementuar nga Edina Krompak. Të gjitha të drejtat e fotografive janë të rezervuara nga Edina Krompak.

Autorët duan të falënderojnë Nora Shabanin, Vera Kondikj Mitkovska dhe Anica Aleksova për komentet e tyre shumë të vlefshme në Manualin e Mësuesit dhe Karen A. Lowing (Universiteti i Strathclyde) për redaktimin e versionit në gjuhën angleze.



# PJESA E PARË





**NGA**

**PARIMET**

**NË AKTIVITETET  
E SHKOLLËS**

## 1.1 СОЗДАВАЊЕ ИНКЛУЗИВНИ УЧИЛИШТА

### Sfondi

Ky kapitull fokusohet në aktivitetet e përgjithshme për promovim të parimeve dhe praktikave të arsimit gjithëpërfshirës në shkollë. Arsimit gjithëpërfshirës nënkuptohet si proces përmes së cilit avancohet mësimi dhe pjesëmarrja e të gjithë fëmijëve dhe të rinjve, ndërsa evitohen të gjitha pengesat të cilat krijojnë barriera për mësim dhe pjesëmarrje. Kjo nënkupton se theksi nuk është vënë në atë që e bëni, por çështja është pse dhe si e bëni.

Nëse dëshironi të mësoni më shumë informacione për premiset themelore të arsimit gjithëpërfshirës, shikoni resurset e theksuara në kapitullin 1, në veçanti modulin 1 të UNICEF-it për trajnim të trajnuesve, si dhe në uebinarin dhe broshurën 1 “Konceptimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe kontekstualizimi i tij në misionin e UNICEF-it”.

### Informacione për përdoruesin

Këtu fokusi është në aktivitetet, të cilat përfshijnë gjithë shkollën, që ajo të bëhet më gjithëpërfshirëse. Ekipi gjithëpërfshirës i shkollës në bazë të marrëveshjes me të gjithë mësuesit duhet t'i planifikojë këto aktivitete dhe të mundësojë implementimin e tyre.

### Aktiviteti shkollor 1: Transformimi i jetës shkollore përmes pjesëmarrjes së nxënësve



#### Pse është me rëndësi?

- Kuptimi i këndvështrimit të fëmijëve ndihmon në mbështetjen e mësimit dhe pjesëmarrjes së tyre
- Kur fëmijët mendojnë për situatën e tyre, ata ndërtojnë vetëdije më të lartë për veten dhe për të tjerët
- Fëmijët kanë të drejtë të dëgjohen, që të merren parasysh qëndrimet e tyre, kur merren vendime të rëndësishme

#### Për çka bëhet fjalë?

- Sigurimi i veglave që nxënësit të mund të shprehen dhe të kuptohen
- Krijimi i mundësive që nxënësit të marrin pjesë në marrjen e vendimeve

#### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Celularë (për fotografim), flip çart ose letër tjetër, fletë ngjitëse dhe flomasterë

### Përshkrimi i aktivitetit:

Përcaktojeni çështjen ose sferën e jetës shkollore, në të cilin dëshironi të shqyrtohet mendimi i nxënësve. Konsultohuni me nxënësit dhe prindërit para se të vendosni për këtë çështje, që të jeni të sigurt se edhe ata e ndajnë me ju të njëjtin mendim dhe e vlerësojnë fokusin e përzgjedhur nga ju dhe shkolla juaj.

- Fotografimi, që të vizualizohet ajo që iu pëlqen dhe nuk iu pëlqen (p.sh. në lidhje me ndërtesën e shkollës, fushën e sportit);
- Ngjyrosje të fotografive për ti shprehur qëndrimet e tyre – për të cilat më vonë do të mund të komentojnë;
- Nxënësit të punojnë në grupe të vogla, që të japin ide, shprehin mendime dhe qëndrime. Mund t’iu jepni fletë ngjitëse dhe flip çart.

Grumbulloni komentet ose zgjidhjet e dhëna nga nxënësit dhe disenjoni një proces, në të cilin do të arrini konsensus ndërmjet të gjithë nxënësve të përfshirë.

Hartoni një plan për implementim dhe konsultohuni me nxënësit. Nëse ka mundësi, ata mund marrin pjesë në këtë proces, ose do të bartin përgjegjësi për të (me mbështetjen tuaj).

Zbatojeni planin dhe përkujdesuni që nxënësit të mësojnë se si janë marrë parasysh qëndrimet dhe mendimet e tyre, ndërsa aty ku nuk ka qenë e mundur, shpjegoni pse dhe cilat kanë qenë arsyet. Përcaktoni datën, kur do të vlerësohet rezultati i arritur.



**Fotografia 5: Porosi të mirëseardhjes në gjuhë të ndryshme (një shkollë fillore nga Zvicra)**

**Informacione plotësuese dhe referenca:**

[E drejta e secilit fëmijë për të qenë i dëgjuar](#). Resurs udhëzues i UNICEF-it dhe Save the Children (Shpëtoni fëmijët), 2011 (Implementimi në shkollë, fq. 100ff.)  
[Projekte për pjesëmarrje të fëmijëve – si të funksionojë](#). Këshilli i Evropës, 2004

**Aktiviteti shkollor 2: Krentimi i Ditës së të drejtave të njeriut****Pse është me rëndësi?**

- Fëmijët mund t'i realizojnë të drejtat e tyre vetëm nëse e dinë se cilat janë ato
- Qasja sipas së cilës fëmijët janë në fokus, arrihet vetëm kur fëmijët mund t'i realizojnë të drejtat e tyre
- Pjesëmarrja përcakton që fëmijët të përfshihen në procesin e vendimmarrjes, me qëllim që t'i realizojnë të drejtat e tyre arsimore

**Për çka bëhet fjalë?**

- Fëmijët përfshihen, që mes tjerash të mësojnë për mbrojtjen nga diskriminimi, për debatet e korrekte në publik, për të drejtën e pushimit dhe kohës së lirë, gjegjësisht për të drejtën e arsimit
- Fëmijët përvetësojnë kuptim më të mirë për të drejtat dhe detyrimet e tyre
- Fëmijët kuptojnë se të drejtat e njeriut janë njësoj të rëndësishme për të gjithë dhe se si të tilla duhet të respektohen

**Metodat dhe veglat e nevojshme**

- [Konventa për të drejtat e njeriut në gjuhë të përshtatshme për fëmijët](#)
- Krijoni loja (p.sh., kartelat e kujtesës) për t'u njoftuar me të drejtat e fëmijëve
- [Hulumtimi i drejtave të fëmijëve](#) (Doracak, që përveç gjuhëve tjera është edhe në gjuhën shqipe dhe atë maqedonase, duke përfshirë edhe kartelat për të drejtat e njeriut)

**Përshkrimi i aktivitetit:**

Shfrytëzoheni Ditën Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, e cila shënohet çdo vit më 10 dhjetor ose në çfarëdo dite ndërkombëtare (p.sh. dita e personave me pengesa në zhvillim më 3 dhjetor), që ta potenconi një çështje me rëndësi për shkollën tuaj, e cila paraqet sferën, në të cilën dëshironi ta ngritni vetëdijen e nxënësve, prindërve dhe të punësuarve. Idetë themelore mund të merren nga [ueb faqja e Kombeve të Bashkuara](#).

Mund të përdorni shembuj konkretë për të drejtat e shkelura të fëmijëve, si pikë nismëtare për diskutim. Shembujt mund të merren nga mediat, mund të potencohet ndonjë eveniment i ndodhur në bashkësi ose në shkollë ose të mund të merren nga ndonjë libër. Shembulli mund të paraqitet në mënyra dhe në rrethana të ndryshme, me ndihmën e cilitdo medium me qëllim që të ngacmohet interesi i nxënësve. Po ashtu, mund të ftohet ndonjë person i njohur ose person me renome, i cili do të rrëfejë për incidentin.

Jepuni fëmijëve kohë, që të mendojnë dhe bashkërisht të bisedojnë në lidhje me shembullin. Diskutimin mund ta drejtoni përmes parashtrimit të pyetjeve konkrete, që më pas ta vazhdoni debatin dhe zhvillimin e zgjidhjeve dhe ideve për zgjidhje të konfliktit ose për respektim të së drejtës së të gjithëve. Po ashtu nxënësit mund të inkurajohen në mënyrë të ndërsjellë t'i përshkruajnë ose t'ia prezantojnë njëri tjetrit zgjidhjet përkatëse. Ju mund ta mbështetni diskutimin e tyre duke i pasqyruar të gjitha nenet e Konventës për të drejtat e fëmijës.

Bisedoni me fëmijët në lidhje me zgjidhjet dhe përpiquni të arrihet konsensus për mënyrën se si situatat e këtilla do të mund të zgjidhen më së miri, gjegjësisht cilat rregulla do të mund të nxirren nga zgjedhjet e prezantuara prej tyre. Pyetni nxënësit për ndodhitë ose situatat, të cilat vetë ata ose shkollat do t'i zbatojnë në të ardhmen nga zgjidhjet e propozuara prej tyre.

Përkujdesuni që vendimi të mbahet mend, të ngel i dukshëm dhe të zbatohet.



**Fotografia 6:** “Ne jemi të sjellshëm, ndihmohemi mes vete dhe e dëgjojmë njëri tjetri” (Në balona me tekst, shënohet: “Mirëmëngjesi!” “Mirëmëngjesi!” “Çka ndodhi? Ai më goditi.”)

**Informacione plotësuese dhe referenca:**

UNICEF-i, [Informacione për të drejtat e fëmijës](#)

Këshilli i Evropës: [Informacione për të drejtat e fëmijës](#)

Këshilli i Evropës: [Nëntë projekte të shkurtra për hulumtim të të drejtave të fëmijëve në shkollë](#)

Këshilli i Evropës: [Materiale shoqëruese për mësimdhënie dhe mësim](#)

**Aktiviteti shkollor 3: Bashkëpunimi ndërmjet bashkësisë dhe shkollës****Pse është me rëndësi?**

- “Për të edukuar një fëmijë nevojitet një fshat”, proverb afrikane
- Arsimi gjithëpërfshirës nuk mund të realizohet pa mbështetjen e prindërve dhe grupeve të rëndësishme të palëve përkatëse në bashkësi

**Për çka bëhet fjalë?**

- Identifikimi i vendeve në bashkësi, ku nxënësit do të mund të mësojnë jashtë klasës
- Ndërlidhja me palët përkatëse, të cilat mund të futen në mësimin e grupeve vulnerable
- Krijimi i hartës së resurseve në bashkësi

**Metodat dhe veglat e nevojshme**

- Formular në të cilin nxënësit do t'i dokumentojnë mundësitë për mësim në bashkësi
- Telefonat e mençur (smartfonët) për dokumentim të fotografive dhe videove
- Formular për krijimin e skicave dhe “Hartës së resurseve të bashkësisë”

**Përshkrimi i aktivitetit:**

Identifikoni grupet e nxënësve të të gjitha klasave, të cilat do të jenë “skautët”(informatorët) tuaj gjatë zbulimit të mundësive për mësim në bashkësi. Hartoni një formular të thjeshtë, të cilin do ta përdorin për të shënuar se çka kanë zbuluar:

- Informacione themelore për mundësi të mësimin: Ku gjendet? Kush ose çka e siguron mundësinë për mësim (tekst i shkurtër, i plotësuar me fotografi, video ose audio dosje shkurtra të bëra me telefon të mençur)?



- Përshkrimi i asaj që mund të mësohet dhe pse është me rëndësi (sipas mundësisë të ndërlidhet me programin mësimor)
- Informacione për nxënësin, i cili ka dobi nga kjo mundësi e mësimi



**Fotografia 7: Këndi për lexim në bibliotekë**

Nxënësit tjerë le t'i vlerësojnë mundësitë për mësim dhe le t'i zgjedhin më të mirat prej tyre. Zhvilloni përshkrimet në skica të shkurtra, duke i dhënë të gjitha informacionet relevante për nxënësit tjerë. Vlerësoni sa kanë vullnet përfaqësuesit e bashkësisë të theksuar në skicat. Këto informacione mund t'i shndërroni në "Hartën e resurseve në bashkësi".

Më pas skicat e vogla ua jepni në dispozicion mësuesve, që t'i shfrytëzojnë në ndonjë ditë të caktuar në "mësim jashtë shkollës" ose si pjesë e programit të rregullt.

Nëse zgjedhet opsioni i dytë, përkujdesuni që vizitat të kenë një orar të caktuar, ndërsa anëtarët e bashkësisë të jenë të përgatitur, që t'i presin nxënësit tuaj në kohën e përzgjedhur.

**Informacione plotësuese dhe referenca:**

[5 hapat për bashkëpunim më të mirë mes shkollës dhe bashkësisë](#) nga Edutopia

**Aktiviteti shkollor 4: Ditë e hapur për mësim****Pse është me rëndësi?**

- Prindërit, të cilat kanë kaluar nëpër mësimin tradicional, duhet të fitojnë mundësi që të njoftohen me mënyrat e reja të mësimdhënies dhe mësimin, me qëllim që të angazhohen për mësim gjithëpërfshirës
- Prindërit e njoftuar me praktikën shkollore kanë mundësi më të mirë për mbështetje të fëmijëve në shtëpi

**Për çka bëhet fjalë?**

- T'u jepet mundësi prindërve dhe anëtarëve të bashkësisë për të vizituar shkollën tuaj dhe për të biseduar me nxënësit dhe të punësuarit, por edhe për t'u njoftuar me shkollën
- T'u jepet mundësi prindërve të parashirojnë pyetje pa fokus të posaçëm ndaj fëmijës së tyre

**Metodat dhe veçoritë e nevojshme**

- Do të varen nga aktivitetet, që i planifikoni
- Ushqimi dhe pijet gjithnjë janë një ndihmesë – secili le të kontribuojë, që të zvogëlohen shpenzimet

**Përshkrimi i aktivitetit:**

Takohuni me përfaqësuesit e prindërve, që të mësoni më shumë rreth perspektivave dhe interesave të tyre, kur bëhet fjalë për shkollën tuaj. Mund t'i përfshini ata në planifikimin e ditë së hapur ose thjesht t'i merrni parasysh këndvështrimet e tyre, kur do ta planifikoni ditën e hapur.

Dita e hapur në arsimin gjithëpërfshirës ofron mundësi për të dëshmuar se çka bëni dhe çka është me rëndësi për shkollën tuaj, por edhe drejtpërdrejt të komunikoni me nxënësit dhe me të punësuarit në një ambient, i cili nxit interaksion dhe shkëmbim. Dita mund të




përfshijë një program ose aktivitet, në të cilin të gjithë nxënësit do të prezantojnë diçka para prindërve, ose do të rrëfejnë tregime të ndryshme për mësim.

Nuk ekziston një protokoll se çka do të mund të vijojë, por mbani llogari që prindërit të mos trajtohen si nxënës, por si njerëz, të cilët e ndajnë përgjegjësinë për edukimin e fëmijëve, që ata të bëhen të pavarur dhe persona të pjekur dhe të përgjegjshëm për të shprehur talentin e tyre, t'i respektojnë të tjerët dhe të japin kontribut produktiv në shoqëri. Siguroni mundësi të ndryshme për kremtim të mësimit dhe pjesëmarrjes së nxënësve, por edhe të të arriturave të tyre si grup. Po ashtu edhe mundësi për biseda të detajuara rreth temave të interesit të posaçëm dhe shoqërimit joformal me nxënësit dhe të punësuarit (p.sh. gjatë ushqimit dhe pijes).

**Informacione plotësuese dhe referenca:**

[Shënim në Uikipedia për Shtëpinë e hapur në shkolla](#)

[Pesë hapat për planifikim të evenimentit të përkryer ndërmjet prindërve dhe mësuesve/aktivëve të mësuesve](#)



## 1.2 MËSUESIT GJITHËPËRFSHIRËS

### Sfondi

Ky kapitull fokusohet në aktivitetet, me të cilat do t'iu ndihmohet mësuesve dhe të punësuarve tjerë të përfshihen në zhvillimin profesional dhe të bëhen praktikues më gjithëpërfshirës.

### Informacione për përdoruesin

Trajnimi profesional i mësuesve nuk përfundon me aktin e diplomimit; ai është proces i mësimit gjatë gjithë jetës. Gjithnjë e më shumë shkollat shfrytëzojnë qasje të mësimit mes kolegëve për mbështetje të zhvillimit profesional. Trajnimi i vazhdueshëm bëhet më efektiv, nëse është drejtpërsëdrejti i ndërlidhur me praktikën, nëse siguron informacione kthyesë dhe inspirim për mënyra të reja të mësimit, interaksionit me të tjerët dhe planifikimit.

### Aktiviteti shkollor 1: Evaluimi ndërmjet kolegëve mes shkollave partnere



#### Pse është me rëndësi?

- Mësuesit më së shumti mësojnë, nëse marrin koment konstruktiv nga kolegët me përvojë dhe kur ndryshimet e propozuara janë drejtpërsëdrejti të ndërlidhura me praktikën e tyre rrjedhëse
- Mësuesit kanë dobi nga vizita e shkollave tjera dhe ekspozimi i ideve të reja, të cilat funksionojnë në praktikë

#### Për çka bëhet fjalë?

- Krijimi i partneriteteve me shkollat tjera për evaluim mes kolegëve
- Vizita e shkollave tjera dhe dhënia e informacioneve kthyesë në bazë të kornizës së përbashkët të indikatorëve

#### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Pyetësor ose listë e indikatorëve, të cilët janë zhvilluar bashkërisht nga të dy shkollat, ose vegël ekzistuese për vetëevaluim ose kornizë për shkollë gjithëpërfshirëse

# 26

#### Përshkrimi i aktivitetit:

Përcaktoni një shkollë partnere, e cila është e interesuar për shkëmbim të përvojave me ju, gjegjësisht është e hapur për mësime mes kolegëve dhe informacione kthyesë. Përkujdesuni që të gjithë mësuesit ta kuptojnë idenë për evaluim kolegjial dhe ndihmohuni të zhvillojnë interes, motivacion dhe qëndrim pozitiv.

Hartoni një kornizë, e cila do të shfrytëzohet në të dy shkollat për informacion kthyes. Definoni indikatorët, të cilët do t'i përdorni për mbikëqyrje dhe si bazë për intervista.

Përcaktoni ditët kur do ta vizitoni shkollën partnere dhe ditën, kur ta pritni në vizitë në shkollën tuaj. Zgjedhjeni një fokus, të cilit shkolla partnere duhet t'i kushtojë vëmendje të posaçme, por edhe indikatorë të cilët dëshironi të vlerësohen. Informoni shkollën partnere në lidhje me kornizën, gjegjësisht indikatorët konkretë që janë relevantë për ju. Kur ju ta vizitoni shkollën e tyre, kërkoni prej tyre të njëjtat informacione.

Plani i rekomanduar për evaluim kolegjal:

- Takim me të gjithë pjesëmarrësit dhe informuesit kyç të shkollës fqinje, me qëllim që gjithë të informohen rreth orarit të ditës, të njoftohen mes vete dhe të potencohen qëllimet kryesore të vizitës.
- Planifikimi i vizitave të klasave në grupe të vogla dhe vizitave në evenimente dhe lokacione tjera (p.sh. bibliotekë, laborator të shkollës, orkestër të shkollës)
- Mundësimi i takimit ndërmjet kolegëve-evaluuesve dhe shkëmbimit të përshtypjeve mes tyre
- Organizimi i takimit për informacion kthyes, ku shkolla partnere do t'i ndajë me te tjerët observimet dhe përshtypjet e veta
- Diskutim përfundimtar për zhvillim të ideve rreth përmirësimit të gjendjes ose përgjigje të çështjeve të iniciuara
- Përfundimi i ditës me takim joformal dhe shkëmbimi i përvojave – mund të ketë pijë dhe ushqim

### **Informacione plotësuese dhe referenca:**

[Blick über den Zaun](#) – Rrjet i shkollave të përfshira në revizione të rregullta kolegji, ku ka [material dhe standarde](#) për revizion kolegjal (vetëm në gjuhën gjermane)

Informacione për [Programin për revizione kolegji](#) nga

<https://www.ssaturk.co.uk/> Rrjeti i shkollave, nxënësve dhe mësuesve.

[Informacione për revizione kolegji](#) të shkollave, të siguruar nga Instituti për arsim i Kolegjit Universitar në Londër

## Aktiviteti shkollor 2: Informacione kthyesë mes kolegëve mësues



### Pse është me rëndësi?

- Mësuesit gjithëpërfshirës janë nxënës gjatë gjithë jetës, ata janë të interesuar për përmirësimin e praktikave të tyre dhe janë të hapur për informacione kthyesë. Ky qëndrim duhet të kultivohet dhe mbështetet nëpër shkolla
- Informacionet kthyesë të drejtpërdrejta për praktikën janë mënyra me efektive për mësim dhe kanë ndikim të drejtpërdrejt pozitiv ndaj suksesit të nxënësve

### Për çka bëhet fjalë?

- Mësuesit përfshihen në praktika mësimore të kolegëve të tyre, që edhe vetë të mësojnë, por edhe t'iu ndihmojnë të tjerëve të mësojnë dhe t'i përmirësojnë metodat e tyre mësimore në bazë të informacioneve kthyesë
- Mësuesit fokusohen në bazë të përmirësimit të praktikave si përpjekje e përbashkët për t'iu mundësuar të gjithë fëmijëve të mësojnë, e jo t'i kritikojnë kolegët tyre

### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Mikro-mësimi përcakton mundësi për incizim të një pjesë të orës (p.sh. me telefon të mençur)
- Pyetësor ose formular për mbikëqyrje të orës, që t'i jepet fokus informacionit kthyes

### Përshkrimi i aktivitetit:

Nëse dëshironi të zbatoni mikro-mësimdhënie, atëherë mund të shërbehëni me disa ide. Fillimisht zgjedhni qasjen ose metodën e mësimdhënies, të cilën dëshironi ta përmirësoni dhe ta zbatoni më shpesh në të ardhmen. Përgatitni një pjesë të orës, ndoshta vetëm me disa nxënës, e jo me gjithë klasën dhe prezantoni para një grupi të vogël të kolegëve. Lusni njërin nga kolegët, ta incizojë orën me smart phone.

Takohuni me kolegët dhe informoni për qëllimet tuaja, si dhe pse mendoni se kjo është qasje inovative ose ndoshta edhe mundësi për përmirësim të mësimdhënies suaj. Dëgjoni komentet e tyre dhe bisedoni se si mund të përmirësohet praktika.

Provoni qasjen e përmirësuar me grup tjetër të vogël të nxënësve – ose lejoni ndonjërin nga kolegët tuaj ta drejtojë procesin. Nëse është e mundur, inçizojeni edhe këtë pjesë të orës.

Takohuni përsëri dhe bisedoni rreth përmirësimeve. Shënoni komentet për praktikën më të suksesshme, por edhe mundësitë e mundshme dhe problemet, që duhet të evitohen.

Përgatitini një dosje të përbashkët me metoda më të suksesshme mësimore, të cilat bashkërisht i keni provuar dhe i keni zhvilluar, me qëllim që ju dhe kolegët tuaj t'i shfrytëzoni më tej.

### **Informacione plotësuese dhe referenca:**

Shënim nga Uikipedia për [Mikro-mësimdhënien](#)

Informacione për [Xhon Heti dhe mikro-mësimdhënien](#) nga IRIS Connect

[Formular për evaluim kolegjal](#) të mësimdhënies në klasë, i hartuar nga Universiteti Shtetëror i Oregonit

### **Aktiviteti shkollor 3: Orët e përbashkëta për të ligjruar atë për çka jeni të spikatur- shkëmbimi i praktikave të mira Përshkrimi i aktivitetit:**



#### **Pse është me rëndësi?**

- Mësuesit mësojnë në mënyrë më efektive nga kolegët e tyre, kur ligjërojnë bashkërisht, për shkak se do të mund në mënyrë të drejtpërdrejtë ta mbikëqyrin dhe ta ndajnë përvojën me të tjerët
- Shkëmbimi i praktikave të mira është mënyrë pozitive për mësim të të gjithë palëve të përfshira

#### **Për çka bëhet fjalë?**

- Praktikimi i metodave të mësimdhënies së përbashkët dhe njëkohësisht mësimi i ndonjë gjëje të re
- Mendimi për mësim të përbashkët dhe gjetja e mënyrave për përmirësim

#### **Metodat dhe veglat e nevojshme**

- Indikatorë të cilësisë për bashkëpunim për shkak të kahjeve në diskutimet tuaja

Merruni vesh me kolegët për realizim të përbashkët të orës, ashtu që do të mësoni nga njëri tjetri për qasje të ndryshme. Krijoni mjedise të ndryshme, në të cilat nxënësit do të mësojnë në mënyrë të pavarur (të mbikëqyrur nga një mësues dhe një ndihmës mësues ose prind), që edhe mësuesit tjerë të inkurajohen dhe ta zbatojnë mësim të përbashkët.

Zgjedheni një temë ose një qasje mësimore, e cila ju intereson juve dhe kolegëve tuaj, me të cilët do të përfshihen në diçka, që jeni të spikatur si ekspert. Së bashku me kolegun, planifikoni orën që më së miri ta plotësoni njëri tjetrin me profesionalizmin e ndërsjellë.

Zgjedheni një qasje të mësimit të përbashkët, që më së miri përputhet me atë që dëshironi ta bëni dhe ta arrini. Mund të zbatoni:

- Mësim në stacione: Mësuesit dhe nxënësit (këtu edhe nxënësit mund të jenë në rolin e mësuesve) ndahen në stacione të ndryshme dhe pastaj bëjnë rotacion, në mënyrë që të gjithë nxënësit të përfshihen në të gjitha aktivitetet e stacioneve të ndryshme.
- Mësimi paralel: Mësuesit ligjërojnë në dy grupe paralelisht me gjysmën e klasës, ose përmbajtjen e njëjtë, ose me përmbajtje plotësuese. Nëse përmbajtja është plotësuese, atëherë nxënësve duhet t'iu jepet kohë, që ta ndajnë mes vete atë që e kanë mësuar.
- Mësimi alternativ: Njëri mësues iu ligjëron më shumë nxënësve në klasë, ndërsa mësuesi tjetër punon me një grup të vogël, për ta realizuar një detyrë konkrete. Grupimi mund të bëhet në bazë të interesit, suksesit ose problemeve konkrete, të cilat duhet të zgjidhen.
- Mësimi ekipor: Të dy mësuesit e ndajnë përgjegjësinë e përbashkët për mësim në klasë, ndoshta duke u fokusuar në mënyra të ndryshme të prezantimit të temës (auditiv, vizual) ose përmes marrjes së roleve të ndryshme (instrukturë, trajner).

Realizojeni orën e përbashkët sipas planit e pastaj diskutoni për të. Bashkërisht mendoni për opsione tjera të mësimit të përbashkët. Këto aktivitete mund t'i planifikoni edhe në kuadër të punës e Aktiveve profesionale ose Bashkësive mësimore.

### **Informacione plotësuese dhe referenca:**

Informator për [Efikasitet më të madh të mbështetjes së klasës](#) nga [Rrjeti i shkollave gjithëpërfshirëse](#)

## Aktiviteti shkollor 4: Pasqyrimi i mësimit të përbashkët



### Pse është me rëndësi?

- Çdo person i ri në klasë mund të shfrytëzohet në mënyrë efektive ose në mënyrë joefektive; duke u fokusuar në praktikat e mësimit të përbashkët, mund ta përmirësoni efikasitetin e mësimit dhe mbështetjen e posaçme

### Për çka bëhet fjalë?

- Njoftohuni me vokabularin, të cilin mund ta përdorni me personin tjetër në klasë, me qëllim që t'i vlerësoni metodat tuaja të mësimit të përbashkët dhe të diskutoni në lidhje me përmirësimet

### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Lista e qasjeve të ndryshme ndaj mësimit të përbashkët e dhënë në aktivitetin 3
- Protokoli i mbikëqyrjes (shih në informacione plotësuese)

### Përshkrimi i aktivitetit:

Mendoni për personat, të cilët punojnë me ju dhe kalojnë kohë në klasën tuaj, p.sh. edukatorët e specializuar (defektologët), asistentët e mësuesve etj.

Shfrytëzoni protokoll për mbikëqyrje më të lehtë, që të jeni të sigurt se kolegu juaj dhe ju do të fokusoheni në aspektet e mësimit, që janë relevante për të dy.

Pas përfundimit të orës, shkëmbeni përshtypjet dhe observimet. Bisedoni lidhur me mënyrat se si do të mund të përmirësohen praktikat tuaja të përbashkëta mësimore.

### Informacione plotësuese dhe referenca:

[Mësimi kolaborativ/Protokoli për mbështetjen dhe lehtësimin e mbikëqyrjes](#) është hartuar nga [Rrjeti i shkollave gjithëpërfshirëse](#).


## 1.3 BASHKËPUNIMI ME TË TJERËT

### Sfondi

Ky kapitull fokusohet në aktivitete, të cilat ndihmojnë në përmirësimin e bashkëpunimit ndërmjet grupeve të ndryshme të palëve përkatëse; ndërmjet nxënësve dhe prindërve, ndërmjet mësuesve dhe nxënësve, ndërmjet gjithë palëve përkatëse të nevojshme për të trajtuar ndonjë çështje ose problem të madh në shkollë dhe në bashkësi. Këto aktivitete shërbejnë për përmirësimin e marrëdhënieve në luftën kundër dhunës, përjashtimit dhe diskriminimit, me të cilat goditen fëmijë ose grupet e caktuara në jetën e përditshme shkollore.

### Informacione për përdoruesin

Aktivitetet e përfshira në këtë kapitull ofrojnë shembuj të praktikës së mirë në sferën e bashkëpunimit ndërmjet grupeve të ndryshme përkatëse ose ndërmjet nxënësve të klasave dhe moshave të ndryshme. Hartimi i kartës së shkollës është i dobishëm në sferat, në të cilat problemet e mëdha do të mund të zgjidhen vetëm nëse të gjitha palët përkatëse në shkollë dhe jashtë saj do të kontribuojnë në zgjidhjen e tyre. Dhuna në shkollë është zgjedhur si shembull, mirëpo ndoshta për shkollën tuaj ekziston ndonjë problem tjetër më i rëndësishëm.





## Aktiviteti shkollor 1: Sistemi i mbështetjes nga bashkëmoshatarët



### Pse është me rëndësi?

- Shfrytëzimi i shokëve ose ndihmësve të moshës së njëjtë është i dobishëm për të gjithë fëmijët e shkollës
- Kur fëmijët mësojnë shkathtësi sociale ose akademike, përmirësohet aftësia e tyre për mësim
- Fëmijët me vështirësi i mbikëqyrin shkathtësitë relevante të modeluara në mënyrë efektive nga të tjerë

### Për çka bëhet fjalë?

- T'iu ndihmohet fëmijëve të lidhen me fëmijët tjerë, të cilët kanë përvojë më të madhe ose më të vogël
- Fëmijët t'i dëgjojnë shpjegimet e gjërave me gjuhën e tyre
- Grupimi i fëmijëve në çifte, në mënyrë që të dy fëmijët të kenë dobi
- Zhvillimi i miqësive ndërmjet fëmijëve
- Lehtësimi i kalimit nga kopshti në shkollë ose nga klasa në klasë

### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Korniza për të vendosur sistem të mbështetjes ndërmjet bashkëmoshatarëve në shkollën tuaj
- Material informativ për prindërit

### Përshkrimi i aktivitetit:

Përcaktojeni situatën ose problemin, të cilin dëshironi ta zgjidhni përmes vënies së sistemit të mbështetjes ndërmjet bashkëmoshatarëve, për shembull përmes:

- Pritjes së nxënësve të rinj të shkollës suaj nga nxënësit e klasave më të larta, me qëllim të tranzicionit më të lehtë
- Një kohe të caktuar brenda javës, në të cilën nxënësit më të rritur iu ndihmojnë nxënësve më të vegjël në kryerjen e detyrave të shtëpisë
- Asistentëve bashkëmoshatarë për fëmijët me aftësi të kufizuar ose me probleme të sjelljes

Potenconi fëmijët, të cilët do të ofrojnë mbështetje për qëllimin, që e keni identifikuar dhe trajtoni ata si për shembull:

- Për metodat e zgjidhjes së qetë të konflikteve dhe për shkathtësitë sociale (p.sh., të bërit shokë)

- Për mënyrat për t'iu ndihmuar fëmijëve të vegjël ose fëmijëve me aftësi të kufizuara
- Për detyra konkrete dhe rutinat shkollore, me të cilat duhet të njoftohen nxënësit e rinj

Bashkoni fëmijët më të rinj ose fëmijët më pak me përvojë, që t'i motivoni, t'i udhëzoni dhe t'i informoni në lidhje me qëllimin e mbështetjes dhe rolit të tyre.

Ndiqeni përparimin, planifikoni takimet me nxënësit dhe nëse është e nevojshme bëni ndonjë ndryshim.

**Informacione plotësuese dhe referenca:**

Shënim në Uikipedia për [Sistemin e "miqve/ortakëve"](#)

[Planifikimi dhe implementimi i sistemeve për mbështetje të bashkëmoshatarëve](#)

– proces në gjashtë hapa nga [Rrjeti i shkollave gjithëpërfshirëse](#)

[Materiale për mësim të shkathtësive jetësore](#) – Familjet dhe fëmijët

në projektin arsimor



## Aktiviteti shkollor 2: Bashkëpunimi me prindërit



### Pse është me rëndësi?

- Zhvillimi i marrëdhënieve me prindërit, respektimi i diversitetit kulturor dhe gjuhësor të prindërve
- Vlerësimi i poezisë jashtë programit mësimor të gjuhës mësimore

### Për çka bëhet fjalë?

- Planifikimi dhe organizimi i evenimenteve zbavitëse me prindërit dhe nxënësit
- Dhënia mundësi fëmijëve dhe prindërve, që bashkërisht të përfshihen në aktivitetet letrare

### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Ftesat për prindërit për të dy projektet të shënuara në disa gjuhë, shkrimi i poezive me fëmijët si përgatitje për “Kafenenë botërore”

### Përshkrimi i aktivitetit:

Të dy shembujt ilustronë se si prindërit do të mund të përfshihen në shkollë. Aktiviteti i parë fokusohet në begatinë gjuhësore, që familjet i sjellin shkollës dhe mënyra e krenimit të këtij diversiteti linguistik, ndërsa aktiviteti i dytë i bashkon prindërit dhe fëmijët përmes përvojës së përbashkët të kënaqësisë së shoqërimit me poezi. Përpos në shkollat, në të cilat mësimi zhvillohet në gjuhë të ndryshme, këto aktivitete mund të zbatohen edhe në shkollat tjera në kuadër të aktiviteteve për integrim ndëretnik me shkollat partnere.

### Aktiviteti 1: Më rrëfe një tregim

Në kopsht ose në shkollë prindërit rrëfejnë tregime në gjuhë të ndryshme. Qëllimet kryesore të aktivitetit janë:

- Të demonstronhet dhe ilustronhet diversiteti i gjuhëve, të cilat i flasin nxënësit e shkollës suaj
- Të transformohet shkrimi leximi nga diçka që mësohet në shkollë në diçka të përbashkët për të rriturit dhe fëmijët
- Të theksohet dhe të ilustronhet rëndësia e prindërve për zhvillim të gjuhës së fëmijëve

## Aktiviteti 2: Kafeneja botërore

- Nxënësit shkruajnë poezi në gjuhë të ndryshme dhe i prezantojnë ato para prindërve, miqve dhe gjyshërve në “Kafenenë botërore”. Prindërit mund të “porosisin” ndonjë këngë nga menyja së bashku me ndonjë çaj ose kafe. Qëllimet kryesore të këtij aktiviteti janë:
- Zhvillimi i shkathtësive të fëmijëve për shkrim në gjuhë të ndryshme
- Ilustrimi dhe kremtimi i diversitetit gjuhësor në klasë
- Krijimi i atmosferës së këndshme për mësim

### Informacione plotësuese dhe referenca:

Broshura dhe uebianr 13 i UNICEF-it [Pjesëmarrja e prindërve, familjeve dhe komunitetit në arimimin inkluziv](#)

## Aktiviteti shkollor 3: Bashkëpunimi me nxënësit: Bashkësia e nxënësve



### Pse është me rëndësi?

- Me rëndësi është që të dëgjohet zëri i fëmijëve për çështjet që kanë të bëjnë me shkollën
- Formimi dhe pjesëmarrja në Bashkësinë shkollore iu ofron fëmijëve përvojë reale për mënyrën se si funksionon demokracia

### Për çka bëhet fjalë?

- Krijimi i një platforme, në të cilën fëmijët marrin pjesë në marrjen e vendimeve edhe jashtë klasës
- Dëgjimi i zërit të nxënësve dhe ekzistimi i partnerit gjatë planifikimit të evenimenteve të mëdha shkollore ose të reformave

### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Organogrami dhe/ose rregullorja me të cilën përcaktohet puna e Këshillit të nxënësve
- Tabela e shpalljeve e këshillit të nxënësve ose mjete tjera për komunikim me të gjithë nxënësit (p.sh. blogu, posta elektronike për ide të nxënësve etj.)

# 36

### Përshkrimi i aktivitetit:

Format e pjesëmarrjes institucionale të nxënësve në marrjen e vendimeve në sisteme të ndryshme arsimore mund të hasen të emërtuara edhe si këshilla të nxënësve, konferenca të fëmijëve ose kuvende të fëmijëve.

Secila klasë duhet të jetë e përfaqësuar në Bashkësinë e shkollës me së paku një, ose eventualisht me dy anëtarë. Këtë delegacion e zgjedhin të gjithë nxënësit e klasës, që t'i përfaqësojë ata.

Me rëndësi është të publikohen rregullat sipas së cilave funksionon Bashkësia e shkollës.


Ftoni një përfaqësues të bashkësisë së shkollës në takimet e rëndësishme, në të cilat merren vendime, të cilat kanë të bëjnë me të gjithë nxënësit. Anëtarët e bashkësisë së shkollës duhet të kenë mundësi të iniciojnë çështje në interes të tyre, të cilat do të vendosen në rendin e ditës së mbledhjeve tuaja profesionale.

Organizoni procesin, në të cilin të gjithë nxënësit do të mund t'i drejtohen bashkësisë së shkollës, nëse kanë interes ose problem të posaçëm. Mund të instaloni një kuti postare, ku do të vendosen deklarata me shkrim ose do t'i ndihmoni bashkësisë së shkollës të krijojë blog për komunikim me të gjithë nxënësit dhe të pranojë komente prej tyre.

#### **Informacione plotësuese dhe referenca:**

[Idetë për këshillin e nxënësve](#) nga Këshilli i nxënësve Pro

[Shkolla: Bashkësia mësimore demokratike](#) e Këshillit të Evropës



## Aktiviteti shkollor 4: Krijimi i fushatës shkollore kundër dhunës



### Pse është me rëndësi?

- Fëmijët luajnë rol vendimtar dhe të fuqishëm në luftën kundër dhunës në shkolla, andaj duhet në mënyrë aktive të kontribuojnë në çdo fushatë të iniciuar në shkollën tuaj
- Dhuna është mostër e interaksionit, andaj duhet të transformohet vetë interaksioni, e jo individët

### Për çka bëhet fjalë?

- Fjala është për të gjitha format e dhunës; ajo verbale, fizike, psikologjike dhe sociale. Këtu bëhet fjalë për rolet implicite shoqërore dhe mënyra se si ato të zbatohen, por edhe mënyrat paqësore dhe miqësore për zgjidhje të konflikteve.
- Fokusi është vënë në pjesëmarrjen aktive dhe angazhimin e fëmijëve në parandalimin e dhunës në shkolla, ashtu që të gjithë fëmijët do t'i gëzojnë të drejtat e tyre dhe do të ndjehen të sigurtë në shkolla.

### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Hartimi i kodit të sjelljes/rregullores së shkollës, e cila vlen për të gjitha palët përkatëse (mësues, prindër, nxënës) – ose nëse veç më ekziston, atëherë le të zbatohet plotësisht

### Përshkrimi i aktivitetit:

Zhvilloni një diskutim të vogël me nxënësit, që t'i shpjegojnë përvojat e tyre me dhunën, qoftë në rolin viktimës ose në rolin e dhunuesit. Mund të kombinohen nxënësit e klasave dhe moshave të ndryshme, ndërsa më vonë nxënësit më të mëdhenj mund t'i zhvillojnë diskutimet dhe të marrin shënime.

Zgjedheni një rezymë ose pasqyrë të pyetjeve të përmendura nga nxënësit, duke i përfshirë edhe të gjithë format e dhunës në klasë, në oborrin e shkollës ose në rrugën drejt shkollës. Ekspozoni ato në atë mënyrë që nxënësit të mund të ndërlidhen dhe të ndjekin.

Nxënësit, mësuesit dhe prindërit le të zhvillojnë skenarë për mënyrën se si do të mund të zgjidhen këto pyetje. Organizoni takime në të cilat mësuesit, nxënësit dhe prindërit do të bisedojnë për ta në grupe të vogla, do të komentojnë dhe do t'u japin prioritet ideve dhe aktiviteteve të mundshme.

Shfrytëzoni ide të projekteve të etabluara ose përvoja të shkollave, të cilat kanë realizuar projekte kundër dhunës.

Hartoni një plan aksionar për aktivitetet e ardhshme, dhe një kod të sjelljes/rregullore të shkollës si referencë për të gjitha palët përkatëse. Filloni me implementimin e planit aksionar dhe përkujdesuni që të përfshihen të gjitha grupet e palëve përkatëse dhe rregullisht kontrolloni përparimin në raport me planin.

**Informacione plotësuese dhe referenca:**

[Shkolla pa dhunë](#) Projekte në Serbi

[Ndërprerja e dhunës në shkolla – Udhëzues për mësues](#) i hartuar nga UNESCO



## 1. 4. RESPEKTIMI I DIVERSITETIT TË NXËNËSVE – FOKUSI NË IDENTITET

### Sfondi

Respektimi i diversitetit të të gjithë nxënësit dhe familjet e tyre paraqet porosi, e cila gjithashtu duhet të përhapet në shkollë, e jo vetëm në klasë. Në këtë rast vizioni përcakton që të gjithë nxënësit duhet të respektohen si personalitete, varësisht nga mënyra se sa përputhen mirë në rolin e nxënësit të përkryer në klasën tradicionale.

### Informacione për përdoruesin

Aktivitetet e përfshira në këtë kapitull ofrojnë shembuj për mënyrën se si gjërat mund të bëhet në shkollë, me qëllim që të ngrihet vetëdija në lidhje me dallimet kulturore, gjuhësore dhe ato të sjelljes, gjegjësisht të përvetësohet këndvështrimi i të tjerëve. Aftësitë e këtyra janë të nevojshme për zhvillim të respektit ndaj fëmijëve tjerë, në veçanti ndaj fëmijëve të grupeve pakicë. Këto aktivitete synojnë t'i mundësojnë fëmijëve ta përjetojnë dhe hulumtojnë identitetin e tyre dhe atë të fëmijëve tjerë. Qëllimi tjetër i përgjithshëm është që të rishikohen paragjykimet dhe të zhvillohet toleranca.

### Aktiviteti shkollor 1: Ne dhe bota – fokusi në paragjykimet



#### Pse është me rëndësi?

- Fëmijët mendojnë për etnocentrizmin dhe eurocentrizmin dhe mësohen ta shohin botën nga një kënd tjetër

#### Për çka bëhet fjalë?

- Ndryshimi i këndvështrimit, që të ndihmohet në lidhje me paragjykimet dhe të zhvillohen njohuri të reja përmes përvetësimit të këndvështrimeve të reja
- Inkurajimi i fëmijëve për të menduar më ndryshe

#### Metodat dhe veglat e nevojshme


- Harta e botës e dhënë mbrapsht, një glob, letër dhe laps për të vizatuar hartën personale të botës

### Përshkrimi i aktivitetit:

Prezantoni hartën e botës të dhënë mbrapsht dhe bisedoni me nxënësit për atë që dallon nga hartat tjera, të cilat veç më i njohin. Përgjigjet mund t'i gjeni në tabelë. Kërkoni nga nxënësit ta gjejnë vendin e tyre në hartë. Pse është më vështirë të gjejnë vendin e tyre në këtë hartë? Pse tani Australia është në mes të hartës?



Nxënësit formojnë grupe dhe vizatojnë një hartë nga një këndvështrim tjetër (p.sh. nga këndvështrimi i astronautëve, nga këndvështrimi i banorëve indigjen të Perusë etj). Në fund të aktivitetit, ekspozohen hartat në klasë, ndërsa grupet e nxënësve i shikojnë ato dhe përpiqen ta zbulojnë këndvështrimin e dhënë.



Fotografia 8: Harta e botës e dhënë mbrapsht (<http://odt.org/Pictures/sideb.jpg>)

### Informacione plotësuese dhe referenca:

[Harta e botës e dhënë mbrapsht](#) nga [Mënyrat e reja për ta parë botën](#)

[Madhësia e vërtetë e Afrikës](#) – në krahasim me 100 shtetet më të mëdha

Shfrytëzoni harta të vendit tuaj ose të rajonit nëpër periudha të ndryshme ndër shekuj

## Aktiviteti shkollor 2: Pa faj - rivlerësimi i sjelljes



### Pse është me rëndësi?

- “Pa faj” – nënkupton qasjen pozitive drejt zgjidhjes së sjelljes problematike, në veçanti në rast të mobingut
- Vënia e qasjes koherente e ndihmon komunikimin ndërmjet grupeve të palëve përkatëse

### Për çka bëhet fjalë?

- Në vend se te dënohet fëmija dhunues, nxiten diskutimet me nxënësit në lidhje me zanafillën e sjelljes së tij, gjegjësisht gjetjes së përbashkët të mënyrave për ndryshim të sjelljes.
- Grupi për mbështetje (mbikëqyrës, të papërfshirë, të përfshirë në maltretim) i përcaktuar nga viktimja dhe mësuesi ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve, duke mos e akuzuar dhunuesin

### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Nuk janë të nevojshme

### Përshkrimi i aktivitetit:

Ekzistojnë pesë hapa për qasje në grupin e mbështetjes. Në fakt ky është një proces i identifikimit të grupit të nxënësve, të cilët mund të ndihmojnë në zgjidhjen e problemit, me të cilin përballet fëmija në shkollës. Viktimë mund të jetë fëmija i grupit pakicë ose fëmija me aftësi të kufizuar. Në veçanti fëmijët me autizëm ose problemet tjera në sjelljen sociale mund të jenë të ekspozuar në dhunë. Kjo qasje është në veçanti e dobishme për këto raste, për shkak se me të vërtetë sjellja e viktimës krijon probleme për fëmijët tjerë.

#### Hapi 1: Bisedë me viktimën

Biseda me viktimën duhet të përqendrohet në gjërat, që kanë ndodhur, në vend se në të fokusohet në incidentin konkret. Gjithçka që dëshiron të thotë viktimja, duhet të dëgjohet, duke mos ia gjykuar pohimet. Fjala është për besimin e viktimës se problemi mund të zgjidhet pasi të shpaloset rasti. Viktimja e tregon me emër dhunuesin ose dhunuesit, vrojtuesit dhe nxënësit, për të cilët mendon se e mbështesin ose nxënësit, që dëshiron t'i bëjë shokë.

#### Hapi 2: Krijimi i grupit të mbështetjes

Prej këtyre emrave formohet grupi për mbështetje, duke i përfshirë edhe dhunuesit, disa vrojtues dhe mbështetës. Mësuesi, gjegjësisht trajnuesi takohet ndaras me grupin dhe shpjegon se shokët, dhunuesit dhe

mbikëqyrësit janë zgjedhur, që të ndihmojnë si dhe flet për viktimën dhe për arsyen pse ai/ajo është i/e palumtur në shkollë. Me rëndësi është që askush të mos gjykohet për atë që ka ndodhur, që të krijohet atmosferë e hapur për motivim të grupit për të gjetur zgjidhje. Anëtarët e grupit për mbështetje duhet të nxiten ta shpjegojnë përvojën e tyre të të qenit të pakënaqur në shkollë.

### Hapi 3: Përgatitja e planit

Mësuesi, gjegjësisht trajnuesi shpjegon se askush nuk duhet të ndjehet i palumtur në shkollë. Më siguri anëtarët e grupit për mbështetje kanë përvoja të veta, andaj i ftojnë nxënësit të potencojnë shkaqe se pse fëmijët mund të ndjehen të palumtur në shkollë. Pasi të potencohet shkaqet, grupi lutet që të jep propozime për mënyrën se si mund të zgjidhen problemet. Në bazë të propozimeve, grupi përgatit plan për zgjidhjen e problemit. Arrihet marrëveshje, që grupi ta realizojë planin në periudhë të caktuar kohore (p.sh. për një javë) dhe të raportojë në fund të aktivitetit. Me rëndësi është që grupi të konsiderojë se procedurat janë ekskluzivisht të tyre, në vend se mësuesi ose trajnuesi t'u tregojë se çka duhet të bëjnë.

Hapi 4: Grupi për mbështetje e realizon planin

Në bazë të asaj që ka vendosur grupi të bëjë, të gjithë anëtarët e mbështesin njëri tjetrin në aktivitete, të cilat janë të kahëzuara drejt përmirësimit të gjendjes së viktimës dhe të çdo personi tjetër. Mësuesit ose trajnuesit ofrojnë ndihmë sipas nevojës, ndërsa grupi e përshëndet mbështetjen e tillë.

### Hapi 5: Pasqyrimi i gjendjes

Grupi i mbështetjes dhe viktimat referojnë dhe i shqyrtojnë përvojat e tyre. Varësisht nga situata, ky referim mund të bëhet së bashku ose ndaras. Po ashtu, në këtë segment mund të përfshihen prindërit, për shkak se mësuesit do të dëshirojnë të dinë, nëse është përmirësuar situata nga këndvështrimi i tyre. Këta pesë hapa mund të përsëriten derisa problemi të zgjidhet plotësisht.

### Informacionet plotësuese dhe referencat:

Video e qasjes "Pa faj": <https://www.youtube.com/watch?v=USpkl4Lr-w>  
Jang, C. (2011). [Zgjidhja për maltretimet në shkolla dhe ndihma e grupit të mbështetjes](#). Psikologjia arsimore në praktikë, 14(1), 32-39.

### Aktiviteti shkollor 3: Shkruaj këngë për veten



#### Pse është me rëndësi?

- Nxënësit mendojnë për diversitetin mes tyre dhe theksojnë, se çka është me rëndësi për identitetin e tyre
- Poezia i tejkalon rregullat, të cilat vlejné për zhanret e ndryshme të letërsisë dhe paraqet mjet të fuqishëm të shprehur, madje edhe kur përdoret gjuha e thjeshtë

#### Për çka bëhet fjalë?

- Nxënësit shkruajnë poezi “Pse jam i/e këtillë?”, që ta përjetojnë diversitetin mes tyre.
- Struktura e poezisë e përcaktuar paraprakisht iu mundëson nxënësve me vështirësi në mësim, që të shkruajnë tekst kreativ

#### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Letra, stilografi dhe struktura e poezisë

#### Përshkrimi i aktivitetit:

Nxënësit shkruajnë poezinë “Pse jam i/e këtillë”, ose “Unë jam”, që ta përjetojnë diversitetin e tyre personal. Struktura e përcaktuar e poezisë iu mundëson nxënësve me vështirësi gjatë mësimit, që të shkruajnë një tekst kreativ. Nxënësit mund t’i lexojné poezitë para të gjithëve, ose t’i varin ato në mur. Mundësia tjetër është që poezitë të varen në mur, kurse nxënësit të zbulojné se kush i ka shkruar. Ky aktiviteti iu mundëson mësuesve dhe nxënësve të bisedojné për aspekte të ndryshme të identitetit dhe përvojave jetësore.

Nxënësit mund të shkruajnë për ndjenjat negative të vetmisë, depresionit ose pikëllimit. Në këto raste me rëndësi është që mësuesi personalisht të kontaktojë me nxënësin, që t’i hulumtojë këto ndjenja dhe të gjejë mënyra për përmirësimin e gjendjes së fëmijës.

Shembull i  
një poezi të  
shkruar nga  
E., 14 vjeçare

Fotografia 9:  
Struktura e  
poezisë  
„Pse jam ...“

Why am I like this?  
I am like this, because .....  
I am like this, because .....  
I am like this - . . .  
- . . .

#### Why am I like this?

Am I like this because I`m a girl?

Am I like this because I`m a teenager?

Am I like this because I`m sometimes crazy?

Am I like this because I love music?

Am I like this because I`m an artist?

Am I like this because I`m a patchwork?

Am I like this because I like to travel?

... I don`t want to grow up?

... I love stories?

... I`m vegetarian?

... I hate sometimes everything.

... I`m sometimes a dreamer and sometimes a realist?

Yes, I am like this because of all these things.

#### Pse jam e këtillë?

A jam e këtillë sepse jam vajzë?

A jam e këtillë sepse jam tinejxhere?

A jam e këtillë sepse nganjëherë çmendem?

A jam e këtillë sepse e dua muzikën?

A jam e këtillë sepse jam artiste?

A jam e këtillë sepse jam me lecka?

A jam e këtillë sepse dua të udhëtoj?

... nuk dua të rritem?

... dua tregime?

... jam vegjetariane?

... nganjëherë urrej gjithçka?

... nganjëherë jam ëndërrimtare e nganjëherë reale?

Po, e këtillë jam për shkak të gjithave këtyre gjërave.

**Struktura e poezisë “Unë jam” (nga Laura Frata, marrë nga [Pinterest.ch](https://www.pinterest.ch)):**

**Strofa e parë:**

Unë jam (1-2 gjëra të posaçme për ty)  
 Pyetem (ndonjë gjë për çka je kureshtar/e)  
 Dëgjoj (ndonjë zë)  
 Shikoj (gjithçka që sheh)  
 Dëshiroj (diçka, që me të vërtetë dëshiron)  
 Unë jam (përsërite vargun e parë të poezisë)

**Strofa e dytë:**

Shtirem (diçka që shtiresh se bën ose je)  
 Ndjej (ndjenjën e fuqishme, që ke)  
 Prek (ndonjë person, vend ose gjësend)  
 Më shqetëson (diçka që të pengon)  
 Qaj (diçka që të bën të mërziur)  
 Unë jam (përsërite vargun e parë të poezisë)

**Strofa e tretë:**

Kuptoj (diçka, që ka kuptim për ty)  
 Them (diçka që beson për veten)  
 Ëndërroj (gjënë që ëndërron ti)  
 Përpiqem (diçka që t'i me të vërtetë përpiqesh)  
 Shpresoj (diçka që t'i me të vërtetë shpreson)  
 Unë jam (përsërite vargun e parë të poezisë)

**Informacione plotësuese dhe referenca:**

[Idetë për mësimdhënie të poezisë](#) nga Këshilli Britanik dhe BBC

**Aktiviteti shkollor 4: Bëjeni të dukshëm diversitetin gjuhësor!**



**Pse është me rëndësi?**

- Vlerësimi dhe respektimi i identitetit kulturo-gjuhësor të nxënësve e ndihmon pjesëmarrjen në aktivitetet shkollore, për shkak të ndjenjës më të fuqishme të përkatësisë
- Vetëdija për qëndrimet e ndryshme dhe mënyrat e të menduarit e përmirësojnë komunikimin e bashkëpunimit

**Për çka bëhet fjalë?**

- Nxënësit mendojnë për rëndësinë e gjuhëve të ndryshme, të cilat i njohin, gjegjësisht për mënyrën se si janë të ndërlidhura me aspektet e ndryshme të përvojave të tyre dhe historinë personale

**Metodat dhe veglat e nevojshme**

- Letër, stilograf dhe model (siluetë) të vajzës ose djalit




**Përshkrimi i aktivitetit:**

Ky aktivitet mund të shërbejë si hyrje në aktivitetet tjera të diversitetit gjuhësor. Mësuesi bën hyrje të shkurtër për të gjitha gjuhët për rreth nesh, për gjuhët që i njohim nga shtëpia (p.sh. dialektet dhe gjuha standarde), që përdoret në shkollë për mësim, gjuha të cilën e përdorin njerëzit tjerë në klasë, gjuhët tjera që fëmijët do të dëshironin t'i mësojnë ose veç më i mësojnë në shkollë, etj.

Mësuesi i ndan modelet dhe e shpjegon detyrën: lidhja me gjuhët e ndryshme mund të asocohet me pjesët e trupit: gjuha e familjes sonë mund të jetë gjuha e zemrës, gjuhët të cilët përdoren në shkollë mund të jenë gjuhë të kokës, ndërsa mund të ketë gjuhë tjera të cilat ndërlidhen me duart dhe këmbët. Pastaj fëmijët nxiten, që fillimisht t'i shënojnë të gjitha gjuhët dhe secilës t'ia japin nga një ngjyrë, e pastaj me përpikëri i ngjyrosin pjesët e ndryshme të trupit.


Autoportretet e këtyra gjuhësore mund të vendosen në klasë, që pastaj nxënësit mes vete, por edhe mësuesi me nxënësit bisedojnë në lidhje me fotografitë. Pyetjet mund të jenë: “Pse të fle në zemër kjo gjuhë?”, “Pse ngjyra e këmbëve ndërlidhet me gjuhën tjetër?”

Ideja rreth portretit gjuhësor (Fotografia 10) është ndërmarrë nga “Avancimi i njohurive ndërkulturore”, Broshura 4 e Materialeve për trashëgiminë gjuhësore të mësimin, që gjenden në [ueb-faqen e Universitetit Pedagogjik të Cyrihut, projekte ndërkombëtare në arsim.](#)



Fotografia 10: Portreti gjuhësor

Mësuesit mund të përfshihen në aktivitete të ngjashme për hulumtim të identitetit të tyre gjuhësor. Mund të zgjedhen tregime më ndryshe, si p.sh. druri ose dora. Këto janë dy shembuj të portretit gjuhësor, të hartuara nga pjesëmarrësit e punëtorisë së UNICEF-it në Shkup, nga viti 2014 (Fotografitë 11-12):



Fotografitë 11-12: Shembuj të drurit dhe dorës për paraqitje të identitetit gjuhësor

### Informacione plotësuese dhe referenca:

Informacione plotësuese dhe referenca:

[Materiale për mësim në gjuhën primare dhe kulturë](#). Universiteti i Cyrihut për edukim të mësimeve të mësimdhënësve

Krum, H.-J (2010). [Mehrsprachigkeit in Sprachenporträts und Sprachenbiographien von Migrantinnen und Migranten](#). AkDaF Rundbrief 61.



## 1.5 MBËSHTETJA E TË GJITHË PJESËMARRËSVE

### Sfondi

Mbështetja për të gjithë nxënësit e shkollës ka të bëjë me mënyrat inovative për mësim të përbashkët dhe të ndërsjellë jashtë klasës. Katër aktivitetet e këtij kapitulli fokusohen në aftësitë interdisiplinare, si p.sh. aftësia personale dhe sociale, duke përfshirë edhe aftësinë për të përvetësuar këndvështrimin e personit tjetër. Aktiviteti i tretë fokusohet në kompetencat artistike dhe aftësinë e për bashkëpunim me të tjerët, me qëllim që të arrihet diçka, që askush nuk mund ta arrijë i vetëm. Aktiviteti i katërt dhe mjedisi motivues për përvoja letrare.

### Informacione për përdoruesin

Të katër aktivitetet e përfshira këtu ndihmojnë në krijimin e ideve për mbështetjen e të gjithë nxënësve në shkollë dhe jashtë saj, edhe pse ato mund të zbatohen edhe në klasë. Këto aktivitete paraqesin shembuj të mënyrave se si mësojnë fëmijët pa marrë udhëzime të drejtpërdrejta nga mësuesi, por përmes pjesëmarrjes në loja dhe aktivitete grupore.

### Aktiviteti shkollor 1: Le të fluturojmë!



#### Pse është me rëndësi?

- Zhvillimi i identitetit pozitiv dhe kultivimi i prejardhjes janë parakushte të rëndësishme për mësim social dhe individual në shkollë

#### Për çka bëhet fjalë?

- Reflektim për identitetin personal (multikulturor) dhe ndjenjën e përkatësisë
- Puna në projektin (përgatitja e balonës) së bashku me fëmijët tjerë
- Përfshirja e prindërve dhe ekspozimi i fëmijëve me prejardhje të ndryshme kulturore-sociale (në veçanti, nëse planifikoni mundësi për fluturim të balonave)

#### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Tabak letre, flomasterë, ngjitëse, materiale për kornizë dhe spango, shirit për baraspeshë


### Përshkrimi i aktivitetit:

Mësuesi e prezanton balonën me pjesët e saj, si paraqitje të identitetit të secilit nxënës. Ndahet një fletë pune, në të cilën është dhënë skica e balonës dhe është shpjeguar se çka paraqet secila pjesë e saj:

- Figura e buzëqeshur (smajli) në qendër: Jam unë – profil i shkurtër. Çka është unike për mua?
- Gjashtë trekëndëshat: Vende, situata kontekste në të cilat jetojmë. Në cilin grup bëj pjesë? Cilat role i kam në situata të ndryshme?
- Tre spangot e balonës në mes: aftësitë e mia, anët e fuqishme, resurset, gjuhët, interesat dhe hobi. Çka mund të bëjë? Cilat janë përparësitë e mia?
- Dy bishtat e vegjël të balonës: idealet e mia, religjioni im, filozofia ime e jetës. Çka është me rëndësi? Cilat norma dhe ide i kam miratuar?
- Bishti i gjatë i balonës (i ndërlidhur me të dy bishtat e shkurtër): rrënjët e mia, familja ime, prejardhja ime, e kaluara ime. Prej ku jam. Kush dhe cilat gjëra kanë ndikuar në punën time?
- Era, ajri: shoqëria në të cilën jetoj, me të gjitha kushtet. Çka pret shoqëria nga unë? Çka pres dhe çka më nevojitet nga shoqëria?

Fëmijët e përdorin fletën e punës (shih djathtas), për t'i shënjuar pjesët e ndryshme të balonës sipas udhëzimit, dhe fillojnë t'i plotësojnë informacionet për aspektet e ndryshme të identitetit të tyre.

Kur do ta përfundojnë detyrën dhe do t'i shënojnë të gjitha informacionet relevante për identitetin e tyre, nxënësit i ndajnë informacionet mes vete, diskutojnë lidhur me



ngjashmëritë dhe dallimet si dhe theksojnë fakte interesante.

Mund të ndjekin detyra të ndryshme (diskutime të orientuara, ndërtim të balonës për klasën me të gjitha aspektet, shkrimi i rezymësë), varësisht nga përzgjedhja e mësuesit dhe qëllimet e përgjithshme.

Nëse është e përshtatshme koha për punë në ambient të hapur, ku do ta fluturoni balonën, shqyrtoni mundësinë që t'i ftoni edhe prindërit. Ata mund të sjellin ushqim dhe pije.

Ideja “Le të fluturojmë!” (Fotografia 13) është marrë nga “Avancimi i njohurve ndërkulturore”, Broshura 4 e Materialeve për trashëgimi gjuhësore në mësim (fq. 19-20), që gjenden në ueb faqen e Universitet Pedagogjik të Cyrihut, Projektet ndërkombëtare në arsim.

### **Informacione plotësuese dhe referenca:**

[Materiale për mësim në gjuhën dhe kulturën e parë](#) , Universiteti Pedagogjik i Cyrihut, shih Broshura 4, fq. 19-20.

[Si bëhet balona në formë të diamantit](#) në My Best Kite.com

### **Aktiviteti shkollor 2: Përvetësimi i këndvështrimit të tjerëve**



#### **Pse është me rëndësi?**

- Perceptimi i vetvetes dhe të tjerëve është parakusht për empati, mësimi social dhe respektimi i të tjerëve
- Perspektiva e të tjerëve duhet të merret për shkak të bashkëpunimit të fëmijëve me përvojë të ndryshme ose grupmosha të ndryshme, si dhe zgjidhje të konflikteve

#### **Për çka bëhet fjalë?**

- Vetëdija e fëmijëve në lidhje me perceptimet dhe nevojat në ndonjë situatë mund të jetë shumë më ndryshe nga të tjerët, gjë që është normale
- Aftësia për shqyrtim të situatës nga aspekti tjetër kuptohet si pikë nismëtare në lidhje me zgjidhjen e problemeve ose mësimin e gjërave në mënyra të reja

#### **Metodat dhe veglat e nevojshme**

- Materialet e ndryshme, varësisht nga aktiviteti

**Përshkrimi i aktivitetit:**

Marrja e këndvështrimit të të tjerëve mund të integrohet në aktivitete tjera të mësimin social dhe zgjidhje të konflikteve. Po ashtu mund të organizohet si pjesë e një evenimenti më të veçantë për krenimin e diversitetit, shfaqjen dramatike të tregimeve ose evenimente për të tjerët (p.sh. fabula “Qengji dhe ujku”), UNICEF, Moduli 3 për trajnim të trajnuesve, përmes përvetësimit të këndvështrimit të kafshëve të ndryshme).


Ndoshta do të organizoni pasdite në shkollë, kur nxënësit do të kenë mundësi ta shohin botën nga një këndvështrim tjetër ose të marrin këndvështrimin e personit tjetër. Një gjë e tillë mund të përfshijë vënien e vetes në rolin e fëmijës me aftësi të kufizuara.

Aktivitetet/lojërat mund të përfshijnë:

- Dramatizime (luajtje të roleve); për të debatuar rreth ndonjë argumenti hidhni monedhën për të vendosur se cili fëmijë çfarë roli do të merr
- Ndërimi i vendeve ndërmjet nxënësve të klasave të ndryshme, ndërmjet mësuesve dhe nxënësve ose mësuesve dhe prindërve dhe “vënia e vetes në lëkurën e tjetrit” për një kohë të caktuar
- Disa fëmijë le të xhirojnë ndonjë eveniment nga kënde të ndryshme dhe pastaj le të japin përshkrim të shkurtër, le t’i krahasojnë interpretimet e tyre të situatës dhe le të diskutojnë në lidhje me vendimet
- Luajtja e lojës me letra “Momente të vështira” ose sajoni ndonjë lojë tuajën

**Informacione plotësuese dhe referenca:**

Shkrimi për motivim socio-emotiv [Si është të jesh në lëkurën e tjetrit](#)  
[Aktivitete në shkollë në lidhje me përvetësimin e këndvështrimeve](#)  
[Si të mësohen fëmijët të përvetësojnë këndvështrime](#)



### Aktiviteti shkollor 3: Orkestra e shkollës dhe grupi teatror



#### Pse është me rëndësi?

- Luajtja në orkestër i mundëson të gjithëve të marrin pjesë, pavarësisht nga shkallë e shkathtësive dhe mjeshtërisë në përdorimin e instrumentit muzikor
- Talentet e fëmijëve dalin në pah për nxënësit tjerë, për mësuesit dhe për prindërit
- Luajtja në orkestër iu jep të gjithë nxënësve të shkollave inkuive një ndjenjë të posaçme të bashkësisë dhe pjesëmarrjes

#### Për çka bëhet fjalë?

- Ushtrimi dhe performimi në orkestrën e shkollës nuk nënkupton vetëm bërje muzikë, por edhe aktivitet të përbashkët me të tjerët, gjë që nuk mund të arrihet nëse jeni vetëm
- Respektimi i të tjerëve në lidhje me kontributin e tyre në përpjekjet kolektive
- Bërja e muzikës paraqet mënyrë të shkëlqyeshme për të nxitur shkathtësitë themelore siç është vëmendja, përballja me frustracionet, bashkëpunimi etj.

#### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Instrumentet muzikore – pyetni familjet nëse kanë instrumente të vjetra, të cilat askush nuk i përdor, filloni të grumbulloni instrumente të vjetra nga bashkësia, të cilat pronarët janë të gatshëm t'ia huazojnë shkollës

#### Përshkrimi i aktivitetit:

Formimi i orkestrës së shkollës është projekt afatgjatë, mirëpo ju mund të planifikoni ndonjë eveniment duke i vënë në funksion shkathtësitë, të cilat veç më i posedojnë nxënësit, pa mos investuar në ndërtimin e shkathtësive për orkestër të suksesshëm shkollor. Varësisht nga talenti i mësuesve dhe prindërve, ndoshta më shumë mund të dëshironi të formoni grup teatral.



Fotografia 14: Orkestra e shkollës

**Informacione plotësuese dhe referenca:**

[Orkestra e shkollës Lajski](#), një shkollë gjithëpërfshirëse në Poloni

## Aktiviteti shkollor 4: Mbrëmje për rrëfim të tregimeve në prezencë të familjeve



### Pse është me rëndësi?

- Nxitet ndjenja e zbatimjes dhe motivacionit për lexim jashtë klasës
- Mësuesit, prindërit dhe nxënësit rrinë së bashku në atmosferë joformale

### Për çka bëhet fjalë?

- Përfshirja më e madhe e prindërve për shkak të përmirësimit të shkrimit leximit të fëmijëve
- Mundësi zbatimëse, ku të gjithë do të thonë ndonjë gjë

### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Njerëzit, le t'i rrëfejnë tregimet e veta, le të flasin për ushqim dhe pije

### Përshkrimi i aktivitetit:

Duhet të sajohet një titull ose temë e mbrëmjes, e pastaj zgjedheni një vend dhe bashkëpunëtorë të mundshëm të evenimentit. Vendi ku do të takoheni duhet të përputhet me atmosferën dhe të fokusohet në titullin ose temën tuaj. Nëse ngelni në shkollë, duhet të mendoni për ndonjë dekorim, që do të përputhet me temën dhe ambientin.

Prezantuesit (treguesit) mund të jenë individë nga bashkësia juaj, mund të jenë prindër, mësues ose nxënës, të cilët kanë rrëfime interesante në temën, që e keni përzgjedhur. Njashtu mund të zgjedhni temë dhe tregime interesante, të cilat do të rrëfehen një në mbrëmje të veçantë në shkollën tuaj.

Në planifikimin dhe realizimin e këtij aktiviteti le të përfshihet biblioteka lokale, libreria ose qendra e bashkësisë.

### Informacione plotësuese dhe referenca:

[Mbrëmja zvicerane e tregimeve](#) organizohet çdo vit me mbështetje të UNICEF-it (informacionet janë në gjuhën gjermane)

# PJESA E DYTË





NDËRTIMI I BLLOQEVE  
NË DREJTIM TË

MBËSHTETJES

SË TË GJITHË NXËNËSVE

## 2.1 PROGRAMI MËSIMOR GJITHËPËRFSHIRËS DHE FLEKSIBIL

### Sfondi

Kjo pjesë ka të bëjë me aktivitetet, të cilat mësuesit mund t'i përdorin në shkollë, me qëllim të realizimit të programit mësimor në mënyrë të qasshme, të pranueshme dhe të përshtatshme për të gjithë nxënësit. Kjo bazohet në parimet e Konceptit universal mësimor dhe e thekson nevojën për më shumë mënyra të prezantimit dhe përshtatjes së përmbajtjes drejt nevojave të nxënësit si dhe më shumë mënyra në të cilat nxënësi mund të përfshihet në procesin mësimor. Këto strategji ilustrohen me nga një aktivitet. Aktiviteti 4 jep shembuj të mënyrës se si nxënësit të përfshihen në krijimin e materialeve mësimore, të arritshme për ta dhe për të tjerët.

### Informacione për përdoruesin

Në përgjithësi mësuesit janë të prirë ta realizojnë programin ashtu siç është dhënë në librat shkollorë dhe në materialet mësimore, të dhëna nga Ministria e Arsimit, institutet pedagogjike dhe qendrat për zhvillim të arsimit. Edhe nëse mësimdhënia është e bazuar në dëshmi dhe mbështetet në praktika të mira në klasë, ajo përsëri mund të mos jetë në dispozicion, ose mund të mos jetë relevante ose interesante për nxënës të caktuar. Për këtë arsye, me rëndësi është që mësuesit ta njohin strategjinë për realizim të programit mësimor sipas mënyrave të cilat i përmbushin nevojat e popullsisë së ndryshme shkollorë.

### Aktiviteti 1: Udhëzimi Diferencues - Piramida e Planifikimit



#### Pse është me rëndësi?

- Mësuesi mund ta përdor piramidën e planifikimit, për të parë se si krijohet dija dhe për ta përdorë atë dituri për planifikim të aktiviteteve kuptimplota për secilin nxënës sipas shkallës së të kuptuarit
- Piramida e planifikimit iu ndihmon mësuesve t'i shqyrtojnë qëllimet mësimore për nxënësit dhe t'i definojnë ato edhe për nxënësit më të avancuar

#### Për çka bëhet fjalë?

- Mësimi maksimal të të gjithë nxënësit përmes hartimit të planeve mësimore të diferencuara për nxënësit, të cilët mësojnë në nivele të ndryshme
- Përshtatja e mësimin, që t'iu përshtatet grupeve të ndryshme të nxënësve

#### Metodat dhe veglat e nevojshme


- Formular për planifikim (shih më poshtë)

### Përshkrimi i aktivitetit:

Përdorimi i piramidës së planifikimit ka më shumë të bëjë me zgjedhjen e metodës së mësimi të diferencuar, se sa me aktivitetin, që do të realizohet vetëm njëherë. Kjo paraqet mënyrë për të menduar në raportin ndërmjet mësuesit, temës, praktikës mësimore dhe kontekstit në krahasim me të arriturat e pritura nga nxënësit. Ky sistem është zhvilluar nga Schumm, Vaughn, Leavell, (1997), me qëllim që t’iu ndihmojë mësuesve të mendojnë për gjërat që ata i kanë emërtuar si “pesë pika të refleksionit”:

- Mësuesi – Perceptimi i mësuesve për mësimdhënien dhe mësimi ndikon fuqishëm në vendimet në lidhje me mësimi.
- Tema – Kjo është gjëja që më së shpeshti i shtyn mësuesin të mendojë - çka të ligjëroj?
- Konteksti - Konteksti – d.m.th. ambienti mësimor i përfshin aspektet sociale të klasës, mënyra se si klasa organizohet për zhvillim të mësimi, dhe faktorët shkollor të cilët ndikojnë në atmosferën e klasës. Konteksti është pika e refleksionit, e cila me siguri mund të parashihet, por shpeshherë dallon varësisht nga ajo se çka ndodh në ditën përkatëse.
- Aktivitetet mësimore – Në fakt pjesa më e madhe e përgatitjeve ditore të mësuesve janë të shënuara në planet e aktiviteteve ose strategjive – lista e aktiviteteve e përbërë nga agjenda mësimore.
- Nxënësi – Në majën e piramidës qëndron nxënësi. Shumë pak është e besueshme që mësuesit do të kenë kohë të merren me secilin nxënës individualisht gjatë hartimit të përgatitjeve të përditshme. Megjithatë mësuesit mund të përgatisin një bankë (bazë) të informacioneve për nxënësit veç e veç, kur planifikojnë aktivitet mësimor për të gjithë klasën. Pra duhet të merret parasysh sfondi akademik, kulturor dhe gjuhësor i nxënësve. Të tre shtresat vertikale përputhen me nivelin e mësimi. Shtresa e ulët e përfshin atë që do ta mësojnë të gjithë nxënësit. Kjo shtresë përmban vëllimin më të madh të materialeve. Shtresa e mesme e paraqet “atë që do ta mësojnë shumica e nxënësve, por jo të gjithë”, ndërsa shtresa më e vogël e paraqet “atë që do ta mësojnë disa nxënës”. Është me rëndësi të theksohet se të gjithë nxënësit mund të mësojnë, por nuk janë të gjithë të përgatitur ta mësojnë përmbajtjen e njëjtë ose në mënyrën e njëjtë. Të gjithë nxënësit kanë qasje të barabartë në përmbajtjen mësimore.


Të tre nivelet e piramidës dallojnë varësisht nga tema. Secila temë duhet të ketë përmbajtje kognitive-stimuluese. Secili bosht i piramidës paraqet “pikë të refleksionit”, për të cilin mësuesit duhet të mendojnë gjatë përgatitjes së ndonjë njësie ose ore mësimore.



**Fotografia 15: Piramida e planifikimit (Schumm, Vaughn, Leavell, 1994, fq. 610)**

Mënyra tjetër për të menduar në lidhje me këtë piramidë është të shqyrtohet mbështetja e nevojshme për grupet e ndryshme të nxënësve, për të arritur rezultate të njëjta mësimore, të pritura në fund të një sërë orëve mësimore ose në mbarim të klasës. Në shtresën e parë janë nxënësit, të cilët nuk kanë nevojë për mbështetje plotësuese, ndërsa në pjesën e dytë janë nxënësit, të cilët kanë nevojë për intervenime të orientuara për realizim të programit mësimor. Nga ana tjetër në shtresën e tretë janë nxënësit, të cilëve iu nevojitet mbështetje e individualizuar dhe intensive për t'i arritur qëllimet e njëjta mësimore. Ky model i trefishtë i mbështetjes quhet "Përgjigja ndaj intervenimit" (shih Modulin hyrës, fq. 15).

Për përgatitje ditore, mësuesi mund ta përdorë modelin me aktivitete për grumbullim të pesë refleksioneve brenda një analize të gjendjes:



**Fotografia 16: Piramida e planifikimit të dhënë si një aktivitet**

Formulari në vijim, sipas Gartin et al. (2016, fq. 23) mund të përdoret për dokumentim të mendimeve dhe për planifikim të orës mësimore. Mund të adaptohet për përdorim individual.

Data: ..... Ora: ..... Lënda: .....

Qëllimi .....

Materialet e nevojshme: .....

	Parashikimet	Aktiviteti mësimor	Prova para realizimit	Aktiviteti mësimor	Evaluimi
Çka do të mësojnë <u>disa</u>					
Çka do të mësojnë shumica					
Çka duhet të mësojnë të gjithë (qëllimi)					
Adaptimet <ul style="list-style-type: none"> <li>• Përmbajtja</li> <li>• Produkti</li> <li>• Procesi</li> <li>• Mjedisi</li> </ul>					

**Fotografia 17: Formular për planifikim të mësimit (Gartin et al. 2016, fq. 23)**

Piramida e planifikimit mund të përdoret për orë individuale, për planifikim javor, madje edhe për planifikim të njëjësive mësimore ose cikleve tematike.

### **Informacione plotësuese dhe referenca:**

Gartin, B. C., Murdick, N. L., Perner, D. E. & Imbeau, M.B. (2016). Mësimi i diferencuar në klasë gjithëpërfshirëse. Strategjitë e suksesit. Arlington: Këshilli për fëmijë të jashtëzakonshëm.

[Strategjitë për mësim të diferencuar](#) në bazë të piramidës së planifikimit

## **Aktiviteti 2: Më shumë mënyra për prezantimin e informatave**



### **Pse është me rëndësi?**

- Mënyra e prezantimit të ndonjë ideje, tregimi, koncepti ose sferë të dijes së zgjedhur nga mësuesi mund të mos jetë njësoj e pranueshme për të gjithë nxënësit, andaj krijon barriera në mësim
- Shumica e mënyrave të prezantimit mbështesin mësim më qenësor, për shkak se nxënësit nxiten të mendojnë në mënyrë të ndryshme, duke përdorë vegla të ndryshme mësimore
- Më shumë mënyra të prezantimit e përmirësojnë mundësinë për qasje të të gjithë fëmijëve në informacione

### **Për çka bëhet fjalë?**

- Zhvillimi ose përdorimi i më shumë mënyrave të prezantimit, që dija të jetë në qasje të të gjithë nxënësve, duke përfshirë grafikë, simbole, gjeste, video-materiale, modele, fotografi dhe zë
- Përdorimi i veglave, materialeve dhe mënyrave të përfshirjes së nxënësve në mësim

### **Metodat dhe veglat e nevojshme**

- Materiale dhe mësimore për të mundësuar qasje në informacione përmes prezantimit të ndryshëm të tyre si p.sh. përmes shikimit, dëgjimit ose prekjes
- Materiale dhe vegla për përshtatshmëri ndaj shfrytëzuesit (p.sh. tekst, i cili mund të rritet, zë që mund të rritet)

**Përshkrimi i aktivitetit:**

Eksitojnë disa udhëzime të hartuara nga [Qendra nacionale për dizajn universal](#), të cilat do t'u ndihmojnë të krijoni materiale, detyra, tekste dhe burime tjera të informacioneve për të gjithë fëmijët:


- Opsionet e ndryshme për pranim të informacioneve si p.sh. alternativa për informacione vizuale dhe auditive (ndoshta, lexim të teksteve në internet me ndihmën e programit falas për lexim në ekran)
- Opsionet e ndryshme për gjuhë, shenjat dhe simbolet matematikore, si p.sh. ilustrime, simulime, fotografi dhe grafikë
- Opsione të ndryshme për kuptim si p.sh. harta konceptuale, metafora, diagrame dhe përdorimi i “skelave dhe strategjive të grumbullimit” të informacioneve për të ndihmuar të kuptuarit
- Opsionet e ndryshme për të ndihmuar në bartjen e mësimit në kontekste të reja si p.sh. afishet, të cilat përmbledhin poentat më të rëndësishme mësimore
- Lejoni nxënësve të ndihmojnë në zhvillimin e mënyrave të ndryshme të prezantimit të informacioneve, pasi ajo pjesë e procesit mësimor dhe do të sigurojë informacione të dobishme për nxënësit tjerë.

**Informacione plotësuese dhe referenca:**

[Broshura dhe uebinari i UNCEF-it 11 “Qasja në shkollë dhe në mjedisin mësimor II – Koncepti universal mësimor”](#)

[Ueb saji i Qendrës nacionale për dizajn universal](#), SHBA

[Standardet evropian për shndërrimin e informacioneve në struktura të lehta për lexim dhe mësim](#)



### Aktiviteti 3: Më shumë mënyra për veprim dhe shprehje



#### Pse është me rëndësi?

- Të gjithë fëmijët nuk mund ose nuk dëshirojnë që kryesisht të dëgjojnë, mësojnë dhe shkruajnë. Me planifikimin e mënyrave tjera të veprimit dhe shprehjes, klasa do të ngel mjedis mësimor efektiv për të gjithë nxënësit
- Disa fëmijë nuk kanë sukses të mirë, por jo për shkak se nuk janë të aftë, por për shkak se iu mungojnë shkathtësitë konkrete për shprehje të aktivitetit, që e kanë planifikuar (p.sh. vëmendje e vazhdueshme dhe qëndrim i qetë në vend), që nuk janë të rëndësishme jashtë kasës tradicionale. Më shumë fëmijë mund të marrin pjesë, nëse sigurohen mënyra alternative për veprim dhe shprehje

#### Për çka bëhet fjalë?

- Planifikimi i procedurave alternative fizike që të gjithë nxënësit detyrat t'i kenë në dispozicion detyrat (p.sh. shkrimi në kompjuter ose tablet në vend se me letër dhe me laps)
- Planifikimi i shprehjes alternative përtej asaj që zakonisht praktikohet në klasat tradicionale

#### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Përmbledhja me strategji të ndryshme mësimore, prej të cilave nxënësit do të mund të zgjedhin
- Aplikacione për telefona të mençur, kompjuterë ose iPad

#### Përshkrimi i aktivitetit:

Ky aktivitet nënkupton të mendohet për më shumë mënyra, në të cilat nxënësit mund të dëshmojnë ose ilustronë atë që e dinë ose kanë mësuar. Pra aktiviteti në fjalë ka të bëjë me mënyrën “si” të mësohet. Zakonisht mësuesit kërkojnë nga nxënësit përgjigje me shkrim ose me gojë, derisa janë në klasë së bashku me nxënësit tjerë. Për shumë nxënës, kjo nuk është mënyrë as atraktive e as e përshtatshme për t'u shprehur. Për këtë arsye mësuesi gjithëpërfshirës siguron mundësi për veprim fizik, për artikullim dhe komunikim. Meqenëse fëmijët e ndryshëm kanë mënyra të dëshiruara ose mundësi të ndryshme të përfshirjes, me rëndësi është që të sigurohet mundësi për funksione ekzekutive, që të zgjerohet repertori i përfshirjes së nxënësve.




Shembuj praktikë për në klasë:

- Fëmijët le t'i përdorin telefonat e tyre të mençur ose kompjuterët (të siguruara nga shkolla) për qasje në informacione dhe kryerje të detyrës
- Siguroni ilustrime dhe modele për ta bërë lëndën ose temën më të qasshme
- Përdorni bllogje ose tabela të bardha, që t'iu mundësoni nxënësve të marrin pjesë në diskutime ose të kontribuojnë në hulumtimin e temës
- Nxënësit le të përpilojnë prezantime multimediale të së mësuarës, si p.sh. përmes krijimit të librit multimedial me Book Creator ose Tar Heel Reader
- Përdorni onlajn resurse për vizualizim të problemeve matematikore të [Bibliotekës nacionale e mjeteve për përdorim \(manipulativë\)](#)

**Informacione plotësuese dhe referenca:**

[Resurse](#) të theksuara nga Qendra nacionale për dizajn universal  
[Kreator i librit](#) – aplikacion për nxënësit, për dokumentim të të mësuarës  
[Skela e strategjive për grumbullim të informacioneve për nxënësit tuaj](#) nga Edutopia [Këshilli Britanik](#)



## Aktiviteti 4: Ndërtimi i përbashkët i vokabularit



### Pse është me rëndësi?

- Klasat me diversitet janë burim i pasur i informacioneve për të gjithë nxënësit, sepse edhe njohuritë do të jenë të ndryshme. Me këtë resurs, nxënësit do të ndjehen të vlerësuar, ndërsa përvojat e tyre do të pranohen si të rëndësishme për mësimin e ardhshëm
- Mësimi përmes bashkëpunimit dhe reagimi ndaj kontributit të të tjerëve e zgjeron diturinë e të gjithëve

### Për çka bëhet fjalë?

- Zhvillimi i pjesëmarrjes i vokabularit për ndonjë temë, sekuencë mësimore ose mësim
- Lehtësimi i “mësimin qenësor” përmes prezantimeve të ndryshme

### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Fletë ngjitëse – nëse rezultatet iu prezantohen të gjithëve
- A5 kartela – nëse rezultatet përdoren për mësim të nxënësve
- Telefona të mençur – nëse rezultatet integrohen në aplikacionin për ndërtim të vokabularit

### Përshkrimi i aktivitetit:

Si hap i parë, grupi i nxënësve (ose nxënës të caktuar) le t'i shënojnë të gjitha fjalët, të cilat nuk i kanë kuptuar plotësisht ose për të cilat dëshirojnë të mësojnë më shumë. Pastaj grupi ose nxënësi i zgjedh fjalët më të rëndësishme. Nëse këtë hap e bëjnë grupe të ndryshme ose nxënës në klasë të njëjtë, atëherë nevojitet një sekuencë e shkurtër, që nxënësit t'i krahasojnë fjalët dhe të përpilojnë një listë të kombinuar të fjalëve më të rëndësishme.

Më pas përgatiten kartela ose fletë ngjitëse, ashtu që fjala e cila duhet të shpjegohet do të vendoset në pjesën e sipërme, duke shtuar një pjesë për shpjegim, një pjesë për komente të shpjegimit dhe pjesa e tretë për tekst të shkurtër, në të cilin është përdorë fjala (shih ilustrimin në tabelën djathtas).

Kur do të hartohet kartela dhe do të vendoset fjala, atëherë ajo përcillet te nxënësit tjetër ose të grupi tjetër i nxënësve, të cilët do të japin shpjegim për fjalën.

Pas shpjegimit, kartela lëviz kah nxënësi tjetër ose kah grupi tjetër. Pastaj shpjegimi lexohet dhe komentohet. A është mirë. A mungon diçka e rëndësishme?

Kur të plotësohen komentet për të gjitha kartelat, ato përcillen te një nxënës tjetër ose te një grup tjetër. Pastaj shkruhet teksti, në të cilin do të përdoret fjala.

Fjala
Shpjegimi i fjalës
Komenti për shpjegim
Tekst i shkurtër, në të cilin është përdorë fjala


**Fotografia 18: Formular për kartelën e vokabularit**

Tani kartelat e plotësuara shkëmbehen dhe vlerësohen ndërmjet nxënësve: a ofron kjo kartelë informacione të dobishme, a është gjithçka e saktë ose duhet të përmirësohet? Kur nxënësit t'i marrin kartelat, mësuesi kontrollon nëse është gjithçka në rregull. Pastaj kartelat mund të përdoren në orët tjera për të gjithë nxënësit.

**Informacione plotësuese dhe referenca:**

[Aktivitetet për ndërtim të vokabularit](#) nga Këshilli Britanik dhe BBC-ja

[Bëni fjalor të ilustruar](#) (aktivitet i Education.com)



## 2.2 KRIJIMI DHE PËRSHTATJA E QËLLIMEVE KUPTIMPLOTA PËR TË GJITHË NXËNËSIT

### Sfondi

Në këtë pikë fjalë është për verifikimin e qëllimeve. Qëllimet janë vizione për ardhmërinë, të cilat i drejtojnë aktivitetet tona dhe i parashikojnë ta arriturat tona: nëse nxënësit përcaktojnë qëllime të ulëta, atëherë ata nuk do të zhvillojnë motiv për rezultate më të larta. Pritjet janë qëllime implicite, të cilat jo vetëm se drejtojnë procedurat tona, por edhe aktivitetet e nxënësve. Përmes zhvillimit të qëllimeve efektive dhe ndihmës së nxënësve, që të bëhen më të vetëdijshëm për pritjet e tyre dhe për ndikimin e pritjeve në vetë arritjen e suksesit, detyrimisht do të përmirësohet mësimi. Këtu aktivitetet paraqesin katër shembuj për ndihmë të nxënësve dhe mësuesve, që të bëhen më të vetëdijshëm për praktikatat e tyre për verifikimin e qëllimeve dhe mënyrave për përmirësim të tyre.

### Informacione për përdoruesin

Sipas Xhon Hetit (John Hattie), parashikimet e nxënësve për suksesin e ardhshëm kanë efekt më të madh në mësimin tyre. Prandaj, nëse mësuesit dinë të ndikojnë pozitivisht në këto pritje, ata do të arrijnë progres të madh në procesin e mësimin të nxënësve. Praktikatat e këtilla duhet të bëhen pjesë e jetës së përditshme shkollore, për shkak se zhvillimi i qëllimeve efektive dhe ndryshimi i pritjeve negative ose të ulëta kërkon përpjeke të vazhdueshme të mësuesit dhe nxënësit.



## Aktiviteti 1: Zhvillimi i qëllimeve efektive



### Pse është me rëndësi?

- Qëllimet i lëvizin procedurat tona dhe e orientojnë vëmendjen tonë. Për mësuesit më me rëndësi është t'i kenë në dijeni qëllimet afatgjate, njëkohësisht duke i ndjekur qëllimet afatshkurtra në rrjedhë të gjerë mësimore. Nxënësit mund të punojnë në qëllime të ndryshme afatshkurtra dhe njëkohësisht do t'i realizojnë qëllimet e përgjithshme.

### Për çka bëhet fjalë?

- Përvetësimi i fleksibilitetit për reagim ndaj ideve dhe dëshirave të nxënësve, pa mos i anashkaluar qëllimet dhe të arriturat afatgjate
- Potencimi i qëllimeve, duke iu mundësuar nxënësve t'i zhvillojnë të arriturat e tyre, duke u fokusuar në atë që është me rëndësi për mësimin e tyre dhe për të kontrolluar nëse i kanë përmbushur qëllimet pas përfundimit të sekuencës mësimore

### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Planifikimi i qëllimeve në më shumë nivele
- Formularë për hartimin e qëllimeve strategjike

### Përshkrimi i aktivitetit:


Në fund të fundit, arsimi duhet t'iu ndihmojë nxënësve të bëhen anëtarë të përgjegjshëm dhe kompetentë të bashkësisë. Shumica e sistemeve arsimore ofrojnë vizion të gjerë për atë që duhet të arrihet me arsimin e detyrueshëm të nxënësve, i cili përdoret për hartimin e programit nacional. Në rrethana ideale programi përmban pohime për rezultatet e nxënësve (p.sh. programi i mbështetur në kompetencë), mirëpo disa shtete ende kanë programe me fokus në përmbajtje, se sa në kompetencë. Nga ana tjetër, gjatë konceptimit qëllimet përcaktohen si pikë fokusi i përgatitjes ditore. Pika nismëtare e planifikimit nuk është “Çka do të bëj me nxënësit?”, por “Çka dua nxënësit të arrijnë dhe të mund të bëjnë?”

Për sekuencën mësimore theksojeni qëllimin që dëshironi ta arrini me nxënësit. Hartoni indikatorët, gjegjësisht definoni rezultatin për të përshkruar nivelin e kompetencës, të cilin nxënësit duhet ta arrijnë, ose atë që prisni nxënësi ta demonstrojë në fund të mësimit. Pastaj secilin rezultat, gjegjësisht indikator të suksesit përdoreni për planifikim të aktiviteteve, me të cilat nxënësve iu ndihmohet në përmbushjen e qëllimit. Për shembull:



Fotografia 19: Ndërlidhja e qëllimeve, rezultateve dhe aktiviteteve

Tregime të këtilla mund të hartojnë edhe vetë nxënësit, ndërsa mësuesi mund t'i kontrollojë ato. Ky është hapi i parë drejt hartimit të planit të punës, i cili përmban edhe informacione për mënyrën e realizimit të aktiviteteve, me cilin/cilën janë kryer, vendi ku dhe në çfarë mënyre. Për këtë hap më konkret të planifikimit mund të përdoret modeli me aktivitete:



Fotografi 20: Paraqitja grafike e qëllimeve multidimensionale të aktivitetit

### Informacione plotësuese dhe referenca:

[Moduli 3 i UNICEF-it për trajnim të trajnuesve](#), Pjesa 2: Përpunimi i qëllimeve efektive  
[Veçla të përditshme mësimore](#) përfshin hartën e strategjisë për qëllimet, e cila po ashtu mund të përdoret

## Aktiviteti 2: Nxënësit i parashikojnë të arriturat e ardhshme



### Pse është me rëndësi?

- Fëmijët janë shumë preciz, kur parashikojnë se si do të bëjnë diçka. Ndikimi ndaj parashikimeve për suksesin e ri drejtpërdrejt do të ndikojë në rezultatet e tyre
- Nëse mësuesit mësojnë se çfarë pritjet kanë nxënësit, ata mund të gjejnë mënyra, për t'iu ndihmuar t'i tejkalojnë pritjet e tilla
- Kur nxënësit do të shohin se mund të jenë më të suksesshëm nga pritjet e tyre, ata do të fitojnë besim në aftësinë e tyre për mësim

### Për çka bëhet fjalë?

- Përballja e nxënësve me pritjet e veta
- Zbulimi i arsytimit të nxënësve, se pse diçka e kanë lehtë ta mësojnë ose e kanë vështirë, gjegjësisht të përvetësojnë vetëbesim gjatë mësimin

### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Nuk nevojitet material i posaçëm

### Përshkrimi i aktivitetit:

Shembuj të cilët mësuesit mund t'i përdorin në klasë:

- Para kontrollimit verbal të diturive ose para testit me shkrim, kërkoni nga nxënësit t'i shënojnë notat, të cilat dëshirojnë t'i marrin. Shfrytëzoni këto informacione që t'i nxisni të përpiqen të jenë më të suksesshëm.
- Tregoni një hartë të qëllimeve, të cilat dëshironi të arrihen (shih Aktiviteti 1 i këtij kapitulli) ose kriter për vlerësim, të cilin e keni parashtruar, ndërsa nxënësit le të shënojnë se sa të suksesshëm presin të jenë.
- Le t'i shënojnë nxënësit qëllimet tyre mësimore, në lidhje me sekuencën mësimore, gjegjësisht çka do të dëshironin të arrinin deri në fund të saj. Pasi të mendoni në lidhje me qëllimet, së bashku me nxënësit tjerë grumbulloni qëllimet e shënuara. Më pastaj tregojani nxënësve qëllimet dhe nënvizoni ato, për të cilat nuk keni menduar. Përkujdesuni që nxënësit t'i arrijnë qëllimet madje edhe t'i tejkalojnë ato.
- Shtoni rubrikën për vetëvlerësim të testeve ose fletëve të punës dhe jepuni kohë nxënësve të shënojnë se çfarë vlerësime presin nga detyra ose testi.

### Informacione plotësuese dhe referenca:

[Vokabulari në lidhje me ndikimin e suksesit të nxënësve](#) – nota e shënuara vetë nxënësit

[John Hattie](#) shpjegon për ndikimin e pritjeve të nxënësve ndaj suksesit të tyre

### Aktiviteti 3: Kontrollimi i qëllimeve SMART



#### Pse është me rëndësi?

- Nxënësit kanë prirje të parashtrajnë qëllime shumë të përgjithshme dhe abstrakte (p.sh. të kenë nota më të mira), mirëpo iu mungon shkathtësia t'i ndajnë ato në qëllime të realizueshme
- Fëmijët zakonisht nuk janë të sigurtë, nëse i kanë arritur qëllimet dhe kanë mësuar gjithçka që nevojitet për të qenë të suksesshëm në të ardhmen. Kontrollimi SMART i qëllimeve iu ndihmon mësuesve dhe nxënësve të komunikojnë rreth rezultateve të mësimit

#### Për çka bëhet fjalë?

- Nxënësit mësojnë të formojnë qëllime sipas kontrollimit SMART
- Nxënësit i kontrollojnë të rriturat e tyre në raport me qëllimet e përcaktuara paraprakisht

#### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Letër, stilograf dhe përshkrim të qëllimeve SMART

#### Përshkrimi i aktivitetit:

Mësuesi i prezanton pesë komponentët e definimit efektiv të qëllimeve, me të cilat nxënësit i potencohet sjellja e nevojshme ose rezultati përkatës. Këta janë pesë komponentët:

- **S** “specifike”: Qëllimi i duhet të përcaktojë një procedurë konkrete, ndodhi ose rezultat, i cili do të realizohet ose do të përmbushet. Duhet dhënë pasqyrim në çështjet “Kush”, “Pse”, “Kur” dhe “Pse”.
- **M** “e matshme”: Qëllimi ose rezultati i pritur duhet të jetë i matshëm dhe i dukshëm. Këtu mund të shërbejnë pyetjet “Kush”, “Çka” ose “Si do të matet progresi”.
- **A** “i arritshëm”: Qëllimi duhet të jetë realisht i arritshëm, duke pasur parasysh kufizimet në kohë, energji dhe resurse. Këtu duhet të parashtrihen pyetjet “Cilat hapa janë të nevojshme”, “A është reale”.
- **R** “reale”: Qëllimi duhet të jetë mjaftueshëm i lartë, që të bëhet sfidë, por edhe të ketë pamjen e suksesit. Këtu mund të ndihmojnë pyetjet “A i kam shkathtësitë dhe njohuritë e nevojshme për realizim të këtij qëllimi, ose “Duke pasur parasysh kufizimet, a është e besueshme se mund të arrihet ky qëllim”



- **T “në kohë”:** Qëllimi në vete duhet të ngërthejë afatin, se kur duhet të përmbushet. Këtu është me rëndësi të parashtrohet pyetja “Cili është afati” ose “Sa kohë më nevojitet për të arritur këtë qëllim”.

Ky kontrollim SMART mund të përdoret për çfarëdo qoftë qëllime – si për qëllime të parashtruara nga nxënësit, po ashtu edhe për ato të parashtruara nga mësuesit. Nxënësit dhe mësuesit mund të bëjnë afishe me SMART listë për kontrollim të qëllimeve si dhe mund t'i varin në ndonjë vend të dukshëm në klasë.

### **Informacione plotësuese dhe referenca:**

Informacione rreth [Edutopisë për përcaktimin e qëllimeve SMART](#)

Kontrolloni në internet se çfarë formularë mund të përdorin nxënësit, p.sh. nga [Kuisi i shkollës Parkuej](#) për kontrollim të diturive në lidhje me verifikimin e SMART qëllimeve në [study.com](#)



## Aktiviteti 4: Ndërtimi i pritjeve pozitive për nxënësit tuaj më të vështirë



### Pse është me rëndësi?

- Qëndrimet negative dhe pritjet e mësuesve janë njashtu të dëmshme për suksesin, sikurse edhe pritjet negative të nxënësve. Ato janë hapi i parë drejt një rrethi vicioz ndërmjet mësuesit dhe nxënësit, i cili shpie drejt suksesit të dobët dhe problemeve të sjelljes
- Disa nxënës pranojnë vetëm komente negative nga mësuesit e tyre; askush nuk mund të mësojë në mjedis të tillë negativ dhe emocional

### Për çka bëhet fjalë?

- Të bëheni të vetëdijshëm për mënyrën tuaj të të menduarit, në lidhje me mësimin dhe suksesin si dhe për mënyrën se si ajo është e ndërlidhur me nxënësit dhe mënyrën se si i perceptoni ata (p.sh. si nxënës të mirë përballë nxënësve të këqij)
- Të bëheni të vetëdijshëm për atë se si të priturat tuaja janë të ndërlidhura me informacionet kthyesë, të cilat ua jepni nxënësve, me qëllim që të kaloni në mënyrën, që promovon pritjet pozitive te ju dhe të nxënësit tuaj

### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Kriteret për mbikëqyrje, për shkak të vetëmbikëqyrjes ose mbikëqyrjes së kolegut/bashkëmoshtarit

### Përshkrimi i aktivitetit:

Ekzistojnë disa aktivitete në të cilat mund të përfshihen mësuesit, me qëllim që t'i rishikojnë pritjet e tyre negative dhe të ulëta për disa nxënës dhe të fillojnë të miratojnë pritje, të cilat do t'iu ndihmojnë nxënësve që të mësojnë më mirë.

### Informacionet kthyesë i reflektojnë pritjet:

Mënyra si jepni informacione kthyesë i reflekton pritjet tuaja. Mbikëqyrni veten në orë, që të vëtdijësoheni në lidhje me informacionet kthyesë, të cilat ju i jepni:

- Kryesisht informacionet kthyesë për suksesin (fokusi në rezultatet ose të arriturat, si p.sh. “tregimi i shkëlqyeshëm dhe pa gabime drejtshkrimore” ose “vetëm pesë detyra të zgjidhura dhe shumë gabime”)

- Kryesisht informacionet kthyesë për personin (fokusi në karakteristikat e nxënësve, p.sh. nxënës i mirë/i keq, “përtac dhe i pakujdesshëm”, “kurrë nuk do ta mësosh këtë”)
- Kryesisht informacionet kthyesë për ndjenjat e nxënësve më të dobët (fokusi në mosshqetësimin e nxënësve për mosuksesin e tyre ose për rezultatet e dobëta)
- Kryesisht informacionet kthyesë për përpjekjen ose procesin (fokusi në strategjinë e zbatuar ose në procesin e mësimit si p.sh. “ke përdorë.... si strategji, a ke menduar të përpiqesh ...”)

Informacionet kthyesë me fokus në përpjekjet dhe procesin e mësimit i pasqyrojnë pritjet tuaja themelore se të gjithë nxënësit mund të kenë sukses të mirë, nëse vazhdimisht përpiqen dhe besojnë në potencialin e tyre për mësim. Informacionet kthyesë ngushëlluese i pasqyrojnë pritjet e ulëta të mësuesve nga nxënësit. Theksimi i rezultatit dhe personalitetit reflekton mënyrën e fiksuar të të menduarit, ashtu që mësuesit supozojnë se suksesi i mirë është refleksion i drejtpërdrejtë i inteligjencës së lartë (dhe anasjelltas), ndërsa inteligjenca e lartë është karakteristikë fikse e nxënësit.

#### Ndryshoni mënyrën e tuaj të të menduarit drejt një mendimi zhvillimor

Përmes ndryshimit të mënyrës së tillë të fiksuar të të menduarit në mënyrën zhvillimore të të menduarit, do t'i transformoni pritjet tuaja nga nxënësit, si dhe efektin e pritjeve të tyre. Me mënyrë të fiksuar të të menduarit supozohet se ekzistojnë nxënës të mirë dhe të këqij, nxënës me inteligjencë të lartë dhe të ulët, andaj këto karakteristika do ta përcaktojnë suksesin e tyre në klasë. Mënyra zhvillimore e të menduarit e promovon idenë se nxënësit mund të mësojnë gjithçka, nëse përpiqen fuqishëm, nuk dekurajohen dhe janë të përgatitur ta kalojnë kohën e nevojshme për të përvetësuar shkathtësi ose për përvetësuar kompetenca.

#### Këshillat për në klasë:

- Mos iu thoni nxënësve “nuk di ta bësh këtë”, por thoni “për momentin nuk di ta bësh këtë, mirëpo më pas do ta mësosh”
- Theksoni se rezultatit i mirë pa përpjekje është në rregull, mirëpo ndoshta këta nxënës parashatrojnë qëllime shumë të ulëta, për atë që e dinë dhe nuk do të mësojnë mirë në të ardhmen. Lëvdata e vazhdueshme për suksesin, që nuk kërkon përpjekje, i bën nxënësit përtacë dhe të paimterësuar për mësim!
- Kujdes: Lëvdata qëllim mirë mund ta fuqizojë te fëmijët mënyrën e fiksuar të të menduarit, nëse fokusohet në bazë të aftësisë së fëmijës, e jo në bazë të punës së vlefshme dhe angazhimit – shih më lartë në pjesën e informacioneve kthyesë.



Fotografia 21: Mbishkrim në derën e klasë “Këtu mëson, qeshet dhe lëviz klasa e minjve dhe elefantëve”

**Informacione plotësuese dhe referenca:**

Shih po ashtu 4.3, Aktiviteti 1 për dhënie të informacioneve kthyesë kuptimplota [Moduli 1 i UNICEF-it për trajnim të trajnuesve](#), Njësia 3 “Vlerësimi i dallimit të nxënësit e ndryshëm”

Dweck, Carol (2007). Mënyra e të menduarit. Psikologjia e re e suksesit. Si të mësojmë ta përmbushim potencialin tonë. Nju Jork: Ballantine Books.

Informacionet për idetë e Carol Dweck-ut [onlajn](#).

[Zhvillimi i mendësisë zhvillimore të të të menduarit të mësuesve dhe personelit të Edutopisë](#)

[Kontrolloni mënyrën e të menduarit](#) në mindsetworks

## Aktiviteti 5: Mësimdhënia përmes punëtorisë



### Pse është me rëndësi?

- Mësimi përmes punëtorive i mundëson mësuesit të hartojë detyra individuale me qëllime për punë të individualizuar dhe të diferencuara me nxënësit
- Nxënësit mësojnë përmes ritmit të tyre dhe parashtrojnë qëllime individuale
- Mësimi përmes punëtorisë promovon mësim të vetërregulluar

### Për çka bëhet fjalë?

- Nxënësit mësojnë, që t'i kuptojnë qëllimet e orientuara drejt kompetencës, si dhe formulojnë qëllime për procesin e tyre të të menduarit
- Qëllimet e diferencuara kërkojnë edhe vlerësim të diferencuar

### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Një kënd për punëtori me dosje për detyra të ndryshme

### Përshkrimi i aktivitetit:

Mësuesit mund të zbatojnë mësim me punëtori për secilën lëndë dhe në formate më të ndryshme, si p.sh. për mësimi të shkurtra ose për gjithë temën mësimore. Për shembull, si mund ta shfrytëzoni punëtorinë për të avancuar aftësinë për lexim? Fillimisht do t'i hartoni qëllimet e leximit (leximi i tekstit ose librit konkret). Rekomandohet që të formuloni tre ose katër qëllime, për nivele të ndryshme të shkathtësisë për lexim:

Qëllimi 1 (niveli themelor): Mund të vendos, nëse fjalia është e saktë ose e gabuar.

Qëllimi 2 (niveli i mesëm): Mund t'i përfundoj fjalitë për përmbajtjen e librit.

Qëllimi 3 (niveli i avancuar): Mund ta lexoj dhe kuptoj librin, si dhe ta përmbledh kontekstin e librit me 5-6 fjali.

Pastaj do të përgatitni detyra në bazë të këtyre qëllimeve. Për qëllimet 1 dhe 2 mund ta përdorni testin me zgjedhje të më shumë përgjigjeve, ndërsa për nivelin e avancuar duhet të përgatitni detyra më të vështira me pyetje të hapura.

Nxënësit lirshëm e zgjedhin detyrën, në të cilën dëshirojnë të punojnë. Secila detyrë ka vlerë dhe rëndësi të njëjtë brenda procesit mësimor. Megjithatë, ju mund t'i nxitni nxënësit të zgjedhin qëllime të nivelit më të lartë, për shkak të zhvillimit të mëtejshëm të aftësisë për lexim. Nëse

dëshironi të vendosni nota për produktin e punëtorisë, atëherë merrni parasysh procesin dhe produktin, por jo edhe niveli e tij. Kjo do të thotë se edhe produkti i nivelit themelor mund të vlerësohet me notë të lartë. Nxënësit do të mësojnë t'i formulojnë qëllimet e tyre të orientuara drejt kompetencës dhe do ta realizojnë këtë qëllim.





## Aktiviteti 6: Korrigjimi i punimeve me shkrim i orientuar dhe fokusuar kah resurset



### Pse është me rëndësi?

- Zbatimi i korrigjimit të orientuar dhe fokusuar në resurse iu ndihmon nxënësve të shohin, se çka dinë dhe të përqendrohen në gabimet konkrete
- Korrigjimi i fokusuar iu mundëson mësuesve të zbatojnë qëllime të diferencuara në bazë të kompetencës së nxënësve
- Me rëndësi është që të mos korrigjohet secili gabim që bën nxënësi

### Për çka bëhet fjalë?

- Nxënësit mund të fokusohen në gabime konkrete dhe t'i eliminojnë ato
- Mësuesit përdorin “skele”, duke i përcjellë nxënësit në zonën e ardhshme të zhvillimit (Vigotski)
- Nxënësit ndjekin qëllime të diferencuara


### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Nuk nevojiten mjete

### Përshkrimi i aktivitetit:

Në hapin e parë përdorni informacione kthyes të orientuara në resurse, ashtu që do të specifikoni gjithçka, që u ka pëlqyer nga punimi me shkrim i nxënësit. Çka ka bërë mirë? Lavdërojeni kreativitetin e tij ose format e sakta të fjalëve konkrete, por edhe strukturën e tekstit. Në hapin e dytë shpjegojeni fokusin: Do të fokusohen në korrigjim të foljeve dhe strukturës së tekstit tënd. Kontrolloni vetë këto gabime në tekst dhe jepni disa këshilla për mënyrën se si nxënësi mund të përmirësohet përmes ushtrimeve. Formuloni disa qëllime me nxënësit, si për shembull për hartimin e ardhshëm me shkrim: di të përdor folje në formë të rregullt. Unë di ta strukturojë tekstin në sekuenca kryesore siç është hyrja, pjesa kryesore dhe konkluzion.

Mësuesit mund të përdorin informacione kthyes të fokusuar në secilën lëndë. Në lëndët e matematikës, gjeografisë ose biologjisë mund të fokusoheni në terminologjinë specifike profesionale, ose në karakteristikën specifike të shprehjes në lidhje me lëndën.



Fotografia 23: Korrigjimi i orientuar dhe fokusuar në resurse

**Informacione plotësuese dhe referenca:**

Fotografia 23 – <http://cciproject.org/afl/images/WrittenFeedback.gif>






## 2.3 KRIJIMI I MJEDISEVE TË PËRSHTATURA MËSIMORE

### Sfondi

Në këtë pjesë bëhet fjalë për mënyrën se si mësuesit mund të ndikojnë në mjedisin mësimor. Këtu nuk bëhet fjalë vetëm për rregullimin fizik dhe lokacionin e klasës, por edhe për mjedisin socio-emocional, të cilin e krijojnë mësuesit dhe nxënësit gjatë komunikimit të ndërsjellë. Disa aktivitete janë të dobishme gjatë krijimit të mundësive më të mira për mësim, përmes sigurimit të klimës pozitive në klasë, përmes promovimit të interaksionit pozitiv ndërmjet nxënësve, përmes ndryshimit të radhitjes së bankave dhe karrigeve në klasë ose përmes grupimit të nxënësve në bazë të përvojës së tyre mësimore. Këto aktivitete janë shënuar në këtë pjesë.

### Informacione për përdoruesin

Qasja, pjesëmarrja dhe mësimi, me të edhe suksesi i nxënësve, varen nga konteksti në të cilin zhvillohet mësimi. Nëse mjediset mësimore nuk janë të rehatshme, ose nëse janë kërcënuese për nxënësit, ata do ta kenë të vështirë të grumbullojnë energji dhe motiv për mësim. Mësimi gjithëpërfshirës nënkupton, që të gjithë nxënësit të ndjehen të mirëseardhur dhe të përfshirë në aktivitetet shkollore, të aftë për të kontribuar dhe për të vepruar. Megjithatë mjediset mësimore duhet patjetër të jenë funksionale dhe në mbështetje të mësimi. Klasat tradicionale kanë tendencë t'i izolojnë nxënësit, gjegjësisht interaksioni të bëhet kryesisht me mësuesin. Mësimi, në qendër të të cilit është mësuesi është i dobishëm, kur të gjithë nxënësit duhet të drejtohen përmes përvojës së njëjtë, mirëpo gjithnjë ekziston rreziku se aktivitetet e këtilla nuk do të depërtojnë deri te të gjithë nxënësit. Mjediset mësimore gjithëpërfshirëse duhet të rregullohet, ashtu që do të mundësojnë më shumë mënyra të përfshirjes, gjë që është njëri ndër parimet e konceptit mësimor universal.



## Aktiviteti 1: Ambienti i klasës



### Pse është me rëndësi?

- Nxënësit duhet të ndjehen të fuqishëm, të pranueshëm dhe të sigurtë për të mësuar dhe për të provuar gjëra, të cilat iu duken të vështira
- Nevojat psikologjike të nxënësve duhet patjetër të përmbushen, për ndryshe nuk do të mund të përqendrohen në mësim

### Për çka bëhet fjalë?

- Në mjedisin mbështetës mësimor fëmijët ndjehen të mirëseardhur dhe të sigurtë, madje ftohen të hulumtojnë, të mësojnë dhe të komunikojnë
- Krijimi i ndjenjës së bashkësisë dhe mbështetja e ndërsjellë, ku të gjithë fëmijët do të kenë vetëbesim të mësojnë, ndërsa edhe gabimet shihen si mundësi për mësim, e jo si shkas për turpërim

### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Vendosni në mur punime të nxënësve ose afishe në gjuhën amtare të nxënësve, duke theksuar se të gjithë nxënësit respektohen dhe vlerësohen

### Përshkrimi i aktivitetit:

Eksitojnë tre komponentë kryesore për zhvillimi të klimës pozitive në klasë: ofrimi i ndjenjës së bashkësisë dhe mbështetja e ndërsjellë e nxënësve; ndjenja e sigurisë, e cila iu mundëson të marrin përsipër rreziqe dhe të veprojnë. Do të përshkruhen tre aktivitete, ashtu që secili sosh ofron qasje të njërit nga këta komponentë.

#### Bashkësia dhe mbështetja e ndërsjellë:

Pika nismëtare e bashkësisë së nxënësve është të njihet dhe të pranohet prezenca e secilit nxënës. Ekspozimi i portretit të secilit nxënës në klasë paraqet shenjë të respektit. Lejimi që fëmijët ta përdorin gjuhën amtare për ta përshkruar veten ose për të thënë “Tung”, i bën ata të ndjehen të respektuar.

Secili fëmijë duhet të ftohet nëpër shfaqje, ashtu që të tjerët do ta përshëndesin, do ta pranojnë dhe do t’ia dëgjojnë përgjigjen.

Ndjenja e identitetit grupor mund të fuqizohet, kur të bëhen portrete dhe të paraqiten mënyrat e ilustrimit të faktit se këta fëmijë i takojnë njëri tjetrit, gjegjësisht të gjithë janë anëtarë të grupit.



**Fotografia 24: Mirë se erdhët nxënës (JUKIBU, Biblioteka ndërkulturore, Bazel, Zvicër)**

Ndjenja e bashkësisë ndërmjet prindërve, të cilët vijnë në mbledhjet prindërore ose në takimet me prindërit tjerë është njësoj shumë e rëndësishme. Diversiteti i prejardhjeve gjuhësore mund të valorizohet duke i ftuar prindërit, që t'i përshëndesin të tjerët në gjuhën e vetë. Kjo mund të bëhet me kartela të cilat do të ngelin të dukshme gjatë takimit dhe do të përdoren më vonë në klasë – përshëndetja e fëmijëve në gjuhën e tyre amtare për çdo mëngjes.

#### **Rrezikimi dhe vetëbesimi:**

Nxënësit, të cilët frikohen se do të ekspozohen në përqeshje dhe turp, nuk janë të gatshëm të rrezikojnë e të thonë diçka gabimisht. Shumë fëmijë, qysh herët në shkollë mësojnë se gabimet janë shenjë e dobësisë dhe mungesës së inteligjencës. Sjellja e mësuesit mund të nxit bindjet e këtilla ose sistematikisht mund t'i ndryshojë ato bindje. Çka mund të bëjnë mësuesit, që t'i nxisin nxënësit të rrezikojnë të bëjnë gabime? Si mund t'iu ndihmojnë, që të kuptojnë se më së miri mësojnë nga gabimet tona dhe se është ndjenja e shkëlqyeshme, kur të tejkalohen gabimet, pasi të kuptohen ato.

Bisedoni me nxënësit për bërjen e gabimeve - mund të jepni citate për dobinë e gabimeve, si p.sh. nga Ajnshtajni "Personi që kurrë nuk ka gabuar, asnjëherë nuk është përpjekur të bëjë diçka të re", ose nga Gandi "Nuk ia vlen të kesh liri, nëse nuk ke liri të gabosh".

Nxënësit mund të përfshihen në grupe të vogla, që të hulumtojnë se çka nënkupton për ta "gabimi" dhe si ai iu ndihmon në mësim. Rezultatet e grupit

prezantohen para të tjerëve. Poentat më të rëndësishme të vlerës së gabimeve grumbullohen dhe pasurohen me informacionet e dhëna nga mësuesi. Për shembull, gabimet duhet të nxisin nxënësit të mos heqin dorë dhe të shfaqin këmbëngulje dhe qëndrueshmëri – që në fakt janë cilësitë e nxënësve të mirë. Rezultatet mund të zhvillohen në rregulla për gabim në klasë.

#### **Ndikimi dhe kontrolli:**

Po ashtu klima pozitive në klasë, varet nga ndenja e kontrollit dhe mundësia për të vepruar. Thënë ndryshe, nxënësit ndjejnë se mund të ndikojnë në atë që ndodh në klasë, e shohin veten si faktorë aktivë, e jo si viktime të rrethanave. E njëjta vlen edhe për mësimdhënien, ku nxënësi është në qendër të vëmendjes dhe në fokusin ndaj kompetencës, që nxënësit duhet të përvetësojnë, e jo në temat të cilat duhet t'i mbulojnë mësuesit.

Dhënia e nxënësve mundësi për atë se ku, çka dhe si do të mësojnë dhe çka duhet të arrijnë është përfshirë në pjesët përkatëse. Po ashtu mësuesit duhet të mendojnë se cilat vendime do t'i ndajnë me nxënësit, si për shembull, kur do të bëjnë pauza, kur do të shërbehet ushqimi, kur do të dorëzohet projekti ose ku dëshirojnë të shkojnë në ekskursion dhe pse.

Rregullat tjera mund ta përfshijnë sjelljen e mësuesit, si për shembull nxënësit të mund ta ndërpresin rrjedhën e mësimin, nëse diçka e kanë të paqartë (p.sh. “Më ndërprisni”, e përshkruar në Saphier et al., fq. 343 ff. Po ashtu mund të ketë rregulla për pyetjet e mësuesve, si p.sh. mësuesit duhet t’iu shmangen çështjeve, të cilat i hutojnë dhe turpërojnë nxënësit, ose çështje të kuptimit, të cilat mund të përgjigjen me “po” dhe “jo”. Për hartimin e rregullave të sjelljes në klasë shih 2.4., Aktiviteti 1.

#### **Informacione plotësuese dhe referenca:**

Saphier, J., Haley-Speca, M.A., Gower, R. (2008). Mësuesi i shkathtë. Ndërtimi i shkathtësive tuaja si mësues. Acton, MA (Kapitulli i ambientit në klasë)

[Mësim i nxënësve për t'i pranuar gabimet](#) nga Edutopia

[Fuqizimi i mësimin duke ua dorëzuar nxënësve kontrollin](#) nga (KnowledgeWorks) (Dija funksion)

## Aktiviteti 2: Rrethi i brendshëm dhe i jashtëm



### Pse është me rëndësi?

- Të gjithë nxënësit mund të shprehen në të njëjtën kohë dhe për një kohë të shkurtër të aktivizohen me nxënës të ndryshëm
- E përmirëson aftësinë për të folur dhe për të dëgjuar

### Për çka bëhet fjalë?

- Rrethi i brendshëm dhe i jashtëm mund të përdoret për njoftim të ndërsjellë të nxënësve në kohë të shkurtër, ose të mësohet se çka mendojnë të tjerët për ndonjë temë të caktuar
- Zbatimi i strategjisë për mësim të gjuhës, e cila nxit shkëmbim të diturive ndërmjet nxënësve
- Përfshirja e ndërsjellë e nxënësve

### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Hapësirë të mjaftueshme që fëmijët të zgjerohen
- Pyetjet, të cilat i parashtrajnë mësuesit

### Përshkrimi i aktivitetit:

Kjo teknikë e diskutimit iu mundëson nxënësve, që për një periudhë të shkurtër të shkëmbejnë mendime, dituri dhe interesa përmes interaksionit me të tjerët në mënyrë të strukturuar. Mësuesi formon dy rrethë të dijes dhe sinjalizon, kur rrethi i jashtëm duhet të lëviz, që secili nxënës të merr partner të ri për bisedë.

Hapi 1. Pjesëmarrësit formojnë rrethë të përqendruara të kthyer kah njëri tjetri, ashtu që secili fëmijë ka partner nga rrethi tjetër.

Hapi 2: Mësuesi parashtron pyetje, ndërsa secili nxënës i ka disa sekonda për të menduar para interaksionit me partnerin. Pyetja mund të shënohet në dërrasë, që nxënësit të përkushtohen gjatë bisedës. Nxënësit i ndajnë mendimet e tyre me nxënësit tjetër përballë tyre. Mësuesi mund ta strukturojë këtë ushtrim, ashtu që në fillim do t'i ftojë nxënësit e rrethit të brendshëm, të tregojnë se çka mendojnë, ndërsa më pas do të jep sinjal se kur do të përgjigjen nxënësit e rrethit të jashtëm.

Hapi 3: Mësuesi jep sinjale dhe i fton nxënësit në rrethin e jashtëm të lëvizin një hap djathtas ose një hap majtas. Nxënësit ua tregojnë përgjigjet e tyre partnerëve të rinj. Pas një kohe mësuesi mund të vendos të parashtrijë pyetje të re, ose të prezantojë temë të re për diskutim.

**Informacione plotësuese dhe referenca:**

[Rrethi i brendshëm dhe i jashtëm](#) nga theteachertoolkit.com

Bennett, B., Rolheiser, C. (2001). Beyond Monet: The Artful Science of Instructional Integration. Toronto, Ontario: Bookation.

**Aktiviteti 3: Riorganizimi i klasës****Pse është me rëndësi?**

- Rregullimi i hapësirës dhe infrastruktura janë pjesë e rëndësishme e mjedisit mësimor. Ato mund ta lehtësojnë mjedisin mësimor ose mund të krijojnë barriera për interaksion

**Për çka bëhet fjalë?**

- Mënyrat se si mësuesit mund ta ndryshojnë mjedisin fizik mësimor, duke i shqyrtuar nevojat mësimore të nxënësve
- Mundësimi i strukturës fleksibile për organizim të karrigeve, me qëllim të lehtësim të mësimit dhe përfshirjes së nxënësve në interaksione dhe aktivitete konkrete

**Metodat dhe veglat e nevojshme**

- P.sh. dyshekë, jastëk të mëdhenj për këndin e leximit
- Mobicie tjera dhe perde për të ndarë hapësirat mësimore

**Përshkrimi i aktivitetit:**

Shkollat tradicionale e kanë mësuesin në qendër të vëmendjes dhe nuk lejojnë mësim të diferencuar, gjegjësisht mësim të personalizuar të mësimit të nxënësve. Mësuesit mund ta përdorin listën për kontrollim të mjedisit mësimor ose pyetjet vijuese për të shqyrtuar orarin aktual në klasë:

- A përfshin klasa zona të ndryshme mësimore (p.sh. mësim në rreth, hapësirë për punë individuale në detyra, hapësirë për punë në grupe)?
- A janë materialet mësimore në dispozicion dhe lehtësisht të qasshme për të gjithë fëmijët?
- A mund fëmijët të përfshihen në lojëra ose në lexim të librave, pasi ta përfundojnë detyrën?
- A mund fëmijët të ulen në vende të ndryshme, në vend se të ulen në një vend
- A kanë fëmijët të drejtë vote gjatë rregullimit të mjedisit të tyre mësimor

Mësuesi dhe nxënësit mund të mendojnë së bashku për rregullimin hapësinor të klasës dhe mënyrën se si klasa të bëhet më e individualizuar ose më funksionale



**Fotografia 25: Karrige të ngjyrosura në mënyrë individuale**



**Fotografia 26: Këndi i leximit**

për mësim nga nxënës të caktuar. Për shembull, fëmijët mund të ftohen të ngjyrosin karrige të thjeshta, të cilat përdoren në rreth (Fotografia 25).

Nëse fëmijëve iu jepet mundësi të lexojnë ndonjë libër ose të luajnë, kur ta përfundojnë detyrën – ose thjesht kur t'iu nevojitet pauzë – atyre mund t'iu ndërtohet një kënd i leximit me jastëk dhe dyshekë komfort, ndoshta edhe me perde, që të kenë rehati dhe komoditet (Fotografia 26).

**Informacione plotësuese dhe referenca:**

[Rregullimi i ambienteve mësimor](#) nga Edutopia

[Insturmentariumi për krijimin e mjediseve miqësore mësimore dhe gjithëpërfshirëse për fëmijët](#) nga UNESCO, Bankog (Broshura 1).

[Churermode](#)ll – tre zonat mësimore në klasë (gjermanisht). Shih edhe Gartin et al. (2016)





## Aktiviteti 4: Ushtrimi për grupim fleksibil – rebusi grupor



### Pse është me rëndësi?

- Grupimi fleksibil e pengon përjashtimin, që shpeshherë vërehet te grupet fikse
- Ndarja e nxënësve në grupe bazohet në detyrat dhe suksesin, që duhet të arrihet bashkërisht e jo në bazë të karakteristikave të nxënësve; pra këtu promovohet mësimi kooperativ

### Për çka bëhet fjalë?

- Grupimi fleksibil iu mundëson nxënësve të punojnë në grupe të ndryshme dhe ta njohin kompetencën e tyre në situata të ndryshme
- Metoda e mësimi kooperativ, përmes të cilit nxënësit njoftohen mes vete dhe i tejkalojnë konfliktet etnike (njihet si metoda e rebusit)

### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Letra dhe stilografi për nxënës ose flip çart për përmbledhje të rezultateve
- Mund të jetë në ndihmë të vizuelizimit të rebusit grupor

### Përshkrimi i aktivitetit:

Rebusi grupor iu mundëson nxënësve të punojnë në grupe të ndryshme me detyra të ndryshme dhe t'i ndajnë rezultatet me gjithë klasën. Në thelbin e rebusit grupor ka një problem, i cili duhet të zgjidhet ose pyetje e cila duhet të përgjigjet. Rebuset grupe mund të përdoren për hartim të rregullave në klasë, planeve aksionare për ndryshim të mjedisit shkollor, por edhe për tema të rregullta mësimore. Nxënësit varen mes vete për shkak se për ta plotësuar rebusin, duhet ta ndajnë detyrën mes vete dhe të zhvillojnë interaksion ndërmjet grupeve të ndryshme.

Ekzistojnë dy qasje për ndarjen e detyrave ose pyetjeve të grupeve dhe për organizim të shkëmbimit:

- (1) Secili grup punon në të gjitha pyetjet dhe detyrat, të cilat iu janë ndarë nxënësve të caktuar
- (2) Secili grup punon në një pyetje ose detyrë, që i është dhënë një grupi

### Procedura 1:

Klasa ndahet në dy grupe, ashtu që secilit nxënës në grup i jepet nga një detyrë ose temë pune. Për shembull, tema kryesore është Lufta e Dytë Botërore



dhe nxënës të caktuar hulumtojnë temë konkret si p.sh. Hitleri, kampet e përqendrimit, rezistenca e Francës etj. Pas një kohe të caktuar, nxënësit e grupit të njëjtë referojnë për gjetjet (konstatimet) dhe idetë e tyre. Grupi bisedon për të gjitha temat dhe mes vete shkëmben informacione kthyesë, i plotëson informacionet e disponueshme si dhe i shqyrton faktet alternative. Pastaj mësuesi kërkon që të gjithë nxënësit e grupeve të ndryshme, të cilët kanë pasur temë të njëjtë t'i shkëmbejnë mes vete gjetjet dhe mendimet. Në këtë mënyrë, nxënësit bëhen njohës të mirë të temës së tyre dhe përvetësojnë kuptim më të thellë, gjë që iu mundëson të zhvillojnë prezantim para gjithë klasës ose të përgatisin dokumentacion për temën.

#### **Procedura 2:**

Klasa ndahet në grupe, ku secilit grup i jepet nga një pyetje ose temë për punë. Për shembull, tema “Si mund ta planifikojmë fushën e sportit për shkollën tonë?” Këtu formohen tre grupet; grupi i parë ka për detyrë të vizatojë hartën e fushës së sportit, grupi i dytë e harton listën e pajisjeve, të nevojshme për fushën e sportit. Grupi i tretë përpilon një listë të vullnetarëve potencial, të cilët ndihmojnë gjatë ndërtimit të fushës së sportit dhe i shqyrtojnë mundësitë për grumbullim të mjeteve të nevojshme. Pas një kohe të caktuar të tre grupet përzihen mes vete. Secili grup i përzier zhvillon plan, i cili përfshin informacione të disponueshme dhe ide për hartën, pajisjet e nevojshme dhe mënyrat e grumbullimit të mjeteve. Në fund, të tre planet prezantohen dhe konsolidohen në një plan të përbashkët.

#### **Informacione plotësuese dhe referenca:**

[Moduli 2 i UNICEF-it për trajnim të trajnuesve](#), Aktiviteti 2.2.3 e përdor metodën me të rriturit

[Klasa-rebusi](#)

[Teknika e rebusit](#) në Educationworld.com




## 2.4 SHFRYTËZIMI I VEGLAVE DHE STRATEGJIVE PËR MBËSHTETJE TË TË GJITHË NXËNËSVE

### Sfondi

Aspekti i katërt që duhet të shqyrtohet, kur mendohet rreth praktikave gjithëpërfshirëse për mbështetje të të gjithë nxënësve është qasja dhe përshtatshmëria e veglave dhe strategjive, të cilat i përdorin të gjithë nxënësit gjatë mësimit. Mësuesit mund ta lehtësojnë mësimin përmes sigurimit të mjeteve dhe përdorimit të metodave, të cilat iu ndihmojnë nxënësve të kuptojnë, atë që e kanë mësuar dhe si është ndërlidhur dituria e tyre me mësimdhënien në klasë. Portofoli i të mësuarit është metodë, më të cilën bëhen të dukshme rezultatet për nxënësit, mësuesit dhe prindërit. Këtu janë dhënë mjetet për drejtimin e klasës, për shkak se me menaxhimin e mirë maksimalizohet koha e paraparë për mësimdhënie. Si metoda për angazhimin e nxënësve janë prezantuar marrëveshjet për mësime.

### Informacione për përdoruesin

Me anë të këtyre mjeteve lehtësohet dhe mundësohet aktiviteti, ndonëse ato nuk realizohen si aktivitete të nxënësve. Në vend të kësaj, idetë dhe propozimet e shfaqura këtu ndihmojnë gjatë drejtimit të klasës ose zbatohen për të lehtësuar aktivitetet në klasë. Ekzistojnë shumë strategji, të cilat mësues mund t'i përdorin në mbështetje të mësimdhënies. Këtu janë dhënë qartë vetëm disa sosh. Shumë prej këtyre mjeteve hasen edhe si aplikacione për telefona të mençur (smart), për tabletë dhe për kompjuterë. Edhe pse gjithandej janë të përhapura dhe zakonisht janë falas në internet, këtu nuk janë të përfshirë në mënyrë sistematike, për shkak se supozohet se shumë klasa nuk kanë qasje në WLAN, që të mund nxënësit t'i përdorin si vegla përkatëse.



## Aktiviteti 1: Veglat për drejtim të klasës



### Pse është me rëndësi?

- Në shumë klasa, një pjesë të konsiderueshme të kohës për mësim humbet për shkak të paqartësive. Këtu do të ndihmojnë veglat për fokusim të vëmendjes dhe vigjilencës së nxënësve në lidhje me detyrën e dhënë
- Zhvillimi i rutinave dhe “Rendi i qartë shtëpiak”, por edhe delegimi i detyrave të nxënësve do ta maksimalizojë kohën për mësim

### Për çka bëhet fjalë?

- Zhvillimi i rutinave dhe procedurave të qarta, të cilat iu ndihmojnë nxënësve ta fokusojnë vëmendjen dhe të marrin pjesë në mënyrë konstruktive në aktivitetet shkollore
- Përdorimi i mënyrave konstruktive dhe ato të pjesëmarrjes për zgjidhjen e problemeve me sjelljen në klasë

### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Materiale dhe vegla të ndryshme

### Përshkrimi i aktivitetit:

Ekzistojnë shumë vegla të disponueshme, të cilat mund t’iu ndihmojnë mësuesve ta drejtojnë klasën, me qëllim që nxënësit të kalojnë kohë maksimale duke punuar në detyrat e dhëna. Ka më shumë mënyra për të fituar dhe ruajtur vëmendjen dhe interesin e nxënësve, por edhe për promovimin e marrëdhënieve pozitive ose zgjedhjen e konflikteve ndërmjet tyre. Këtu janë dhënë vetëm disa propozime. Me rëndësi është që këta vegla të përdoren, për të krijuar rutinën, të cilën nxënësit do ta internacionalizojnë në afat prej disa javëve.

### Përdorni vegla për mbështetje të sjelljes pozitive të nxënësit:

Drejtimi i mirë i klasës, lidhjet e fuqishme dhe qartësia e mësimit ka të bëjë me disiplinën pozitive. Kur një grup i fëmijëve mësojnë së bashku, pritjet të ketë ndonjë çrregullim, andaj më me rëndësi është të përgatiteni për t’i minimalizuar ndërprerjet dhe për mbështetje të sjelljes pozitive të nxënësve. Nëse nxënësit e dinë se çka të presin dhe si mësuesi përdor vegla, me të cilat do t’iu ndihmojë të organizohen dhe të ngelin të fokusuar, atëherë do të ketë ndërprerje të shkurtra. Këtu janë dhënë disa vegla, të cilat mund t’i përdorin mësuesit për këtë qëllim:



Fotografia 27: Kohëmatësi



Fotografia28: Semafor

### Kohëmatësi

Nxënësve iu jep ndihmë vizuale për kohën që e kanë në dispozicion për përfundimin të detyrës. Mund të përdorin orë të thjeshtë me kohëmatës, [kohëmatës on-lajn](#) që shfaqet në kompjuter ose të paraqitur në mur ose në ekran me anë të projektorit, orë me rërë ose kohëmatës të rëndomtë. Mësuesi duhet të jetë i sigurt se të gjithë fëmijët e kuptojnë sistemin dhe dinë t'i interpretojnë informacionet. Disa fëmijë me vështirësi gjatë mësimit mund të kenë probleme me orë digjitale, të cilat paraqesin vetëm numra

### Semafori

Semafori mund të jep një informatë vizuale kur ka shumë zhurmë në klasë- pa bërë turp mesimdhënësi. Duhet të përdoret përttë gjithë klasën, e jo për nxënës të veçuar.

### Kartela

Kartelat mund të përdoren në mënyra të shumta, për t'iu ndihmuar fëmijëve të mbajnë mend gjëra. Për shembull, çdo fëmijë mund të vizatojë kartela me sjelljet më të rëndësishme pozitive dhe sociale (p.sh. respekti, vëmendja, durimi, nderi, kujdesi) dhe çdo mëngjes ose gjatë orës të përzgjedh njërin sjellje dhe të fokusohet në të. Mësuesi mund ta disenojë kartela më të mëdha dhe të zgjedh njërin për menaxhim të klasës gjatë orës. Mund të përdorë edhe kartela të laminuar/petëzuara, që t'ua ndan nxënësve detyrat në klasë.

### Kapëse

Secili nxënës e ka kapësen e vetë me emrin e tij në të. Kur nxënësit e kanë ndonjë pyetje gjatë punës në heshtje, ata e ngjitin kapësen e tyre në tel, nën kapësen e nxënësve tjerë. Pastaj mësuesi i fton nxënësit, kur t'iu vijë radha. Kapësja mund të vendoset edhe në karrigen e nxënësit ose në vend tjetër të dukshëm, që të sinjalizohet nevoja për ndihmë. Kapëset përdoren për ndarjen e nxënësve në detyra të ndryshme dhe për organizim të grupeve. Më shumë ide për punë me kapëset gjenden [on-lajn](#).


### Hartimi dhe zbatimi i rregullave në klasë

Përcaktimi i rregullave parqet instrument të rëndësishëm për menaxhim të klasës. Për klasën gjithëpërfshirëse me rëndësi është që rregullat të zhvillohen së bashku me nxënësit brenda një procesi pjesëmarrës. Mësuesit mund të fillojnë me disa rregulla themelore, për të cilat nxënësit do të bisedojnë, do t'i ndryshojnë, do t'i zgjerojnë ose do t'i shprehin me fjalë të tyre. Madje

nxënësit për ambientet paraprake mësimore, të cilat kanë qenë produktive dhe mbështetëse. Rregullat mund t'i vënë në pah këto pyetje:

- Sjellja ndaj nxënësve dhe mësuesve
- Respektimi i personalitetit dhe pronës
- Bashkëpunimi
- Kujdesi për klasën
- Mësimi kolaborativ
- Siguria e të gjithëve
- Përgjegjësia për mësimin personal
- Trajtimi i gabimeve si mundësi për mësim

Lejojuni nxënësve të ofrojnë formulim përfundimtar për rregullat në klasë dhe sigurohuni, që të gjithë i kanë kuptuar ato. Rregullat do të varen në klasë, që t'i shikojnë të gjithë. Pastaj bisedoni me nxënësit për atë se çfarë dënime do të përcaktohen në lidhje me shkeljen e rregullave, gjegjësisht çfarë shpërblime për respektimin e tyre. Mësuesi do të fokusohet në një rregull konkret gjatë orës, me qëllim që t'iu ndihmohet nxënësve që një nga një të përqendrohen në rregullat, përderisa të ndërkombëtarizohen ato.



Fotografia 29: Rregullat e klasës “E ruajmë rendin në klasë, me këmbë dhe çanta nën banka”

**Informacione plotësuese dhe referenca:**

[Vënia e rregullave në klasë](#) nga Asociacioni nacional për arsim  
[6.5 Rregullat, përgjegjësitë dhe detyrimet në klasë](#). Në “Promovimi i diturisë ndërkulturore”, Universiteti Pedagogjik i Cyrihut (fq. 81-82).

[6.7 Pakica](#) – Përdorimi i kartelave me pohime pozitive dhe negative për shkak të mësimit të nxënësve për dinamikën në grup dhe jashtë tij. Në “Promovimi i diturisë ndërkulturore”, Universiteti Pedagogjik i Cyrihut (fq. 83-84).

**Aktiviteti 2: Puna me paragjykimet e nxënësve****Pse është me rëndësi?**

- Nëse nuk i kushtohet vëmendje paragjytimeve të nxënësve, gjegjësisht informacioneve më ndryshe, nxënësit mund të kenë probleme të vazhdueshme me lëndë të caktuara
- Mbështetja e nxënësve për t'i rishikuar qëndrimet e tyre për vete, për të tjerët dhe për botën, iu ndihmon atyre të bëhen mendimtar kritik dhe nxënës reflektues

**Për çka bëhet fjalë?**

- Përdorimi i metodave dhe veglave të ndryshme për t'iu ndihmuar nxënësve në zhvillimin e të menduarit dhe në tejkalimin e bllokadave gjatë mësimit
- Zbatimi i strategjive mësimore për shkak të mësimit efektiv dhe të thellë

**Metodat dhe veglat e nevojshme**

- Veglat dhe metodat e ndryshme (shih më poshtë përshkrimin e aktivitetit)

**Përshkrimi i aktivitetit:**

Në vazhdim janë dhënë aktivitetet, veglat dhe metodat, të cilat mësuesit mund t'i përdorin, që të mësojnë më shumë në lidhje me dituritë paraprake, teoritë e përditshme dhe paragjykimet e nxënësve të tyre.

**Vlerësimi i njohurive paraprake**

Tradicionalisht mësuesit e testojnë diturinë pasi ta përcjellin dhe mbikëqyrin procesin. Ata mund të përdorin kuisë para ligjërimit, që të kuptojnë se çka dinë nxënësit për temën përkatëse. Po ashtu mësuesit duhet të përkujdesen, që nxënësit të mos frikohen nga dhënia “e përgjigjeve të gabuara”, por përkundrazi të kënaqen me mundësinë e dhënë për t'i hulumtuar dituritë e tyre dhe për t'u

motivuar të mësojnë më shumë për temën. Shfrytëzoni përgjigjet e nxënësve (pa mos zënë në emër asnjë nxënës), që ta theksoni atë që do të mësojnë në orën e mësimit. Mësuesit mund t'i përdorin të gjitha pyetjet pas përfundimit të orës, si dhe t'iu lejojnë nxënësve t'i krahasojnë përgjigjet.

Le të bëhen të dukshme dijet dhe mendimet e nxënësve  
Para se të ligjëroni ose të shpjegoni një koncept të ri, lutni nxënësit ta vizualizojnë diturinë e tyre për temën ose konceptin. Nxënësit mund të përfshihen në stuhinë e përbashkët të ideve dhe të zhvillojnë [hartë konceptuale](#) ose [hartë mendore](#) për t'i prezantuar idetë e tyre. Po ashtu, mësuesit mund t'i lusin nxënësit, t'i shënojnë pyetjet e tyre ose të potencojnë sfera të posaçme të interesit.

#### **Strategjitë e mira për parashtrim të pyetjeve në klasë**

Pyetje dhe përgjigjet e mësuesve mund të jenë të bezdisshme dhe dekurajuese në lidhje me nxënësit, të cilët nuk kanë përgjigje “të saktë”. Përmes miratimit të disa udhëzimeve në lidhje me bisedën efektive në klasë, mësuesit mund ta mbështesin mësimin e të gjithë nxënësve:

- Shmangni pyetjet, të cilat e sugjerojnë ose e përmbajnë përgjigjen. Përdorni sa më rrallë pyetjen “A”.
- Parashtroni pyetje të hapura, të cilat nuk e implikojnë drejtpërsëdrejti përgjigjen e saktë, që t'iu ndihmoni nxënësve ta hulumtojnë diturinë dhe kuptimin e tyre.
- Lusni nxënësit të japin shembuj ose ta hulumtojnë përgjigjen fillestare, që të mund të nxitni mësim më thelbësor.
- Mos e turpëroni nxënësin, duke insistuar për të marrë përgjigjen, gjë që mund t'i duket shumë armiqësore, por ftojeni të përfshihet në bisedë dhe të tregojë para nxënësve tjerë se çka mendon.
- Bëni pauzë edhe gjatë parashtrimit të pyetjes, edhe kur të merrni përgjigjen – së paku bëni pauzë prej pesë sekondash – para se të përgjigjeni ose të kërkoni përgjigje nga nxënësit. Kjo do t'iu ndihmojë nxënësve të mendojnë dhe të orientohen më shumë kah nxënësit tjerë të klasës.
- Parashtroni pyetje, të cilave nuk ua dini përgjigjet. Kjo do t'i inkurajojë nxënësit ta bëjnë të njëjtën dhe të bëhen më kureshtarë.

#### **Informacione plotësuese dhe referenca:**

[Si t'ia dalin nxënësit e me njohuritë alternative gjatë procesit të mësimit](#) nga Asociacioni i Psikologëve Amerikan.

[Parashtrimi i pyetjeve për përmirësim të mësimit](#) nga Qendra arsimore

[Parashtrimi i pyetjeve efektive](#) nga Qendra për arsim Çikago

### Aktiviteti 3: Marrëveshjet për mësim



#### Pse është me rëndësi?

- Nëse përpilimi i marrëveshjes është procesin në të cilin marrin pjesë edhe nxënësit, atëherë ata e rrisin interesimin për mësim, ndërsa mësimi bëhet më shumë i vetëorientuar
- Marrëveshja për mësim iu përcakton qëllime nxënësve, të cilët ecin shkojnë marrjes së notave të mira
- Ajo që është mësuar bëhet më e dukshme për mësuesit, nxënësit dhe prindërit

#### Për çka bëhet fjalë?

- Arritja e marrëveshjes ndërmjet mësuesit dhe nxënësit (ndoshta edhe prindërve) për qëllimet mësimore ose për sjelljen. Kushtet nuk duhet të jenë vetëm të njëanshme (t'i theksojnë vetëm qëllimet e nxënësit), por ato duhet ta përfshijnë edhe këndvështrimin dhe pajtueshmërinë e mësuesit
- Përcaktimi i marrëveshjes, me të cilën përforcohet raporti mësues-nxënës dhe angazhimi i përbashkët drejt qëllimeve të marrëveshjes

#### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Formular për marrëveshjen

#### Përshkrimi i aktivitetit:

Marrëveshja për mësim e përcakton qëllimin dhe kushtet e përvetësimit të kompetencave ose sjelljes në klasë dhe jashtë saj. Për dallim nga planet mësimore, të cilat i shënon mësuesi, marrëveshjet për mësim hartohen bashkërisht. Ato janë të mbështetura në pajtueshmëri, e jo në qëllime të imponuara mësimore të mësuesit ndaj nxënësit.

Para se të përcaktohet marrëveshja, mësuesi dhe nxënësi (edhe prindërit, nëse janë të përfshirë) duhet të kenë kohë dhe mundësi ta përcaktojnë gjendjen aktuale dhe të hartojnë qëllime, të cilat dëshirojnë t'i arrijnë. Edhe mësuesi edhe nxënësit duhet t'i shpalosin pritjet nga tjetri. Po ashtu, duhet të theksohet tema ose problemi, që të jepet udhëzimi i duhur (p.sh. të zgjidhet problemi i potencuar ose të mbështetet ndonjë talent i posaçëm).

Caktohet një takim, në të cilin të dy palët i prezantojnë qëllimet e parapara dhe pritjet e tyre (p.sh. në lidhje me mbështetjen). Definohen implikimet pozitive



nga respektimi i marrëveshjes, por edhe pasojat negative nëse ajo shkelet.


Gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes, mësuesi e ndjek respektimin e saj dhe ofron mbështetje, atëherë kur është e nevojshme. Nëse shkelet marrëveshja, atëherë hynë në veprim pasojat – preferohet që ato të vijën në shprehje pasi që fillimisht të tërhiqet vëmendja. Mësuesi dhe nxënësi kontaktojnë në lidhje me progresin ose vështirësitë e hasura.

Kur të përfundojë marrëveshja, zhvillohet një mbledhje që të bëhet një vlerësim për atë që është bërë dhe atë që pritet të bëhet në të ardhmen. Pas kësaj mund të përcaktohet një marrëveshje e re për mësim.

Nëse e përdorni për herë të parë, atëherë filloni me aktivitete të thjeshta, të cilat nxënësit mund t'i kryejnë pa shumë përpjekje, pastaj zgjidhni qëllime më të gjera mësimor dhe përdorni ato si vegla për ndjekje të progresit (mes tjerash edhe vetëmbikëqyrja, shih aktiviteti 2, kapitulli 4.3.)

**Informacione plotësuese dhe referenca:**

[Marrëveshjet dhe menytë e mësimi](#) të përpiluara nga Cindy Strickland



## Aktiviteti 4: Portofolat për mësim



### Pse është me rëndësi?

- Portofolat e mësimit e bëjnë të dukshëm suksesin e nxënësve, gjë që nuk mund ta bëjnë notat

### Për çka bëhet fjalë?

- Portofolat janë përmbledhje të punimeve të përgatitura nga nxënësit; ato mund të jenë përmbledhje fizike të punimeve të nxënësve, ueb faqe të krijuara nga nxënësit, ku janë theksuar ose grumbulluar punimet e nxënësit, ose fletoret me shembuj të punimeve të nxënësve. Portofolat mund të përmbajnë tekste, detyra me shkrim, shënime në ditar, punime vizatimore, gjësende fizike etj.

### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Do të varen nga lloji i portofolit

### Përshkrimi i aktivitetit:

Meqenëse portofolat e mësimit, gjegjësisht portofolat e nxënësve gjenden në forma dhe medime shumë të ndryshme, nuk është e thjeshtë të përshkruhet se si përpunohen ato. Përparësia e portofolave është që e bëjnë mësimin dhe progresin shumë të dukshëm. Po ashtu, ato kanë shumë më tepër karakter informativ se sa vetë notat.

Portofoli mund të hartohet për shkak të qëllimeve konkrete të informimit të mësuesve ose punëdhënësve të ardhshëm, në lidhje me shkathtësitë konkrete, dituritë dhe aftësitë e nxënësit. Edukatorët në kopsht mund t'iu ndihmojnë fëmijëve të hartojnë portofol të mësimit, me qëllim që t'i informojnë mësuesit e klasës së parë në lidhje me shkathtësitë konkrete, të cilat fëmija i ka përvetësuar (portofoli për tranzicion).

On-lajn portofolat japin mundësi për mësimi të TIK shkathtësive, duke iu shmangur problemit të grumbullimit të llojeve të ndryshme të punimeve të nxënësve (me ndihmën e video-sekuencave, audio dosjeve ose fotografive të punimeve), me çka ata do të jenë lehtë të kapshme për prindërit dhe mësuesit tjerë.

**Informacione plotësuese dhe referenca:**

[Përshkrimi i llojeve të ndryshme të portofolave të nxënësve](#) në [edglossary.org](http://edglossary.org)



# PJESA E TRETË



ZBATIMI

**PRAKTIK**

### 3.1 PLANIFIKIMI: PARASHIKIMI I DETYRAVE DHE RRETHANAVE

#### Sfondi

Planifikimi i një gjysmëvjetori, një jave dhe një ore është i rëndësishëm për aktivitetin e mësuesve. Tradicionalisht, kjo plotësisht bie në përgjegjësi të mësuesit. Madje mësuesit mund të mos ndjehen komfort, kur mendojnë për pjesëmarrjen e prindërve ose fëmijëve në planifikimin e mësimit. Në këtë drejtim, janë prezantuar disa aktivitete të planifikimit, përmes bashkëpunimit ndërmjet nxënësve, prindërve dhe personave tjerë profesional (p.sh. edukator i posaçëm (defektolog)). Këtu janë dhënë edhe ide plotësuese për mësimin e diferencuar përmes planifikimi të më shumë aktiviteteve, prej të cilave nxënësit mund të bëjnë përzgjedhje.

#### Informacione për përdoruesin

Pjesa e tretë është organizuar sipas hapave të procesit mësimit: planifikimi, implementimi dhe vlerësimi. Në klasat gjithëpërfshirëse këto hapa janë aktivitete të përbashkëta ndërmjet të gjithë pjesëmarrësve, me qëllim që nxënësit të mësojnë dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive. Nxënësit, të cilët marrin pjesë në planifikim ose janë të ftuar t'i shprehin qëndrimet dhe interesat e tyre, lidhur me temën përkatëse, do të kenë më shumë ndjenjë e pronësisë dhe do të mund të zhvillojnë pjesëmarrje me efektive. Shfrytëzuesi mund t'i përdor idetë e këtilla, që t'i kombinojë me aktivitetet tjera të përshkruara në pjesën e parë dhe të dytë.



## Aktiviteti 1: Vënia e pasaportës së kompetencës, ose pasaportës arsimore



### Pse është me rëndësi?

- Kur nxënësit kalojnë nga njëri mësues te tjetri, ose nga një shkollë në një shkollë tjetër, humben informacione të vlefshme për kompetencën, interesat dhe përparësitë e nxënësve, gjegjësisht edhe për fushat në të cilat nevojitet të mësohet më shumë
- Nxënësit e vetëdijshëm për mësimin e tyre kërkojnë në mënyrë aktive mundësi për të përvetësuar kompetencë më të madh

### Për çka bëhet fjalë?

- Vizualizmi i asaj që nxënësit dinë ta bëjnë në fusha të ndryshme të kompetencës si bazë për planifikim të mundësive të ardhshme për mësim
- Hartimi i dokumentacionit, me të cilin ndihmohet tranzicioni

### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Hartat ose pasaportat e kompetencës mund të përgatiten së bashku me nxënësit

### Përshkrimi i aktivitetit:

Pasaportat e kompetencës, gjegjësisht pasaportat arsimore paraqesin lidhje ndërmjet programeve mësimore nacionale dhe planifikimit të përditshëm shkollor. Ato iu shërbejnë dy qëllimeve kryesore: si pikë e parë, pritjet mësimore të jenë të dukshme për nxënësit, ndërsa si pikë e dytë, të dokumentohet ajo që e kanë përvetësuar nxënësit, gjegjësisht ajo që dinë ta bëjnë. Kjo është vegël, të cilën e përdorin edhe mësuesit edhe nxënësit, për shkak të “fotografisë më të gjerë” të mësimit dhe pjesëmarrjes së nxënësve. Në klasat tradicionale, mësuesi bën planifikim për gjithë klasën dhe harton përgatitjet ditore të mësimit, në bazë të programit mësimor. Planifikimi i individualizuar bëhet vetëm për fëmijët, të cilët kanë nevojë për mësim të individualizuar. Pasaportat e kompetencës mundësojnë planifikim të personalizuar për të gjithë fëmijët, për shkak se të gjithë ata i zhvillojnë kompetencat e tyre. Klasat gjithëpërfshirës shfrytëzojnë vegla të njëjta për planifikim, ashtu që të gjithë nxënësit e realizojnë programin mësimor në mënyrë fleksibile dhe me qasje konkrete.

Meqenëse pasaportat e kompetencës duhet të harmonizohen me programin mësimor dhe me pritjet e përgjithshme për suksesin e vendit ose shkollës, nuk mund të jepet shembull i cili do të jetë i përshtatshëm për të gjitha nevojat. Pasaportat e kompetencës mund të kenë ne fokus vetëm kompetencat

interdisiplinare. Fushat përkatëse të kompetencave mund të përfshijnë (kategoritë dhe hartat mendore për indikatorë siç janë zhvilluar në shkollën “Michael Strembitsky”, Alberta, Kanada):

- Mendimi kritik, zgjidhja e problemeve dhe marrja e vendimeve
- Komunikimi
- Kreativiteti dhe inovacioni
- Përgjegjësia sociale, kulturore, globale, si dhe përgjegjësia për mjedisin jetësor
- Spikatje në sferën digjitale dhe teknologjike
- Mësimi gjatë gjithë jetës, vetëkontrolli dhe mirëqenia
- Bashkëpunimi dhe lidhshipia

Nxënësit dhe mësuesit e vlerësojnë zhvillimin e kompetencës përgjatë rrjedhës nga:

- “Fillimi/shfaqja” përmes “Zhvillimit/evidencës” deri të “Pjekuria/shëmbëlltyra”
- “Fara” përmes “Fidanit” përmes “Drurit të zhvilluar” deri te “Druri me fruta”
- “Fillestari” përmes “Fillestarit të avancuar” deri te “Personit kompetent”, dhe “Eksperti”

Për vizualizim mund të përdorni:

- “Rrjetin e merimangës” ose lidhjen e radarit
- Shkalla Likert
- Hartat mendore për secilën sferë të kompetencës.

### **Informacione plotësuese dhe referenca:**

[Hulumtimi i zhvillimit të kompetencës interdisiplinare](#) – informacione për shkollën “Michael Strembitsky”

[Kompetenzpass](#) shkolla Cajningen, Zvicër (gjermanisht)

[Moduli 1 i UNICEF-it për trajnim të trajnuesve](#), Aktiviteti 1.4.1 “Mendimi për aktivitete e jo për detyra” e thekson rëndësinë për të shikuar aktivitetin në kontekst të situatës më të madhe jetësore, për të cilën nxënësit duhet të bëhen kompetentë.



## Aktiviteti 2: Planifikimi i mësimit për më shumë nivele dhe më shumë dimensione



### Pse është me rëndësi?

- Mësimi në më shumë nivele ka të bëjë me planifikimin e më shumë mënyrave për të angazhuar më shumë nxënës dhe për të lejuar rezultat të ndryshëm të secili nxënës një nga një rreth qëllimit ose konceptit të njëjtë themelor
- Nxënësit e talentuar, njësoj sikurse edhe nxënësit më të ngadalshëm ose nxënësit me aftësi të kufizuara, do të mund lehtë të heqin dorë, kur aktivitetet mësimore nuk janë të sajura sipas nevojave dhe interesave të tyre

### Për çka bëhet fjalë?

- Dhënia e shembujve për mundësinë e ndryshimit të mësimit për të njëjtin tregim
- Nxënësit formojnë grupe dhe marrin detyra të ndryshme për tregimin e njëjtë “Qepa” nga Huviler (2010, fq. 83). Mësuesi e zgjedh një modifikim mësimor dhe e realizon atë për tekstin e njëjtë.

### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Një tregim i shkurtër, si p.sh. “Qepa” nga Huwyler (shih më poshtë)
- Kartelat ose sllajdet me detyra për secilin grup, stacion pune dhe materiale

### Përshkrimi i aktivitetit:

Mësuesi e përzgjedh një tregim (në orë mësimi të gjuhës), një temë ose një koncept (ora e matematikës ose lëndëve natyrore) dhe i përfshin të gjithë nxënësit. Ndoshta gjatë planifikimit do ta përdorni piramidën e planifikimit (Aktiviteti 1 në Pjesën 2.1), që t'i përcaktoni nivelet e ndryshme dhe të mendoni për pesë pikat fillestare të planifikimit. Në shembullin e dhënë këtu, pikë nismëtare është Tregimi për “Qepën”:

*„Ekziston edhe tregimi për qepën. Jam i sigurt se ka një tregim të tillë. Gjatë kohë e kisha ndër mend t’ua tregoj. Në fakt, shpeshherë filloja t’ua tregoj, mirëpo gjithnjë kur filloja t’ua rrëfej tregimin për qepën, i cili fillonte kështu: “Shumë kohë më parë ekzistonte një qepë e bukur dhe me formë të rrumbullakët me lëvore të kuqe dhe të bardha, që shkëlqenin dhe me shtresa të lëngshme dhe të fuqishme...”, sytë filloni të më djegin dhe të më mbushen me lot, andaj nuk*

*mundja të vazhdojë. Tregimi refuzon të rrëfëhet. – Ju lutem përpuni vetë të vazhdoni më tej” (Huwylar, 2010, fq. 83).*

Mësuesi mund t'i shqyrtojë këto pyetje:

Cili është niveli i njohjes së gjuhës nga nxënësit e mi? Si mund ta bëj tekstin të kapshëm për të gjithë nxënësit? Mësuesi mund t'i zgjedh këto opsione:

- Ta përdor tekstin në gjuhë të ndryshme, që t'i përmbush nevojat e fëmijëve me gjuhë tjetër amtare
- Ta shkruajë tregimin me gjuhë më të thjeshtë (shih [Standardet evropiane](#))
- Të hartojë një sërë fotografi për ilustrim të tregimit (ose t'iu mundësojë nxënësve ta vizatojnë tregimin)
- Me telefon të mençur ta incizojë tregimin në audio version, që të mund fëmijët ta dëgjojnë

Çka dua të arrijnë nxënësit? Mësuesi mund t'i zgjedh këto opsione:

- Nxënësit mësojnë vokabular të ri (p.sh. shkruajnë kartela me fjalët kyçe në gjuhën e tyre dhe gjuhën mësimore)
- Nxënësit e shkruajnë vokabularin me fjalë të tyre dhe gjejnë më shumë sinonime
- Nxënësit e shkruajnë tregimin e tyre në lidhje me qepën në gjuhën e tyre të preferuar. Qëllimi i aktivitetit është që të shkruhen një tregim interesant, të cilin nxënësit tjerë do të dëshirojnë ta lexojnë.

Çfarë mbështetje mund të siguroj, që t'iu ndihmoj nxënësve në mësim?

- Udhëzim për “ndërtimin e skelës”, e cila do t'i shpie nxënësit nëpër tekst (p.sh. nënvizimi i fjalëve të rëndësishme me ngjyrë të gjelbër, ndërsa i atyre të vështirave me ngjyrë të kuqe).
- Kriteret për suksesin e rezultatit mësimor (p.sh. “Di që në mënyrë interesante t'ua lexoj tregimin të tjerëve”)
- Hartimi i udhëzimeve për mësim, duke përfshirë edhe përshkrimin e detyrës, qëllimet ose arsyet e aktivitetit, dhënien e informacioneve të nevojshme (p.sh. nocionet kryesore ose vokabulari), pyetjet të cilave duhet t'iu adresohen nxënësit etj.

Çfarë hapësira do të rregulloj në klasë, që të mundësoj përvoja të ndryshme mësimore?

- Zhvillimi i qendrave të ndryshme për mësim, ku grupe të vogla ose nxënës të caktuar do të përfshihen në aktivitete të ndryshme mësimore. Qendrat për mësim mund të kenë libra në gjuhë të ndryshme, fjalorë, harta ose resurse tjera. Nëse ka në dispozicion, mund të përdoren edhe kompjuterë ose vegla tjera mësimore.
- Përgatitja e aktiviteteve të ndryshme me detyrat e përshkruara në udhëzuesin për mësim të nxënësve të caktuar.

**Informacione plotësuese dhe referenca:**

[Krijimi i qendrave për mësim në klasë](#) nga thought.com

[Pesë llojet e stacioneve për mësim](#) nga Educationworld.com

**Aktiviteti 3: Druri i pritjeve****Pse është me rëndësi?**

- Pritjet e nxënësve kanë ndikim të madh ndaj mësimin. Kur pritjet janë të dukshme, mësuesit mund ta nxisin nxënësin edhe t'i tejkalojë ato
- Kur nxënësit i shprehin pritjet e tyre, mësuesit marrin vesh se çka i motivon dhe për çka shpresojnë. Ky është informacion i rëndësishëm, kur është fjala për planin arsimor

**Për çka bëhet fjalë?**

- Përdorimi i mjeteve vizuale, me ndihmën e të cilëve nxënësit i zhvillojnë pritjet në fillim të procesit mësimor
- Nxënësit, të cilët dinë, që në mënyrë retrospektive t'i krahasojnë pritjet me të arriturat e tyre, do të parashtrajnë qëllime më reale për të ardhmen

**Metodat dhe veglat e nevojshme**

- Flipçart, flomasterë, letër të gjelbër, ngjyrë kafe dhe ngjyrë portokalli, ngjitëse, fletë ngjitëse (për refleksion në fund të modulit)


**Përshkrimi i aktivitetit:**

Në fillim të vitit shkollor ose kur fillon njësisia e re mësimore, nxënësit ftohen t'i paraqesin pritjet e tyre për atë që dëshirojnë ta mësojnë. Ata qëndrojnë në grupe me nga tre deri në pesë persona në tavolinë dhe e dizajnojnë "Drurin e pritjeve" në flipçart ose në tabak të madh të letrës ngjyrë kafe. Mësuesi mund të sigurojë model të drurit, që më pas nxënësit t'i vënë idetë e tyre në pjesët përkatëse të drurit. Qasja tjetër është që në klasë të sillen një dru ose një degë, në të cilën nxënësit do t'i varin kartelat e tyre.

Nxënësit përdorin letër ngjyrë kafe, ngjyrë të gjelbër dhe ngjyrë portokalli, me qëllim që t'i shënojnë interesat dhe pritjet e tyre. Letra ngjyrë kafe e shënjon rrënjën dhe trungun e drurit, ku prezantohen temat kryesore me të cilat nxënësit dëshirojnë të merren, ose rezultatet kyçe që dëshirojnë t'i përmbushin. Letra ngjyrë portokalli i shënjon degët, duke prezantuar se çka iu nevojitet nxënësve, që t'i përmbushin rezultatet. Letra ngjyrë të gjelbër i

shënjon gjethet, gjegjësisht i paraqet interesat e posaçme të nxënësve. Mësuesit mund të vendosin të shtojnë edhe letrën e verdhë, ku nxënësit do të shënojnë se prej çka frikohen ose çka nuk dëshirojnë (mund të vendoset kudo qoftë).

Secili grup e plotëson drurin e vetë dhe ngjet afishen në vend të caktuar në klasë, që të gjithë nxënësit të mund ta shohin. Nxënësit ua prezantojnë grupeve tjera drunj të vetë. Afishja vendoset në një vend të sigurt, ose mësuesi e fotografon secilin dru, që të mund të shikohet edhe në fund të procesit të mësimi (shih Fotografia 30, Druri i pritjeve i hartuar nga pjesëmarrësit e punëtorive të UNICEF-it në Shkup të vitit 2016).



Fotografia 30: Druri i pritjeve

Në fund të orës mund përsëri të rishikohen drunjtë, që nxënësit dhe mësuesit të kenë sërish mundësi t'i komentojnë ato. Mësuesi mund të përdor fletë ngjithëse ose figurë të buzëqeshur (smiley) për të marrë informacione kthyes nga nxënësit.

Si alternativë e “Drurit të pritjeve”, mësuesi mund ta përdor metodën e “Lumit të jetës” të përshkruar në [Modulin 1 të UNICEF-it për trajnim të mësuesve](#), Aktiviteti 1.1.1., që mundëson të shikohet e kaluara dhe të zhvillohen qëllimet për orën e ardhshme dhe për rezultatet afatgjate.

### **Informacione plotësuese dhe referenca:**

[Druri i pritjeve](#) – Përshkrimi i aktivitetit nga Pro-shkathtësi (Pro-Skills)

[Lumi i jetës](#) – Përshkrimi i aktivitetit nga sktoolkit.org

### **Aktivitetit 4: Nxënësit dhe prindërit marrin pjesë në planifikimin e arsimit**



#### **Pse është me rëndësi?**

- Prindërit të cilët ndjehen të marginalizuar nga shoqëria duhet të inkurajohen, me qëllim që të shfaqet interes për përvojën dhe diturinë e tyre, me çka do të pasurohet mësimi i të gjithë nxënësve
- Marrja e këndvështrimit të mësuesit iu jep nxënësve dhe prindërve kuptim më të thellë për rolin e tyre personal dhe iu mundëson të kontribuojnë në mënyrë aktive, aty ku është e mundshme dhe e qëllueshme

#### **Për çka bëhet fjalë?**

- Përfshirja e nxënësve dhe prindërve në planifikimin arsimor
- Shfrytëzimi i përvojës dhe njohurive të prindërve për pasurimin e mësimi

#### **Metodat dhe veglat e nevojshme**

- Planifikues i orëve, për shkak të koordinimit të aktiviteteve

### **Përshkrimi i aktivitetit:**

Përfshirja e prindërve në shkollë mund të shkojë edhe përtej mbledhjeve prindërore dhe vizitave të shkollës. Në veçanti, në shkollat multikulturore, prindërit janë më të njoftuar me traditën kulturore, të cilën e ndajnë me prindërit tjerë, por jo edhe me mësuesin. Ndoshta ata janë rritur në vende, ku shkollat janë të organizuara shumë më ndryshe, andaj kanë pritje, të cilat nuk

janë të zbatueshme në shkollën ku e ndjek mësimin fëmija i tyre. Angazhimi i prindërve në planifikimin arsimor mundëson përfshirjen e tyre në shkollë dhe iu ndihmon ta tejkalojnë jazin, që për ndryshe mund të krijojë probleme në mësimin dhe pjesëmarrjen e fëmijës së tyre.

Mësuesit duhet të planifikojnë, t'i përfshijnë prindërit në temë, të cilën e kanë të njohur dhe me të cilën mund në masë të konsiderueshme të kontribuojnë në diturinë dhe përvojën e të gjithë nxënësve. Për shembull prindërit mund të shpjegojnë se si kremtohen festat dhe evenimentet e tyre fetare dhe kulturore, të përgjigjen në pyetjet e nxënësve dhe të tregojnë anekdota nga fëmijëria e tyre. Të gjithë prindërit duhet të kenë mundësi të kontribuojnë edhe në temat, si p.sh. profesioni ose puna e tyre, hobi i tyre i posaçëm ose aspektet tjera të jetës, të cilat përfshihen në programin mësimor dhe janë në interes të fëmijëve.

Takimet e prindërve mund të shërbejnë për të prezantuar dhe për të diskutuar së bashku me prindërit tjerë në lidhje me idenë. Kjo do të krijojë mundësi të shkëlqyeshme, që ata të njoftohen më shumë mes vete, por edhe me programin mësimor. Mësuesit duhet t'i nxisin prindërit ngurrues, që të sigurojnë edhe mbështetjen e tyre. Në planin vjetor mund të veçohen saktë datat, të cilat më së miri përputhen me programin vjetor, kur prindërit do të vijnë në shkollë, që t'i ndajnë përvojat e tyre me të tjerët. Nëse ata punojnë në vende, të cilat mund të vizitohen, atëherë është më mirë që e gjithë klasa të shkojë t'i vizitojë atje, në vend se të prindi të vijë në shkollë.

Paraqituni prindit rreth gjashtë javë para planifikimit të vizitës dhe shihni a ka planifikuar gjithçka si duhet. Nxiteni angazhimin e fëmijës së tij, si në planifikim po ashtu edhe gjatë vetë ngjarjes. Mbështetni prindërit dhe fëmijët gjatë zhvillimit të ideve për përfshirje në klasë dhe për organizim të një eventi interesant dhe atraktiv për të gjithë nxënësit.

### **Informacione plotësuese dhe referenca:**

[Shfrytëzimi i profesionalizmit të prindërve për suksesin e nxënësve](#) nga Cheryl Boughton


## 3.2 VEPRIMI: SINKRONIZIMI I MËSIMDHËNIES DHE MËSIMIT

### Sfondi

Në këtë pjesë janë dhënë aktivitete të caktuara, me të cilat mësuesit dhe nxënësit angazhohen pozitivisht për ta mbështetë mësimin dhe pjesëmarrjen. Meqenëse nxënësit duhet të jenë aktiv, me rëndësi është që mësuesit dhe nxënësit t'i kuptojnë mirë stilet e dëshiruara të mësimin të nxënësve. Një strategji e rëndësishme është që përmes mësimin aktiv, t'iu ndihmohet nxënësve ta parashikojnë atë që do ta mësojnë e pastaj ta fokusojnë vëmendjen e tyre në të. Fakti që nxënësit do të bëhen mësues për një ditë ose një orë, ata më mirë do ta kuptojnë ndërlikueshmërinë e menaxhimit të klasës. Po ashtu, sinkronizimi i mësimdhënies dhe mësimin nënkupton përfshirje të prindërve, për ta mbështetë fëmijën e tyre atëherë kur është e nevojshme. Këtu mund të përdoret Udhëzuesi për lidhshmëri mes shkollës dhe shtëpisë.

### Informacione për përdoruesin

Mësimi lëndor i mësuesve dhe ndërtimi i diturive dhe kuptimit të nxënësve duhet të ndërlidhet në aktivitetin e përbashkët të mësimdhënies dhe mësimin. Me fjalë tjera, mësimdhënia dhe mësimi paraqesin proces interaktiv e jo rrugë një kahëshe. Fëmijët mund të ulen të qetë në vendet e tyre dhe në shikim të parë duket se dëgjojnë me vëmendje, mirëpo ata mund të jenë të zhytur në mendime ose të brengosur për diçka, që i defokuson. Vetëm kur nxënësit janë të inkuadruar në mënyrë aktive në ndonjë veprim, mësuesit mund të kuptojnë se çka mendojnë ata dhe a është ai aktiviteti i dobishëm për mësimin. Aktivitetet e përshkruara këtu janë komplementare me aktivitetet e përshkruara në pjesën e dytë. Në fakt, parimet e konceptit mësimor universal do të mundësojnë angazhim të të gjithë nxënësve (shih pjesa 2.1).



## Aktiviteti 1: Njohja e stilit të të mësuarit dhe aftësitë ekzekutive të nxënësve



### Pse është me rëndësi?

- Në arsimin gjithëpërfshirës respektohet stili i dëshiruar i mësimit të fëmijëve, gjë që iu ndihmon të bëhen nxënës të pavarur dhe të vetëorientuar (kompetenca personale)
- Shumë fëmijë nuk arrijnë të korrin sukses, për shkak se nuk i kanë të zhvilluara shkathtësitë e nevojshme për vetëdije dhe vetëorientim – e jo për shkak të mungesës së inteligjencës së mjaftueshme. Mësuesit duhet të mund t'i zbulojnë fëmijët, të cilët duhet t'i zhvillojnë këto shkathtësi

### Për çka bëhet fjalë?

- Vetëvlerësimi i nxënësve si pikë fillestare për përmirësim të mësimit

### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Pyetësor (shih më poshtë)

### Përshkrimi i aktivitetit:

Mësuesit dhe nxënësit kanë shumë opsione të kuptojnë më shumë për mënyrat e dëshiruara të mësimit dhe për shkathtësitë e vetëorientimit të nxënësve. Mësuesit mund të vërejnë se disa nxënës janë më impulsiv dhe se heqin dorë pas dështimit të parë. Ata mund të shohin se disa nxënës janë më të motivuar dhe më të inkuadruar, kur ajo që mësohet mund të perceptohet me më shumë shqisa (shikimi, dëgjimi, prekja). Disa fëmijë dëshirojnë më shumë të punojnë në grupe, në të cilat bisedohet shume, ndërsa disa të tjerë duan të punojnë vetë dhe në kënde të qeta.

Nuk është gjithnjë e qartë pse fëmijët nuk arrijnë të mësojnë, të marrin pjesë ose të përqendrohen. Pra meqenëse fëmija vetëm mund ta ndryshojë shkathtësinë e dobët për mësim, me rëndësi është që nxënësit të mësojnë më shumë për shkaqet dhe të vetëdijesohen për sjelljen e tyre gjatë mësimit. Për këtë arsye, si hap i parë do të ishte e dobishme që nxënësit ta vetëvlerësojnë stilin e tyre të dëshiruar të mësimit. Me rëndësi është që të bisedohet me nxënësit për stilin e tyre të dëshiruar dhe për mënyrën se si do të mund t'i zhvillojnë shkathtësitë e nevojshme, si p.sh. fokusimi në përqendrimin e vëmendjes, qëndrueshmëria dhe kujdesi. Këto shkathtësi njihen edhe si “shkathtësi ekzekutive”.



Ndoshta te fëmijët e vegjël është më lehtë të pyetet personi i autorizuar (p.sh. prindi), në vend se të përdoret pyetësor. Mësuesit mund ta përdorin Shkallën e kompetencave sociale të fëmijëve, e cila përmban nënshkallë të shkathtësive prosociale/komunikatave dhe shkathtësi për rregullim emotiv.

Lucy M. Guglielmino ka hartuar Vlerësimin e preference për mësim me 19 pyetje, ku grumbullohen të dhëna për prirjen dhe qëndrimet ndaj mësimin. Pyetjet gjenden [on-lajn](#), mirëpo për të arritur deri te informacionet për klasifikimin e përgjigjeve, duhet të blihet pyetësori.

Peg Dawson dhe Richard Guare e hartuan një pyetësor për Shkathtësi ekzekutive të fëmijëve dhe adoleshentëve, i cili mund të gjendet [on-lajn](#) (së bashku me pikët). Ekziston edhe [Pyetësori për shkathtësi ekzekutive të fëmijëve](#).

Ekzistojnë disa pyetësorë lidhur me stilet e mësimin, të cilat plotësohen në internet. Megjithatë mësuesit mund t'i përdorin pyetjet edhe për krijimin e këtij pyetësori, të cilin nxënësit do ta plotësojnë në letër. Këto pyetje mund të mbështeten në preferenca shqisore ose në idenë për “më shumë inteligjenca” të shpалosur nga Howard Gardner:

- [Pyetësor](#) për dallimin e nxënësve vizual, auditiv dhe kinetik të “Shkolla në rrota”
- [Pyetësor për stilet e mësimin](#) nga O'Brian
- [Cili është stili juaj i mësimin?](#) nga educationplanner.org
- [Vetëvlerësimi i më shumë inteligjencave](#) nga Edutopia
- [Pyetësor për më shumë inteligjenca](#) për prindërit nga vizioni i mësuesve (TeacherVision)

Vetëvlerësimi ose vlerësimi nga tjetri është hapi i parë i të menduarit për stilet e mësimin dhe për funksionet ekzekutive. Me rëndësi është të ndiqet diskutimi për atë se si fëmijët ta përmirësojnë mësimin e tyre dhe si t'i përvetësojnë shkathtësitë për të qenë nxënës të suksesshëm.

### **Informacione plotësuese dhe referenca:**

[Shënime për stilet e të mësuarit në Wikipedia](#) ofron pasqyrim të teorive dhe qasjeve të ndryshme

[Sferat e funksioneve ekzekutive](#) shpjeguar nga “Kuptimi i mësimin dhe çështjet rreth vëmendjes”

## Aktiviteti 2: Festë me çaj – Ushtrimi i përbashkët për parashikim të tekstit



### Pse është me rëndësi?

- Kjo strategji interaktive para mësimit iu ndihmon nxënësve të bëjnë parashikimin e tekstit më të vështirë, i cili do të lexohet më vonë
- Nxënësit mundën të ndihmohen mes vete gjatë kuptimit adekuat të koncepteve kryesore, që janë të rëndësishme për të kuptuar tekstin

### Për çka bëhet fjalë?

- Nxënësit shkëmbejnë mendime dhe bisedojnë për atë që e kanë kuptuar
- Bërja e parashikimeve dhe njoftimi me mënyrën për “organizim të avancuar”, që të përmirësohet kuptimi i teksteve

### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Kartelat me fjalë ose me fraza kyçe nga tregimi
- Muzika ose forma tjera për matjes të kohës gjatë aktiviteteve dhe për drejtimin e punës në grupe

### Përshkrimi i aktivitetit:

Zgjedhni fjalë ose fraza kyçe nga teksti, të cilin dëshironi ta lexoni dhe shënoni ato në një fletë të madhe ose në ndonjë hamer. Shënoni flakët e njëjta nga teksti dhe kërkoni fjalë ose fraza me më shumë domethënie. Zgjedhni gjysmën e fjalëve ose frazave dhe bëni kopje dublikatë, që secili nxënës të merr një kartelë.

Jepjani nxënësve kartelat dhe tregojuni se çka duhet të bëjnë derisa dëgjohet muzika:


- Faza 1: Ndajeni kartelën tuaj me sa më shumë nxënës dhe punoni në çifte ose në grupe. Dëgjoni të tjerët, kur i lexojnë kartela e tyre dhe bisedoni për mënyrën se si këto kartela do të mund të ndërlidhen mes vete dhe çka mund të përmbajë teksti
- Faza 2: Kur të përfundojë muzika ose të bie zilja, ndani nxënësit në grupe me nga 4-5 anëtarë dhe shkëmbeni kartelat me të gjithë brenda grupit. Bisedoni për atë që e keni dëgjuar në fazën 1, cilat fjalë i keni parë dhe çfarë ndërlidhje ose supozime janë bërë. Mudnësoni

parashikime të mundshme për tekstin dhe theksoni fjalët, të cilat ju bëjnë të keni parashikime të sigurt. Për parashikimet e këtilla, nxënësit i përdorin njohuritë dhe përvojat paraprake.

- Faza 3: Në kuadër të grupit shënoni paragrafin “Ne mendojmë”, në të cilin do të jepni parashikime për temën e tregimit dhe do të shpjegoni se si grupi ka arritur në atë konkluzion.
- Faza 4: Ndani parashikimet me grupet tjera dhe bëni parashikim të përbashkët për tekstin.
- Faza 5: Lexojeni tekstin (së bashku ose individualisht) dhe ndajeni me parashikimin/parashikimet

**Informacione plotësuese dhe referenca:**

Përshkrim në Uikipedia për [avancimin e shkrim leximit](#) përmes disiplinave Shikojeni përshkrimin e metodës “[Festë me çaj](#)” në Jutub (Youtube) (si procedurë alternative)



### Aktiviteti 3: Nxënësit bëhen mësues për një ditë – mësimdhënia reciproke



#### Pse është me rëndësi?

- Mësimdhënia për një temë përkatëse e thellon njohurinë dhe zhvillon aftësi dhe shkathtësi të ndryshme
- Ndryshimi i perspektivës dhe shikimi i klasës përmes syve të mësuesit e thellon kuptimin se mësimi mund të zhvillohet në mënyra të ndryshme
- Disa nxënës nuk arrijnë të kenë kuptim adekuate për atë që nevojitet të planifikohet për orë mësimore, ku të gjithë nxënësit do të përfshihen në përvoja pozitive mësimore. Angazhimi i nxënësve në planifikimin arsimor mund të ndihmojë në fokusimin në aktivitetet relevante dhe interesante për ta

#### Për çka bëhet fjalë?

- Nxënësit e klasës së njëjtë mësojnë nga njëri tjetri ose shkojnë në klasa tjera, gjegjësisht nxënësit e klasave më të larta i mësojnë nxënësit e klasave më të ulëta, mundësisht kjo ndihmesë bëhet në temën që është në interesit të tyre të përbashkët
- Mësimi për rolet komplementare rreth temave të interesit të nxënësve

#### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Planet e thjeshta për orë mësimore për mbështetje të aktiviteteve të nxënësve për planifikim
- Planifikimi se si fëmijët të regjistrohen në orët me interes të posaçëm

#### Përshkrimi i aktivitetit:

Mësimi nga bashkëmoshatarët mund të organizohet në mënyra të ndryshme: nxënësit mund të përgatisin një orë të shkurtër për nxënësit e klasës tjetër ose t'i ftojnë të vijnë në ambient të posaçëm jashtë klasës, ku nxënësit tjerë do të mësojnë për temën e veçantë. Kjo mund të organizohet në nivel të shkollës (njëherë në muaj, mësim pasdite nga bashkëmoshatarët), si aktivitet i përbashkët i dy mësuesve ose si aktiviteti në kuadër të një klase.

Tregojuni nxënësve disa këshilla dhe marifete për përgatitjen e “orës” interesante dhe bisedoni me ta për atë që dëshirojnë të dëgjojnë nga bashkëmoshatarët ose si do të dëshironin të ndiqnin orën e “mësimdhënies”


nga bashkëmoshatarët e tyre. Këto informacione shfrytëzoni si bazë për përgatitjen e planit të orës, të cilin nxënësit e përdorin për t'u përgatitur.

Bëni plan për organizim të “orës” – filloni me organizim të thjeshtë, nëse nxënësit nuk janë me përvojë, sipas mundësisë filloni me një person të rritur, që do të ndihmojë organizimin dhe drejtimin e gjithë procesit.

Përkujdesuni që mësuesit e nivelit të njëjtë të kenë informacione kthyesë dhe mundësi për ta “përmirësuar” orën, ndoshta përmes mësimit nga bashkëmoshatarët për temën e njëjtë ose përmes përgatitjes për ndonjë temë tjetër.

**Informacione plotësuese dhe referenca:**

Informacione për [Mësim nga bashkëmoshatarët](#) nga InformED



## Aktiviteti 4: Libreza për lidhjen e shkollës me shtëpinë



### Pse është me rëndësi?

- Prindërit, të cilët e dinë se çka ndodh në shkollë mund të japin mbështetje më të mirë në shtëpi
- Observimet ose informacionet për incidentet e posaçme në shtëpi iu ndihmojnë mësuesve t'i mbështesin nxënësit në klasë

### Për çka bëhet fjalë?

- Shkëmbimi i informacioneve me interes dhe rëndësi të përbashkët
- Zhvillimi i ndjenjës së përgjegjësisë së përbashkët për mësim të fëmijës
- Ndjekja e zhvillimeve në shtëpi dhe në klasë

### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Duhet të përgatiten libreza për lidhjen e shkollës me shtëpinë (qoftë nga ekipi për të gjitha klasat, individualisht nga mësuesit e klasave, ose nga vetë nxënësit)

### Përshkrimi i aktivitetit:

“Librezat për lidhjen e shkollës me shtëpinë” ose “Librezat shtëpi-shkollë” mund të shërbejnë për qëllime të ndryshme. Më së miri është të kenë në fokus një ose dy qëllime, në vend se në ta të kumtohet gjithçka:

- Formularët ditorë për dokumentim të komunikimit mësues-prindër (formularë mund të grumbullohen në fashikull)
- Libreza për çështje organizative, informacione të rëndësishme dhe detyra të shtëpisë ruhet nga nxënësit, të cilët gjithnjë e mbajnë me vete dhe ua tregojnë prindërve, gjegjësisht mësuesve
- Të premtën fëmijët shënojnë se çka kanë mësuar gjatë javës në lidhje me prindërit e tyre (shih “Ditari i së premtës”), prindërit komentojnë dhe/ose shënojnë çka kanë mësuar fëmijët në shtëpi
- Billogu i klasës, prej të cilit prindërit informohen për aktivitete të rëndësishme shkollore (krijohet lehtë dhe falas përmes [Wordpress](#)) – nxënësit ose prindërit le të ndihmojnë të krijohet blloku dhe të jepni instruksione

Nëse keni zgjedhë librezë, mund t'i angazhoni nxënësit vetë ta krijojnë dhe të bisedojnë për atë që do të dëshironin të kumtohet (publikohet) në ta dhe sa shpesh. Ky do të jetë udhëzim për rubrikat, të cilat do t'i përfshini në librezë (nëse ka).

**Informacione plotësuese dhe referenca:**

Shembuj për [Ditarë dhe formularë për komunikimin mes mësuesve dhe prindërve](#)

Informacione si për shembull [Zhurnali i së premtes](#) nga Jamie Sears [Përmbledhje të formularëve](#), duke përfshirë edhe formularët për komunikimin prindër-mësues

[10 mënyrat sipas së cilave përdoren blogjet dhe Wordpress](#) në shkollë (shembuj të praktikës së mirë)

[Fëmijët krijojnë librezën e tyre](#) – përmban udhëzim për hartim të lehtë të librezave



### 3.3 EVALUIMI: KOMBIMIMI I RISHIKIMIT DHE REFLEKSIONIT

#### Sfondi

Kjo pjesë ka të bëjë me refleksionin dhe rishikimin e asaj që është mësuar. Në klasën tradicionale, kemi notim përmbledhës (sumativ) të asaj që është mësuar dhe ai bëhet në fund të rrjedhës mësimore. Për të siguruar mësim aktiv dhe për të përmirësuar shkathtësisë metakognitive të nxënësve me rëndësi është të fuqizohet notimi formues (formativ). Notimi formues ngjan paralelisht me procesin mësimor, ndërsa informacionet thyese përdoren për avancimin e mësimin, e jo për vlerësimin e nxënësit. Në fakt edhe mësuesi edhe nxënësi fokusohen në procesin e mësimin. Në aktivitetin e parë është përshkruar mënyra se si bëhet kjo. Megjithatë, pasi që mësuesit nuk mundën gjithnjë t'i ndjekin nxënësit, me rëndësi është që nxënësit të zhvillojnë shkathtësi dhe strategji për vetëbesim. Vlerësimi mes bashkëmoshatarve është efektiv, për shkak se fëmijët mësojnë nga njëri tjetri, si dhe i ushtrojnë shkathtësitë sociale gjatë dhënies së komenteve kthyesë të bashkëmoshatarëve të tyre. Në fund është përshkruar një metodë e thjeshtë për avancimin e vetëdijes dhe vetëmbikëqyrjes në klasë, duke e fuqizuar pozitivisht atë që e thekson kontributin e një nxënësi në dobi të gjithë klasës.

#### Informacione për përdoruesin

Katër aktivitetet e përshkruara këtu fokusohen në vlerësimin (notimin) formues, i cili është tipi më i rëndësishëm i vlerësimin për avancim të mësimin dhe pjesëmarrjes. Vlerësimi formues është orientuar drejt mësimin dhe meqenëse nxënësit duhet të jenë aktivë dhe të vetëorientuar, me rëndësi është t'u jepet mundësi nxënësve t'i ushtrojnë këto shkathtësi dhe të vetëdijesohen në lidhje me vetërregullimin ose mangësitë. Aktivitetet e përshkruara këtu mund të zbatohen vazhdimisht. Me fjalë tjera ato nuk janë aktivitete, të cilat mësuesit i realizojnë vetëm njëherë gjatë vitit shkollor, por për çdo ditë. Nevojitet kohë, që nxënësit t'i ndërtojnë shkathtësitë e nevojshme, andaj mësuesit nuk duhet të presin, që brenda një ore fëmijët do t'i përvetësojnë ato në mënyrë të përkryer.





## Aktiviteti 1: Sigurimi i informatave kthyes kuptimplote për nxënësit



### Pse është me rëndësi?

- Informacioni kthyes mund t'i inkurajojë ose t'i dekurajojë nxënësit. Informacioni i mirë kthyes jo vetëm që i inkurajon, por edhe i motivon nxënësit dhe iu jep informacione të rëndësishme për mësimin e mëtejshëm
- Dhënia e informacioneve kthyes është strategjia më efektive për t'iu ndihmuar nxënësve të arrijnë rezultate pozitive

### Për çka bëhet fjalë?

- Notimi formues i nxënësve, për shkak të mbështetjes në procesin e tyre të mësimin
- Dhënia e informacioneve kthyes në mënyrë që iu ndihmon nxënësve të mësojnë në vend se të ndjejnë se ndokush të gjykuar

### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Nuk nevojitet material i posaçëm

### Përshkrimi i aktivitetit:

Që të marrin nxënësit informacione të dobishme për mësimin dhe suksesin, fillimisht duhet të dinë se cili është fokusi i orës mësimore, gjegjësisht cili është qëllimi i përgjithshëm i aktivitetit ose projektit (shih aktivitetet në kapitullin 3.2). Sa më mirë dhe më qartë iu shpjegohet nxënësve vizioni për atë që dëshironi ta arrijnë, aq më shumë ato informacione do t'u ndihmojnë ta arrijnë atë që e kanë ndër mend.

Njësoj është me rëndësi që nxënësi të dijë se ku qëndron në raport me qëllimin, të cilin e keni parashtruar për klasën ose për nxënësin. Për këtë arsye mësuesi duhet të përgjigjet në punën ose të arriturat paraprake të nxënësit, të cilat drejtpërsëdrejti janë të ndërlidhura me detyrën ose projektin aktual dhe me qëllimet, të cilat duhet të përmbushen.

Përpos kësaj, nxënësve iu nevojiten informacione për mënyrën se si ta zgjedhin ndonjë problem dhe të fillojnë me aktivitetin. Shpeshherë, kur nxënësit nuk i kanë të qarta hapat e parë, humbet shumë kohë nëpër orët mësimore. Komponenti i tretë i rëndësishëm i informacionit të mirë kthyes është të kontrollohet se çka dëshirojnë nxënësit të bëjnë në vijim dhe t'iu ndihmohet ta fillojnë atë.


Thënë ndryshe, informacioni kthyes i mirë (fidbeku) ka tre qëllime:

1. Komente orientuese (fidup): përgjigje në pyetjet e nxënësve për atë se si ata e kuptojnë qëllimin dhe çka duhet të përpiqen të arrijnë: “Ku shkoj?”
2. Koment kthyes (Fidbek): përgjigjet në pyetjet e nxënësve për atë se ku gjenden dhe si iu shkon puna në lidhje me detyrën e dhënë: “Si më shkon?”
3. Koment udhëzues (fid foruad): përgjigjet në pyetjen e nxënësve për atë se si të fillojë me aktivitetin, gjegjësisht cili duhet të jetë hapi i parë më i mirë: “Çka pas?”

Nxënësit mund të aftësohen, që të parashtrajnë pyetje, me të cilat do të mund vetë të gjejnë përgjigjen – në vend se vazhdimisht të mbështeten të mësuesi, që ai t’ua drejtoje procesin e tyre të mësimit. Në fakt, nxënësit, të cilët dinë të mendojnë për mësimin ose për suksesin e tyre bëhen vetëorientues dhe efektivë në mësim. Ky është qëllim i rëndësishëm drejt të cilit duhet të aspirojnë shkollat.

#### **Informacione plotësuese dhe referenca:**

[Moduli 3 i UNICEF-it për trajnim të trajnuesve](#), Aktiviteti 3.2.4 Përdorimi i pohimeve për qëllimet mësimore gjatë dhënies së informacioneve kthyes  
[Fuqia e informacioneve kthyes](#) nga John Hattie në Jutub (Youtube),  
[Informacione](#) përkatëse në ueb-faqen [visible-learning.org](http://visible-learning.org)



## Aktiviteti 2: Strategjitë për vetëmbikëqyrje të nxënësve



### Pse është me rëndësi?

- Vetëmbikëqyrja gjatë mësimit është mënyrë e rëndësishme për përmirësim të mësimit dhe si e tillë iu ndihmon nxënësve të bëhen më efektiv dhe më të pavarur
- Aftësia për mbikëqyrje të sjelljes dhe aktiviteteve personale është njëra ndër shkathtësitë më të rëndësishme për në shkollë (= strategji metakognitive)

### Për çka bëhet fjalë?

- Mësuesit nuk duhet vetëm të supozojnë se të gjithë fëmijët kanë shkathtësi të mirë për vetëmbikëqyrje, por në mënyrë aktive duhet t'ua mësojnë këto shkathtësi dhe t'i mbështesin fëmijët me aftësi të dobët për vetëmbikëqyrje
- Strategjitë për vetëmbikëqyrje ndihmojnë në zhvillimin e sjelljes produktive të nxënësve me vështirësi emotive ose vështirësi të sjelljes

### Metodat dhe veglat e nevojshme

- Formulari ose lista e kontrollit për ndihmë të nxënësve gjatë vetëmbikëqyrjes
- Kartela me të cilat nxënësve iu përkujtohet sjellja pozitive

### Përshkrimi i aktivitetit:

Vetërregullimi ose shkathtësitë ekzekutive janë të domosdoshme për mësimit të suksesshëm. Fëmijët me prejardhje më të varfër ose ata me nevoja të posaçme ka më shumë të ngjarë, të kenë mangësi të shkathtësive të nevojshme. Disa fëmijë nuk janë të vetëdijshëm se çka bëjnë dhe nuk dinë ta ndjekin sjelljen e tyre.

Mësuesit mund t'i përdorin listat për kontrollim ose pyetësorët si pikë fillestare për bisedë në lidhje me vetëmonitorimin dhe vetëdijen (shih pjesa 3.2, Aktiviteti 1). Mirëpo atëherë theksi duhet të vendoset në atë që u ndihmon nxënësve të bëhen më të vetëdijshëm dhe ta kontrollojnë sjelljen e tyre. Mësuesit dhe nxënësit mund të merren vesh rreth sjelljes konkrete, të cilën nxënësit do ta vetëmonitorojnë në periudhë kohore, për të cilën paraprakisht janë marrë vesh. Mësuesit mund ta zgjedhin një vegël për drejtim të klasës, siç është prezantuar në pjesën 2.4, Aktiviteti 1, për potencim të kohëzgjatjes dhe fokusit të dëshiruar si p.sh., kartela me fotografi të sjelljes së dëshiruar. Mësuesi

dhe nxënësi mund të merren vesh edhe për mënyrën se si të shpërblehet ndryshimi i suksesshëm i sjelljes.

### **Informacione plotësuese dhe referenca:**

[Përdorimi i strategjive për vetëmonitorim](#) nga LearnAlberta

[Udhëzues për intervenime të vetëmonitorimit](#) nga Diana Askings McCarty

### **Aktiviteti 3: Strategjitë e vlerësimit të nxënësve nga ana e bashkëmoshatarëve**



#### **Pse është me rëndësi?**

- Përfshirja e nxënësve në dhënien e informacioneve kthyese pozitive (fidbek) iu ndihmon të bëhen nxënës të përgjegjshëm, qoftë duke qenë vetë, qoftë edhe gjatë bashkëpunimit me nxënësit tjerë
- Përfshirja e nxënësve në informacioneve kthyese mes bashkëmoshatarëve e zvogëlon barrën e mësuesit
- Nxënësit të cilët dinë të përfshihen në evaluimin pozitiv të bashkëmoshatarëve bëhen nxënës më kompetent dhe të aftë për t'u mbështetë mes vete, e jo të ngelin gjithnjë të varur nga komenti i mësuesit

#### **Për çka bëhet fjalë?**

- Integrimi i sekunecave të evaluimit mes bashkëmoshtarave në kuadër të orëve, iu mundëson nxënësve që bashkërisht të mendojnë për mësimin, pjesëmarrjen dhe suksesin e tyre
- Krijimi i kulturës së klasës, ku nxënësit janë pjesë e bashkësisë që mëson, në vend se të mësojnë në izolim

#### **Metodat dhe veglat e nevojshme**

- Lista e kontrollimeve, rregulla për dhënie të informacioneve kthyese, formularë për qëllime konkrete
- Koha e prezantimit dhe vlerësimit të rregullave për dhënie të informacioneve kthyese, gjegjësisht për zbatimin e listave të kontrollimit

**Përshkrimi i aktivitetit:**

Mësoni vazhdimisht nxënësit për mënyrat e dhënies së informacioneve kthyesë kuptimplota për bashkëmoshatarët, si për shembull:

- Rregulli i informacionit kthyes “sandviç”: një koment pozitiv – një kritikë konstruktive për shpjegim të mënyrës se si të përmirësohet ajo – dhe një koment pozitiv
- Potenconi fjalë adekuate për të shprehur kritikë, d.m.th. përmes elaborimit të shkaqeve ose me ndihmën e kriterëve të përbashkëta për të përshkruar pse diçka ka qenë mirë/jo aq mirë/jo mirë
- Mësojani shkathtësitë themelore të domosdoshme të komunikimit për informacion kthyes pozitiv
- Potenconi disa “fjalë fillestare” për informacione kthyesë konstruktive mes bashkëmoshatarëve

Merruni vesh për kriteret, të cilat do të përdoren për informacione kthyesë të bashkëmoshatarëve gjatë një sekuence ose detyre konkrete (p.sh. pohimet për qëllimet mësimore, kriteret e suksesit etj.), të cilat nxënësit do t'i përdorin për dhënie të informacioneve kthyesë të bashkëmoshatarëve. Kriteret duhet drejtpërsëdrejti të ndërlidhen me qëllimet mësimore, të cilat i keni theksuar në fillim të sekuencës mësimore dhe me rezultatet e pritura. Filloni me informacion kthyesë të shkurtër të dhënë nga ndonjë nxënës për evaluim të ndonjë aktiviteti ose detyre të shkurtër të bashkëmoshatarit. Mund të kërkonte nga të gjithë nxënësit, që janë prezent, të shënojnë nga një ose më shumë fjali lidhur me përvojën e dhënies ose pranimit të informacioneve kthyesë dhe si mund ato të përmirësohen për herën tjetër.

**Informacione plotësuese dhe referenca:**

[Si ta përdorni evaluimin mes bashkëmoshatarëve me nxënësit tuaj](#) nga


[Nxënësit në qendër të vëmendjes](#)

[Mësoni nxënësit se si të bisedojnë](#) nga Edutopia

[Fjalët hyrëse për informacione kthyesë të bashkëmoshatarëve](#) nga

Throughtheclassroomdoor.com

[Moduli 2 i UNICEF-it për trajnim të trajnuesve](#), Aktiviteti 2.1.1, ushtrimi “Më dëgjo”



**Aktiviteti 4: Aktiviteti me tre kavanoza****Pse është me rëndësi?**

- Nxënësit nxiten të ofrojnë kontribut pozitiv në përpjekjet e klasës, pa mos e theksuar sjelljen negative të nxënësit
- Nxënësit ndihmohen për t'u identifikuar me klasën si bashkësi e mësimi dhe për të fituar shpërblim, nga i cili do të përfitojnë të gjithë nxënësit

**Për çka bëhet fjalë?**

- Shpërblimi pozitiv për respektimin e rregullave paraprakisht të përcaktuara në klasë

**Metodat dhe veglat e nevojshme**

- Tre kavanoza, kartela që mund të futen në brenda kavanozave

**Përshkrimi i aktivitetit:**

Nxënësit dhe mësuesit zhvillojnë rregulla, të cilat vlejnë në përgjithësi ose kanë të bëjnë me një orë konkrete. Rregullat shënohen në kartela të vogla dhe vendosen në kavanozin e emërtuar “Sjellja”

Nxënësit dhe mësuesit i shënojnë shpërblimet, të cilat janë të dobishme dhe iu pëlqejnë të gjitha nxënësve. Këto shpërblime janë shënuar në kartela të vogla dhe janë vendosur në kavanozin e emërtuar “Shpërblimi”.

Po ashtu emrat e të gjithë nxënësve shënohen në kartela të vogla dhe vendosen në kavanozin e emërtuar “Cili”.

Në fillim të orës, mësuesi e nxjerr nga një kartelë nga kavanozat “Sjellja” dhe “Cili”, me çka do të dijë se çfarë sjellje do të mbikëqyret dhe cili nxënës do ta mbikëqyrë në klasë, me qëllim që të shoh nëse nxënësi arrin t'i përmbush kriteret.

Në fund të orës, mësuesi tregon nëse kriteret kanë qenë ose nuk kanë qenë të përmbushura. Nëse kanë qenë të përmbushura kriteret, mësuesi e tregon emrin e nxënësit, por nëse ato nuk kanë qenë të përmbushura atëherë mësuesi i drejtohet gjithë klasës që të angazhohet më shumë për herën e ardhshme. Pastaj nxënësi, i cili i ka përmbushur kriteret e përcaktuara paraprakisht e tërheq një kartelë nga kavanozi “Shpërblimi”, me çka e zgjedh shpërblimin, nga i cili ka dobi e gjithë klasa (nëse mësuesi nuk e përmend emrin e nxënësit, mësuesi mund të kërkojë nga cilido nxënës ta tërheq një kartelë nga kavanozi).

**Informacione plotësuese dhe referenca:**

Videon mësimore [Tre kavanoza](#) mund ta gjeni në Jutub (Youtube).



## Shtojca

### Fotografi

**Fotografia 1:** Modeli i aktiviteteve

**Fotografia 2:** Arsimi si sistem dhe proces

**Fotografia 3:** Modeli i aktiviteteve për praktika të mësimit gjithëpërfshirës

**Fotografia 4:** Modeli i aktiviteteve për praktikatat e mbështetjes së të gjithë nxënësve

**Fotografia 5:** Porosi të mirësearchjes në gjuhë të ndryshme (një shkollë fillore nga Zvicër) © Edina Krompak

**Fotografia 6:** “Ne jemi të sjellshëm, ndihmohemi mes vete dhe e dëgjojmë njëri tjetri” (në balona me tekst, shënohet: “Mirëmëngjesi!” “Mirëmëngjesi!” Çka ndodhi? Ai më goditi.”) © Edina Krompak

**Fotografia 7:** Këndi për lexim në bibliotekë © Edina Krompak

**Fotografia 8:** Harta e botës e dhënë mbrapsht (<http://odt.org/Pictures/sideb.jpg>)

**Fotografia 9:** Struktura e poezisë „Pse jam ...“

**Fotografia 10:** Portreti gjuhësor

**Fotografia 11-12:** Shembuj të drurit dhe dorës për paraqitje të identitetit gjuhësor © Edina Krompak

**Fotografia 13:** Le të fluturojmë!

**Fotografia 14:** Orkestra e shkollës © Edina Krompak

**Fotografia 15:** Piramida e planifikimit (Schumm, Vaughn, Leavell, 1994,

**Fotografia 16:** Piramida e planifikimit e dhënë si një aktivitet

**Fotografia 17:** Formular për planifikim të mësimit (Gartin et al. 2016, fq. 23)

**Fotografia 18:** Formular për kartelën e vokabularit

**Fotografia 19:** Ndërlidhja e qëllimeve, rezultateve dhe aktiviteteve

**Fotografia 20:** Paraqitja grafike e qëllimeve multidimensionale të aktivitetit

**Fotografia 21:** Mbishkrim në derën e klasës “Këtu mëson, qeshet dhe lëviz klasa e minjve dhe elefantëve” © Edina Krompak

**Fotografia 22:** Kutia me fletë pune © Edina Krompak

**Fotografia 23:** Korrigjimi i orientuar dhe fokusuar në resurse (<http://cciproject.org/afl/images/WrittenFeedback.gif>)

**Fotografia 24:** Mirë se erdhët nxënës (JUKIBU, Biblioteka ndërkulturore, Bazeli, Zvicër) © Edina Krompak

**Fotografia 25:** Karrige të ngjyrosura në mënyrë individuale © Edina Krompak

**Fotografia 26:** Këndi i leximit © Edina Krompak

**Fotografia 27:** Kohëmatësi

**Fotografia 28:** Semafori © Edina Krompak

**Fotografia 29:** Rregullat e klasës “E ruajmë rendin në klasë, me këmbë dhe çanta nën banka” © Edina Krompak

**Fotografia 30:** Druri i pritjeve © Edina Krompak



## Referencat

Aktas, Z. (2016). Promovimi i njohurive ndërkulturore. Materiale për mësim në gjuhë të trashëguar. Propozime didaktike 4. Cyrih: Universiteti Pedagogjik i Cyrihut. Gjetet në: <https://phzh.ch/de/Dienstleistungen/ipe/Lehrmittel-und-Handbuecher/Materialien-fur-den-herkunftssprachlichen-Unterricht/> (në gjuhën gjermane, angleze, shqipe, portugeze, boshnjake, kroate, serbe, turke)

Bennett, J. B.. (2012). Op-Ed: Differentiated instruction: Easier in theory than in practice. Marrë nga <http://patch.com/new-jersey/southorange/differentiated-instruction-easier-in-theory-than-in-practice>

Bennett, B., Rolheiser, C. (2001). Beyond Monet: The Artful Science of Instructional Integration. Toronto, Ontario: Bookation.

Boon, R. T. & Spencer, V. G. (2010). Best practices for the inclusive classroom. Scientifically based strategies for success. Waco: Prufrock.

Agjencia Europiane për Zhvillim në Arsimin Special (2012). Teacher Education for Inclusion. Profile of Inclusive Teachers. Odense: European Agency for Development in Special Needs Education. Gjetet në: <https://www.european-agency.org/sites/default/files/Profile-of-Inclusive-Teachers.pdf>.

Gardner, H. (1983). Frames of Mind. The theory of multiple intelligences. Nju Jork: Basic Books.

Gartin, B. C., Murdick, N. L., Perner, D. E. & Imbeau, M.B. (2016). Differentiated instruction in the inclusive classroom. Strategies for success. Arlington: Këshilli për fëmijë të jashtëzakonshëm

Gould, A. & Vaughn, S. (2000). Planning for the inclusive classroom: Meeting the needs of diverse learners. Catholic Education: Zhurnal për hulumtime dhe praktikë, 3 (3), 363-374

Huwylar, M. (2010). Was ist – Ist was. Geschichten, Gedichte, Szenen. Deutsch und Übersetzungen in sieben Sprachen [Çka është ajo – Ajo është diçka. Poezi, tregime, skena. Në gjuhën gjermane dhe I përkthyer në shtatë gjuhë tjera]. Czrih: Orell Füssli.

Saphier, J., Haley-Speca, M.A., Gower, R. (2008). The skillful teacher. Building your teaching skills. Acton, MA.

Schumm, J. S., Vaughn, S. & Leavell, A. (1994). Planning Pyramid: A Framework for Planning for Diverse Student Needs During Content Area Instruction. The Reading Teacher, 47, 608-615.

Tomlinson, C.A. (2000). Reconcilable differences: Standard-based teaching and differentiation. *Educational Leadership*, 58 (1), 6-11.

UNICEF (2015). Module për trajnim të trajnuesve në lidhje me arsimin gjithëpërfshirës. Moduli hyrës, moduli 1-3. Nju Jork: UNICEF. Gjetet në: <http://www.inclusive-education.org/basic-page/unicef-trainer-trainers-modules-inclusive-education>.

UNICEF (2014). 14 uebinare dhe broshura profesionale për udhëzim praktik në lidhje me çështjet e arsimit gjithëpërfshirës. Gjetet në: <http://www.inclusive-education.org/basic-page/inclusive-education-booklets-and-webinars>.



